



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.05.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i diskutimit për shqyrtimin nen për nen të dispozitave të Projekt Amendamenteve Kushtetuese, pjesa e gjykatave,(nenet 25 - 44).

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Jorida Tabaku, Petrit Vasili.

Mungojnë:

Eduard Halimi, Spartak Braho

Të ftuar:

Rainer Deville – shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

John Smibert – përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit të posaçëm parlamentar për Reformën në Drejtësi, për të vazhduar atje ku e kemi lënë shqyrtimin e projektit kushtetues, pikërisht te neni 25. Sot kemi kapitullin e gjykatave, që do të thotë se sipas njoftimit që keni, do të shqyrtojmë paradite, pasdite nuk e di do arrijmë dot apo jo, në qoftë se do të na mbetet kohë nuk diskutohet, ndoshta mund të fillojmë dhe kapitullin tjetër, por paradite kemi shqyrtimin e nenit 25 deri tek neni 44, janë rreth 20 nene, nuk është shifër e madhe. Po të punojmë me seriozitet dhe konstruktivitet s'kemi asnjë arsye pse të mos i mbarojmë shpejt, për të filluar pastaj kapitullin tjetër. Do t'ju lutesha, ndoshta mund ta vëmë dhe rregull që nuk duhet të zgjatemi me fjalë të tepërta, por të hyjmë konkretisht në thelbin e gjësë, në propozime konkrete, sepse pjesën e diskutimeve në parim kemi gati muaj që e bëjmë, tani duhet të fokusohemi te neni konkret, te çështja konkrete dhe nëse ka pyetje konkrete padyshim, por me propozime konkrete. Atëherë, fillojmë me nenin 25.

Oerd Bylykbashi – Kryetar, e vlerësoj atë që thoni, besoj se këto janë mbledhje të rëndësishme të komisionit. Jemi në diskutimin nen për nen dhe e dimë shumë mirë që janë nene dhe që ndërlidhen me njëra-tjetrën, dhe kanë problematika të cilat nuk janë vetëm në një organ të caktuar, por shtrihen edhe më shumë se në një organ. Unë besoj që mbledhja e kaluar dha një model pune, ku ne diskutuam me seriozitet, por kohën e nevojshme, do ta marrim dhe të gjithë anëtarët të shprehin atë që mendojnë, kështu që, le të mos limitohemi aq shumë nga presioni i kohës, por nga objektivi që kemi bashkë për të bërë një punë ashtu siç duhet. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Jo, koha ka rëndësi. Nëse doni që të kalojmë dhe të fillojmë shqyrtimin e ligjeve, mos harroni janë edhe ligjet që do të kalojnë.

(Diskutim pa mikrofon)

Jo, nuk kalojnë të gjitha ashtu. Të mos bëjmë gjëra që i kemi fokusuar, jashtë kornizës së Venecias dhe jashtë asaj çfarë kemi diskutuar në diskutimin në parim, se janë të panevojshme. Oratori për të shtyrë kohën. Kam përshtypjen që është pretekst për ta zvarritur. Është i dëmshëm ky pretekst. Mirë që nuk merrni pjesë në mbledhje, se keni punë partie, por tani doni edhe...

Oerd Bylykbashi – Ju kërkoj që mbledhja të fokusohet në çështjet që kemi dhe të mos merremi me çështje të jashtme, ashtu siç ishte komenti i fundit që bëtë. Ne mbledhjet do t'i bëjmë sipas mundësisë që kemi, kur të jenë anëtarët të disponueshëm, do të bëjmë mbledhje. Agjenda kohore juaja nuk korrespondon me atë që është objektivi besoj i të gjithë neve, që të bëjmë një Kushtetutë siç duhet. Në qoftë se ju mendoni që Kushtetuta mund të bëhet për dy ose tri orë të bëhen 20-30 nene, unë besoj që kjo është diçka jashtë parametrave të normales. Kam parasysh dhe diskutime që janë bërë për një Kushtetutë të vitit 1998, atë që kemi sot në fuqi, që ka marrë shumë kohë më tepër. Zoti Majko mund të na thotë në lidhje me këtë çështje. Ju lutem, ta mbajmë në parametrat e normalitetit, të diskutojmë për të gjitha çështjet që është e nevojshme. Asnjë lloj kufizimi për sa i përket asaj që ne mendojmë se është detyrim për ta diskutuar këtu.

Fatmir Xhafaj – Mos ngatërro kohën tëndë me kohën që ka marrë projekti. Koha jote është tjetër dhe koha që ka marrë projekti është kohë tjetër. Projekti nuk ka marrë natën e të mërkurës duke u gdhirë e enjtja, për fat të mirë nuk e ka atë fat ky projekt, ka marrë 1 vit e gjysmë dhe është bërë gjithë ky diskutim. Tani po flasim për të bërë një diskutim nen për nen, teknik dhe të fokusuar. Kaq, është e thjeshtë.

Neni 25.

Zoti Majko e ka kërkuar fjalën.

Pandeli Majko – Për nenin 25, që i konvenon nenit 135 të Kushtetutës, unë mendoj që paragrafi i parë të mbetet kështu siç është në draftin fillestar, po ashtu dhe i dyti. Për paragrafin e tretë kam një ndryshim dhe po e lexoj ashtu siç e propozoj. “Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe çështjeve penale kundër funksionarëve të lartë, akuzat kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarëve të bashkive, deputeteve të Kuvendit, zëvendësministrave, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative dhe drejtuesve të institucioneve shtetërore qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe në akuzat kundër ish- funksionarëve të sipërpërmendur që kanë shërbyer që nga viti 1991 për këto vepra”. Besoj se kolegët e mirëkuptojnë, që gama e akuzave që do të përfshiheshin me draftin fillestar është absolutisht shumë e gjerë, prandaj unë kam bërë me propozim një strukturim të këtij paragrafi. Sigurisht kam hequr edhe atë, për të cilën besoj se kam përkrahjen e të gjithë kolegëve,

afatin e përfshirjes së hetimit të këtyre veprave, duke e vënë atë që nga 1991 dhe jo vetëm për 3 vjetët e fundit. Në pikën 4, propozoj që të riformulohet “gjqqtarët e Gjykatave të Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në përputhje me këtë dispozitë dhe ligjin. Gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme shkarkohen nga detyra me 2/3-t e votave të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civil gjyqësor në gjykatat e posaçme duhet të kalojnë verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Kandidatët duhet të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve personale. Pëlqimin për sa më sipër mund ta japin edhe familjarët e afërm të kandidatëve”. Kaq për nenin 135, të Kushtetutës që i konvenon nenit 25, në draftin që kemi përpara.

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit! Ka tjetër? Po zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Së pari, ky është një nen kushtetute, i cili më shumë i ngjan një neni ligji sesa një neni kushtetute. Besoj që zgjatja në këtë detaj, por edhe nevoja për të mos u zgjatur më shumë se ç’duhet, që gjithsesi ka ikur, ka krijuar dhe një seri problemesh në lidhje me formulimet të cilat krijojnë konfuzion, janë të paplota, janë konfuze dhe duan patjetër sqarim dhe rregullim. Sigurisht që, ne ndoshta mund t’i bëjmë edhe këtu ato, pra t’i japim rekomandimet për t’u zgjidhur kjo çështje, por besoj që, në vetvete neni është tmerrësisht i detajuar për një nen kushtetute.

Do të vazhdoj me një shqetësim që e ngriti edhe zoti Majko, për paragrafin 3. Sigurisht, unë kuptoj që ka nevojë jo vetëm për të kufizuar te lënda që do të gjykojë Gjykata e Posaçme, edhe pse ne themi që Gjykata e Posaçme krijohet me ligj në një fushë të posaçme. Pra, në një fushë të caktuar mund të kemi një gjykatë, të tillë kemi Kolegjin Zgjedhor dhe unë besoj që në një ditë të caktuar ai kolegji na intereson më shumë se çdo gjykatë tjetër e posaçme në këtë Republikë për mënyrën si operon, por nuk e kemi këtu në Kushtetutë. Gjithsesi, në të gjithë diskutimin që kemi bërë mendoj se ndoshta një element bazë për këtë gjykatë që po ngremë këtu, na duhet në këtë Kushtetutë, por të shkohet pastaj më pas edhe në detajimet e këtij lloji që kanë çuar në një konfuzion të madh për sa i përket jo vetëm lëndës, por dhe subjekteve. Këtu qartazi më pas kemi një konfuzion i cili çon në keqinterpretime jo vetëm të karakterit politik, por edhe në zbatimin e ligjit. Unë besoj që do të na duhet ta rishikojmë me shumë kujdes këtë pjesë, sepse kjo është dhe shumë e zgjidhshme, por nëse dikush do të hetohet për korrupsion apo krim të organizuar, kjo është lënda që do të shqyrtojë kjo gjykatë, pastaj procedurat dhe afatet, qoftë dhe

për ndjekjen penale janë të përcaktuara diku tjetër. Nëse ne duam që të kufizojmë këtë sferë të subjekte të caktuara, pra të mos i ofrojmë, por të mos lëmë nga ana tjetër askënd jashtë. Kështu siç është zgjidhur, është zgjidhur keq.

Oerd Bylykbashi – Në draft gjithmonë?!

Në këtë draft. Nuk po flas për propozimin, sepse duhet ta shohim të shkruar, mund të kemi dhe ne propozimin tonë së shpejti në lidhje me këtë. Kështu që, gjykoj që në aspektin edhe të asaj që do të ishte teknika legjislativë e një neni kushtetues, që është shumë e rëndësishme, besoj biem dakord për këtë, na duhet të thellohemi shumë në mënyrën se si është shkruar.

Tani do të shkoj te një çështje edhe më principiale se kjo. Paragrafi i parë flet për ushtrimin e pushtetit gjyqësor nga dy gjykata, Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën e Lartë Administrative. Sot e kësaj dite nuk ka asnjë arsytim solid që të justifikojë pse Republikës së Shqipërisë i duhet Gjykata e Lartë Administrative. Nuk është standard, nuk është nevojë, ende nuk e kemi ezauruar ne shtratin e gjykimit administrativ deri në atë pikë sa kemi ardhur te konkluzioni që Shqipërisë i duhet dhe një Gjykatë e Lartë Administrative. Madje unë besoj që, ato që janë thënë në Komisionin e Venecias që Shqipëria ka burime njerëzore të mjaftueshme, ndërkohë që në rastin konkret, ndoshta mund të trajtohen ndryshe, por nuk janë arsye që ne të krijojmë një Gjykatë të Lartë Administrative. Është vetëm një pikë tjetër debati institucional në emërimin dhe në funksionimin e sistemit të drejtësisë, por më shumë se kaq është një institucion, i cili kështu siç parashikohet, do të krijojë një konfuzion dhe një përplasje të rëndësishme. Gjykata e Lartë Administrative do të përballet me çështje të cilat nuk do t'i kenë kufijtë kaq të qartë. Gjykata e Lartë Administrative ose i tërë sistemi, mund të marrë në shqyrtim çështje të cilat mund të jenë po aq të trajtueshme nga aspekti civil. Pra, edhe një gjykatë civile mund t'i marrë në shqyrtim. Atëherë cilat janë opsionet që do të përballet sistemi? Do të kemi një person i cili nuk do të dijë kujt t'i drejtohet dhe mund të kemi Gjykatën Civile dhe do të përfundojë në Gjykatën e Lartë normale, por mund të kemi dhe Gjykatën Administrative që ta marrë një çështje dhe ta çojë deri në Gjykatën e Lartë Administrative.

Së dyti, mund të kemi dhe situatën kur subjekti shkon në Gjykatën Administrative dhe kjo e refuzon, shkon dhe në Gjykatën Civile dhe kjo e refuzon. Pra, do të jemi përpara një situatë ku subjekti nuk do të dijë ku ta zgjedhë të drejtën e vet dhe për këtë do të na duhet të investohemi në vend tjetër. Por kemi edhe më keq se kaq, kemi mundësinë e subjektit për të bërë

atë që quhet *forum shopping*. Ju kujtoj diçka, kolegë, nuk e di, një pjesë prej jush ndoshta dhe e mban mend.

Një nga kritikantët më të forta, që i është bërë procesit gjyqësor zgjedhor në Shqipëri ka qenë mundësia për *forum shopping*, që u krijohej subjekteve, për të bërë ankimin e tyre për një çështje zgjedhore. Çështje gjyqësore është, po e marrim si të tillë dhe ekspertët ndërkombëtarë e kritikuan shumë këtë si diçka të papranueshme, diçka që dëmtonte sistemin, dëmtonte dhe besimin te sistemi. Këto janë të shkruara, nuk po i them unë. Gjithashtu, mundësia për të bërë *forum shopping* mund ta çojë edhe në situatën kur ne kemi dy gjykata që trajtojnë të njëjtën çështje, në mënyra krejt të ndryshme me një konsistencë dhe një vendimmarrje krejt të papranueshme. Nëse ju mendoni që ajo mbledhja e përbashkët është zgjidhja, besoj që është infantile, besojmë që ajo do të funksionojë, sepse askush nuk garanton që kjo mbledhje do të jetë funksionale. Askush nuk garanton subjektin që ka interes, që çështja e tij do të zgjidhet në kohë dhe do të unifikohet. Do t'ia lemë mbledhjes së një sasive çështjesh që kjo të ndërhyjë, nëse këto do të kenë vullnetin e përbashkët? Ç'do bëjnë këta, do të bëjnë vetëm ndarjen e kufijve me njëri-tjetrin, apo do të trajtojnë çështjet, për ta ndarë: është në këtë drejtim apo në atë drejtim? Po krijojmë një shkallë tjetër? Pse duhet e gjitha kjo? Për të krijuar një institucion tjetër me të cilin emërojmë dhe fusim persona të tjerë në një Gjykatë tjetër të Lartë? Për të krijuar një spiral të caktuar brenda përbrenda sistemit të drejtësisë për mënyrën se si emërojnë njëri-tjetrin, apo funksionojnë? Unë nuk besoj se ky është qëllimi që kanë individët të cilët i drejtohen Gjykatën e Shkallës së Parë, për të zgjidhur hallin e tyre. Në qoftë se kjo është çështje kapacitetesh, siç është parashikuar Gjykata e Lartë Administrative, mund të jetë në mënyrë perfekte me të njëjtin numër, ne numrin e Gjykatës së Lartë nuk e kemi të përcaktuar në Kushtetutë, të jetë pjesë e Kolegjit Administrativ. Sot Shqipëria ka nevojë për më shumë gjykim administrativ, do të jetë një kolegji i madh administrativ. Pra, edhe çështjen e burimeve njerëzore, ju po e parashikoni që të jetë i tillë në Kushtetutë. Atëherë t'i bëjmë bashkë dhe kemi një trupë të vetme, e cila e mbyll këtë problem në Shqipëri dhe nuk krijon konfuzion. Shqiptarëve, që i drejtohen gjykatës, nuk u intereson si ndahet pushteti në majat e pushtetit gjyqësor, u intereson efikasiteti i dhënies drejtësi, transparenca, konsistenca e dhënies së kësaj drejtësie dhe mënyra se si është arkitektuar e gjitha është diçka e cila nuk prodhon tjetër vetëm se konfuzion. Duhet më shumë gjyqtarë në Gjykatën Administrative, në Gjykatën e Lartë për gjykimin administrativ, bëjmë një kolegji të madh.

Fatmir Xhafaj – Ka një të drejtë që, fokusohu...

Oerd Bylykbashi – Edhe një herë, Gjykata e Lartë Administrative është në goditje për stabilitetin e procesit, aq më tepër, që ju vetë e keni kuptuar që nuk mund ta ngrini menjëherë dhe për kompromis, na e shtytë në 2020. Kush është arsyeja? Pra, në themel qëndron panevojshmëria për këtë gjykatë.

Fatmir Xhafaj - Edhe një herë, se dëgjova që përdore atë fjalën infantile. E di çfarë është infantile në të gjithë këtë histori? Që të mos kuptosh që kompetenca lëndore ndahet në shkallë të parë, nuk ndahet në Gjykatën e Lartë Administrative. Kur ka vajtur në shkallë të parë, është ndarë, do të jetë te Gjykata Civile, apo do të jetë te Gjykata Administrative? Pra, nuk krijohet konflikt ndërmjet dy kompetencave kur shkon te Gjykata e Lartë, se ka kaluar tri shkallë: ka kaluar shkallën e parë, ka shkuar në Apel dhe Gjykata e Lartë nuk do të jetë gjykatë fakti, do të jetë gjykatë e unifikimit të vendimeve dhe si e tillë nuk do të gjykojë çështjet konkrete, këto çështje do të mbyllen në Apel, siç janë sot, nuk do të krijojnë kompetencë për unifikim, janë gjykata unifikuese qoftë Gjykata e Lartë e zakonshme, qoftë Gjykata e Lartë Administrative, nuk krijojnë konflikte për çështje konkrete. Janë zgjidhur konfliktet për çështjet konkrete kur shkojnë në Apel, ka marrë formë vendimi kur shkon në apelin administrativ. E ka zgjidhur ligjvënësi, kemi krijuar dy lloj gjykimesh. Sot që po flasim ne gjykohet. Arsyeja e Gjykatës së Lartë Administrative, që është një debat që e kemi bërë këtu, e kemi mbyllur dhe kemi rënë dakord. Hapni procesverbalet, kemi rënë dakord për këtë gjë, në këtë sallë. Jo sa herë që kujtoheni ta hapni, megjithatë, meqenëse e hapët po të kthej një përgjigje shkurt fare, është për ta mbyllur gjykimin administrativ, për efekt të cilësisë, për efekt të shpejtësisë dhe për efekt të unifikimit cilësor të praktikës së gjyimit administrativ. Kjo është logjika. Megjithatë, kjo është një çështje që e kemi tejkaluar dhe nuk kemi pse i rikthehemi sa kohë që ne e kemi mbyllur këtë çështje. Po të hapësh procesverbalet e mëparshme është.

Po zoti, Majko!

Pandeli Majko – Besoj dhe shpresoj që, propozimi që sapo bëri zoti Oerd, të mos jetë një tendencë për të bllokuar diskutimin, sepse çështja proceduralisht ndahet në dy drejtime. Nëse kemi një pozicion të ri të Partisë Demokratike për sa i përket infrastrukturës së reformës, e cila është krejt e ndryshme nga pozicioni që keni mbajtur deri tani. Kujtoj, se në mbledhjen e fundit, ku paraardhësi juaj lexoi rezymenë e të gjithë qëndrimit të Partisë Demokratike dhe e lexoi me shkrim, pikërisht për t'u fiksuar si pozicionim i Partisë Demokratike për sa i përket reformës, kjo

çështje nuk u ngrit në asnjë paragraf. Nëse kjo është një çështje që e hapni ju, zoti Oerd, tani që e zëvendësuat zotin Halimi, ky është një problem tjetër, por nuk është problemi ynë. Atëherë, kthehuni te partia juaj, gjykoni çfarë keni për të bërë, merrni me ndërkombëtarët. Ne kemi ardhur këtu për të mbrojtur dhe për të diskutuar nenet, nene të cilat kanë kaluar të paktën në dy filtra të Komisionit të Venecias, janë diskutuar në parim me ju dhe janë të regjistruara. Tani, ju zoti Oerd, ditën e parë që vini si drejtues i grupit të opozitës, na rihapni një temë tjetër, e cila shkatërron të gjithë procesin, për hir të vërtetës, nuk dua të them e qesharakizon, por e shkatërron.

Po i kthehem edhe një herë problemit kur e kemi diskutuar në parim. Çështja e ndërtimit të Gjykatës Administrative është e një natyre të tillë dhe e kemi diskutuar në parim, nuk ka nevojë të hapim procesverbalet. Ne mund të jemi nga vendet e rralla që kemi Gjykatë Apeli Administrative dhe nuk kemi Gjykatë të Lartë Administrative, në Europë, e para.

Fatmir Xhafaj - I vetmi shtet në Evropë.

Pandeli Majko - E dyta, interpretimin e çështjeve që kalon Gjykata e Apelit Administrativ e bëjnë gjyqtarët penalistë në Gjykatën e Lartë, që është absolutisht e palogjikshme.

E treta, ju e dini shumë mirë që, gjyqtarët administrativ në bazë të ligjit kalojnë në filtra të natyrave të ndryshme nga gjyqtarët penalistë. Gjyqtarët administrativ bëjnë konkurse, do të plotësojnë disa kushte specifike e kështu me radhë. Kështu që, është e natyrshme që kur është diskutuar në parim Gjykata e Lartë Administrative, është e rëndësishme edhe për faktin e kësaj që sapo thashë. Prandaj, do t'ju lutesha, shumë përlusht dhe me shumë respekt, të vazhdojmë diskutimin nen për nen dhe të mos i fillojmë gjërat edhe një herë nga a-ja. E përsëris, nëse doni t'i filloni gjërat nga a-ja, ky nuk është problemi ynë, është problemi juaj. Shprehni qëndrimin tuaj politikisht dhe merrni vendim për këtë çështje. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zoti Mediu, vetëm shkurt!

Fatmir Mediu – Pak më shkurt se kolegu juaj. Shkurt fare.

Përlusht me respekt nuk është kur ne përlushtemi t'i bëjmë moral njëri-tjetrit, dakord? Le të jemi të drejtpërdrejtë. Secili vjen këtu dhe thotë gjykimin e vet, mirë apo keq, pastaj dalim në një përfundim duke u bazuar edhe te mendimi i specialistit sa i vlefshëm është. Gjëja më e keqe do të ishte, që neve të kalojmë në një indiferencë për shkak të paragjyimit, ose gjërave që nuk duhen.

Ajo çka ngriti zoti Bylykbashi ka qenë një shqetësim i diskutuar këtu, u ringrit për ekzistencën ose jo të Gjykatës Administrative. Në pikëpamjen tonë, për shkak të vetë pamundësive që ka shteti etj etj, pra, gjykojmë që mund të ketë një koleg administrativ, pra te ky numër të shtohet dhe Gjykata e Lartë, duke pasur parasysh të gjitha asetet që ka dhe mundësitë që ka. Kjo është një çështje teknike, që s'ka pse të bëhet një debat kaq i madh këtu. Do t'ju lutesha të mos e diskutojmë njeri-tjetrin. Ne këtu jemi për reformën në drejtësi. Zotëria është drejtues i opozitës për këtë grup, do të ngrejë shqetësimet e opozitës. Uroj dhe shpresoj të jemi të gjithë sa më konciz, pa i bërë moral njëri-tjetrit. Po t'i vij thelbit, vetëm një shqetësim kam në raport me atë ç'ka ngriti zoti Majko. Unë nuk mendoj se duhen vendosur afate në këtë linjë, e kështu me radhë. Le të lihet e hapur, për të gjithë ish-gjyqtarët, për të gjithë kohët që kanë qenë, për korrupsionin që kanë bërë. Vendosija e afateve duket sikur vendos një target...

Fatmir Xhafaj - Po e the nga 91-shi, s'është amnisti.

Fatmir Mediu - Mirë, zoti Xhafaj, duket sikur vendos një target kohor, i cili s'ka pse të ekzistojë. Zyrtarët për të gjithë abuzimet që kanë bërë me pushtetin. Për të gjithë abuzimet.

Fatmir Xhafaj – Qartë. Ky është një version i juaji.

Nuk kam ndonjë gjë, edhe unë jam shumë dakord mbi atë sugjerimin që u bë. Por, kam një gjë zoti Mediu. Kemi rënë dakord, e kemi mbyllur që në fillim këtë histori, Venecia është korniza dhe ne këtu kemi ardhur të diskutojmë projektin në mbështetje të asaj dhe e kemi marrë të mirëqenë kontributin e ekspertëve, e kemi vlerësuar dhe kemi rënë dakord me forcat politike, jemi ulur në tryeza, këtu dhe jashtë saj. T'u qëndrojmë korrekte atyre gjërave. Ky ishte gjithë shqetësimi. Unë jam shumë dakord dhe siç e ke parë dhe në këto dy seancat e mëparshme kam qenë shumë i hapur për të dëgjuar sugjerime konkrete, vërejtje, por jo për të pasur diskutime politike për t'iu kthyer atyre. Ka ngelur një pikë politike dhe unë kam qenë shumë i hapur, e kam pranuar këtë gjë, që ka disa gjëra që janë diskutime politike, e kam diskutuar, e kam thënë dhe këtu, që po, nuk mbyllet projekti pa mbyllur ato, patjetër, pa diskutim fare, por të mos rihapim këndvështrime të reja.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, është çështje me rëndësi kjo. Unë nuk po e shtroj këtë si çështje të karakterit politik, sepse po qe se është çështje me karakter politik, që duhet zgjidhur pamundësia e kapjes, atë do ta zgjidhim dhe nuk ka shans që ky komision ta lerë të pazgjidhur. Barra jonë këtu është të ndërtojmë një sistem i cili funksionon.

Unë po flas këtu për një qëndrim të cilin ne kemi qenë konsistentë në parim, në fund ne do të gjejmë zgjidhje për këtë çështje, por pyetjet që ngrita, mbeten dhe asnjë nga ata që thatë ju, për fat të mirë, apo të keq nuk i dha përgjigje, as nga ajo që tha kryetari. Sigurisht që kompetencën lëndore do ta ndajnë gjykatat atje në Shkallën e Parë. Do të doja që edhe ekspertët ta ndiqnin këtë, ku një veprim administrativ ka ndikuar mbi funksionimin dhe mbi zbatimin e një kontrate, që është kontratë civile dhe ka shkaktuar një konflikt dhe mund ta marrë përsipër Gjykata e Shkallës së Parë Administrative.

Në fund të fundit, mund të jetë legjitime në këtë, por një çështje identike mund ta marrë në shqyrtim edhe Gjykata Civile, sepse e sheh në aspektin civil. Pra, kemi ndarjen e kompetencës lëndore, zoti kryetar. Pra, çështja është pikërisht kjo. Jemi në të njëjtën substancë, që kanë vendosur ta trajtojnë ndryshe dy gjykata të ndryshme dhe ky është konflikti.

Pra, ne nuk do të jemi në gjendje të kuptojmë, ose subjekti më i zgjuar do të mendojë se në cilën gjykatë i leverdis më shumë, ku mbaron më shpejt dhe më mirë, dhe më pas mund të kemi dy vendimmarrje të ndryshme. Kjo e dëmton sistemin.

Pse jo, të mendohemi në mënyrë principiale, me mendje të hapur për të parë nëse është kjo, ose jo ajo që i duhet sistemit .

Zoti kryetar, nëse ne do ta ndajmë përfundimisht që duhet të jetë kjo ose jo, zgjidhja do të reflektohet edhe në pika të tjera, por është administrimi i përditshëm i drejtësisë. Është ajo që qytetarët kanë nevojë. Ne nuk po diskutojmë se cili do të jetë kryetari dhe në çfarë trupi tjetër *ex officio* do të jetë ai dhe pse është kryetar i Gjykatës së Lartë Administrative. Nuk është kjo çështja. Po të jetë kjo, e keni gabim. Besoj se duhet ta nisim nga rrënja. Po, edhe në 2020-ën, zoti kryetar...

Fatmir Xhafaj – Hapim një debat publik të të dy forcave politike me biznesin, me komunitetin e gjyqtarëve për këtë çështje. Unë do t’u drejtohem publikisht njerëzve, duke filluar nga dita sotme. Vetëm dëgjoni se çfarë do të thotë biznesi... Unë nuk kam dashur ta bëj këtë gjë.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, çështja që po shtroj është kjo: nëse ky shtet ka nevojë, nëse biznesi, individët kanë nevojë për shumë gjyqtarë administrativ, jo penalist, zoti Majko, në Gjykatën e Lartë, le ta bëjmë, sepse për sa i përket kompetencës nuk ndryshon asgjë.

E vetmja gjë që do të bëjë më shumë Gjykata Administrative pas 2020-ës do të jetë fakti që dikush nga këta, nga kjo gjykatë, mund të jetë edhe në trupa të tjera të sistemit të

drejtësisë, për sa i përket substancës asgjë më shumë dhe asgjë më pak. Madje na jep mundësinë që Gjykata e Lartë të unifikojë praktikën pa pasur konfliktin që kemi sot.

(Mungesë incizimi.)

Fatmir Xhafaj – Keni vërejtje konkrete, për dispozitën për sa i përket vetëdërhyrjes që bëri zoti Mediu, për të mos e kufizuar kohën?

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, besoj se me kufizimin që kemi bërë te lënda përcakton, për shembull: Ka vepra penale në të cilat parashkruhet hetimi deri në një afat të caktuar. Pra, çfarëdolloj kufizimi kohor që mund t’i japësh... Nëse duam të krijojmë një rreth për t’i ngushtuar, po themi, ngarkesën, le ta bëjmë. Por a është e nevojshme të shkruhet këtu në këtë nen?

Fatmir Xhafaj - ...pika 3 zgjidh vetëm juridiksionin e gjykatave. Ajo që bëri zoti Majko, se ndoshta nuk u kuptua, është që subjektet do të jenë të kufizuara vetëm brenda këtij juridiksioni. Pra, nuk do të gjykohen për vepra penale, që nuk lidhen me këtë juridiksion. Në qoftë se këtu janë krimet e rënda dhe korrupsioni, larg qoftë, unë apo ju, bëjmë një aksident automobilistik, nuk gjykohehi nga gjykata ...

Me normën që është sot ne përfshiheshim në këtë gjë. Mjafton të jesh deputet, edhe për shpifje, edhe për fyerje shkon në gjykatë të posaçme. Me rregullimin që i bëmë, kufizohet dhe shkohet vetëm për këto lloj vepra penale.

Oerd Bylykbashi – Unë jam dakord me këtë gjë. Çështja është...

Fatmir Xhafaj - E kufizojmë, e shkurtojmë. Nëse keni ndonjë shkurtim tjetër, më thoni. Jam dakord.

Oerd Bylykbashi - Do ta shikojmë një herë në detaje, pastaj do ta...

Fatmir Xhafaj - Bëni një rregullim, sepse mua më pëlqeu për vete.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është një çështje që duhet parë, sepse politikisht logjika që përdori zoti Majko është e pranueshme, që të jem i sinqertë, sepse dua që të jem i hapur, dhe kur flasim këtu, unë kam i çliruar nga ngarkesa politike, por nga pikëpamja e efektshmërisë nuk është shumë oportune, sepse do të rritej shumë në vite ngarkesa e Gjykatës së Posaçme. Kjo do të thotë se dikush që ka qenë në vitin 1992 6-muaj ministër, do të të gjykohet gjithë jetën, edhe pse nuk ka asnjë interes për publikun, por në këtë fazë ndoshta duhet të gjejmë një dispozitë transitore. Ta mbyllim këtu dhe pastaj vëmë një kufi.

Fatmir Mediu - Të çmohet nga Prokuroria e Posaçme dhe nga Gjykata e Posaçme.

Fatmir Xhafaj - Po s'e pati në..

Fatmir Mediu - Po vendosëm afat, do të thotë që duhet t'i shkojë automatikisht, kurse, po nuk vendosëm afate, do të çmohet nga ata që bëjnë hetimin.

Fatmir Xhafaj - Po the vetëm fjalën "ish", pastaj i kap në çdo kohë.

Fatmir Mediu - Po e the që nga viti 1991...

Fatmir Xhafaj - Një kufizim duhet vendosur, por se i çfarë natyre do të jetë, do ta...

Fatmir Mediu - Ju po thoni të njëjtën gjë që keni shqetësim dhe e përfshini, sepse ju thoni që nga...

Fatmir Xhafaj - Kufizimi i kompetencës së juridiksionit na ndihmoi, dhe e rregulloi goxha.

Fatmir Mediu – Dakord, ajo është njëra anë.

Fatmir Xhafaj - Duhet që ta shikojmë edhe këtë gjë, por ky është njëri opsion, dhe, po na gjeti dikush ndonjë formulim më të mirë, e rregullojmë.

Fatmir Mediu – Afati kohor i të gjithë...ti sikur vendos target dhe duhet që ta fillosh që atje.

Fatmir Xhafaj - Dakord, fjalën e ka zoti Vasili.

Petrit Vasili – Ne përpiqemi ta qetësojmë këtë proces si profesionalisht, ashtu edhe në përmbajtje. Çdo lloj ngarkesë politike që procesit do t'i futet qoftë edhe në formulim, nuk e ndihmon atë. Ne me këtë proces kemi marrë përsipër një mision, megjithëse kemi pasur një drejtësi, një Kushtetute që në vite mund të ketë pasur afeksionet e veta, është afektuar, dhe kemi ardhur sot në këtë moment dhe themi se këto ndryshime duhet të jenë të pastra dhe të çliruara nga këto gjëra. Tani të fusim konceptet, "ish kaq", 1991, 1992, 1994, problemi është i tillë, që vepra penale, të cilat për mua janë të përcaktuara shumë qartë, dhe unë përshëndes këtë, janë të tilla që ndiqen nga këto figura kushtetore që kanë. Ndër vite ka pasur gabime të konstatuara, por sistemi ynë ka, dhe këto që po bëjmë nuk e kufizojnë mundësinë e gjykimit të tyre, por në moment që ne fusim elemente të tilla të karakterit politik, atëherë i gjithë debati vende-vende do të dalë me të tilla koncepte. Unë jam i mendimit që ne të qëndrojmë në formulime të pastra juridike.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit! Kemi ndonjë merak tjetër për nenin 25?

Zoti Bylykbashi, po.

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar.

E para një herë, për paragrafin e tretë do të na duhet që të gjejmë një zgjidhje që të jetë funksionale.

Fatmir Xhafaj - E gjetëm një zgjidhje që e ngushtuam juridiksionin për këto subjekte, por, nëse doni që t'i heqim fare nga Kushtetuta, le ta gjykojmë, por keni...

Oerd Bylykbashi - Gjykata Penale e Posaçme e Shkallës së Parë dhe Apelit gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar të caktuara me ligj. Këto gjykata gjykojnë nga akuzat e tjera penale kundër Presidentit të Republikës, kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, kryetarëve të bashkive, prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si edhe anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të gjykatave të larta, pavarësisht nëse këta funksionarë të lartë në kohën e gjyqimit nuk janë më në detyrë. Ligji mund të shtoj në kompetencën lëndore të këtyre gjykatave edhe gjykimin e akuzave të tjera penale kundër funksionarëve të tjerë të lartë.

Fatmir Xhafaj – Edhe kështu siç është formuluar, edhe kjo është...

Oerd Bylykbashi - Do t'i depozitojmë dhe do të bëjmë një draft të përbashkët në këtë aspekt, por ndoshta kemi në draftin më të mirë dhe bindeni edhe ju.

Fatmir Xhafaj – Qartë.

Oerd Bylykbashi – Gjithashtu, ka edhe një çështje tjetër. Në paragrafin e katërt, ne duhet të jemi të kujdesshëm me mënyrën se si personat do të vijnë në këtë sistem të posaçëm, mënyra se si ata do të verifikohen në lidhje me privatësinë e tyre. Formulimet, kështu siç janë, kanë probleme, por besoj se janë të rregullueshme, sepse ka edhe përplasje të llojit që nuk mund të emërohen gjyqtarë, pa marrë pëlqimin e tij dhe të familjarëve të afërt. Pastaj thuhet, telekomunikimet e familjarëve, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin, monitorohen vetëm me vendim gjykate, por, në qoftë se nuk e ka dhënë pëlqimin, ai nuk mund të jetë anëtar dhe për rrjedhojë nuk ka pse hyn gjykata, sepse nuk është emëruar. Në mënyrën se si është shkruar, kemi konflikt, por problemi kryesor këtu është që ne, përveçse duhet të jemi shumë të kujdesshëm në lidhje me nivelin apo dozën në të cilën ne invadojmë në privatësinë, jo vetëm të gjyqtarëve, por edhe të prokurorëve që do ta shikojmë më vonë, por edhe të familjarëve të tyre, mund të na çojë në atë që është pamundësia për të pasur individë, të cilët do të pranojnë këtë lloj niveli në të ardhmen, të ndërhyrjes në privatësinë jo vetëm të tyre, por edhe të

familjarëve të tyre nga shteti. Për rrjedhojë, mund të jemi përpara një kolapsi të sistemit, sepse nuk ka burim njerëzor për ta mbushur këtë, sepse po flasim për gjykata të të gjitha niveleve, prokuroritë, dhe për rrjedhojë mund të kemi pamundësinë për ta plotësuar me persona. Kështu që lind nevoja për të qenë shumë të kujdesshëm, sepse nuk është që ta shkruash bukur sot në Kushtetutë dhe të kënaqemi ne, sepse, kur të na vijë nesër nevoja për ta zbatuar dhe e kemi edhe në nën kushtetues, çfarë do të bëjmë, do të ndryshojmë Kushtetutën, sepse nuk kemi njerëz? Pra, ta proporcionojmë këtë kufizim, në raport me atë që është qëllimi publik dhe që është e drejtë e individit, por edhe me këtë që është një gjë reale. E zëmë se nuk do të pranojmë asnjë gjyqtar dhe asnjë prokuror...

Fatmir Xhafaj - Pra, ju mendoni se kjo pjesë duhet të jetë në ligj.

Oerd Bylykbashi - Besoj se në ligj mund të jemi shumë më të rafinuar dhe shumë më të kujdesshëm, me mënyrën se si do të ndërhyjmë në mënyrë që të na funksionojë sistemi, sepse për këtë biem dakord dhe të mos e teprojmë.

Fatmir Xhafaj - Keni gjë tjetër jashtë...

Vasilika Hysi - Lidhur me shqetësimin që ngre zoti Bylykbashi, unë nuk pajtohem që gjërat apo parimet të mos jenë të përcaktuara në Kushtetutë. Gjëja e parë e rëndësishme është që biem dakord që gjyqtarët nga administrata gjyqësore, që do të punojnë në këto lloj gjykatash, do t'i nënshtrohen detyrimisht verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. Më pas, për shkak të specifikës së tyre, qoftë kandidatët për gjyqtarë, qoftë nëpunësit civilë të gjyqësorit, pasi të kalojnë këto pjesë, do të pranojnë edhe një kusht tjetër, do të japin pëlqimin për kontrollin periodik të pasurisë së tyre dhe të komunikimeve personale. Meqenëse po shkojmë te kufizimi i të drejtave të pjesëtarëve të tyre të familjes, ky lloj kufizimi duhet të jetë shprehimisht në Kushtetutë, sepse nuk mund t'ia lëmë ligjit, se me ligj mund të rregullohen detajet. Janë dy raste. Rasti i parë kur familjarët bien dakord dhe japin pëlqimin dhe rasti i dytë kur ata nuk bien dakord dhe në këtë rast veprojnë rregullat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale, që përgjimi do të bëhet me vendim të gjykatës. E vetmja gjë, këtu pajtohem me sugjerimin e kolegut Majko, por edhe ju e thatë, është për ta riformuluar më pas dhe më qartë nga ana gjyqësore, për të mos krijuar kuptim të ndryshëm nga njerëz të ndryshëm.

Fatmir Xhafaj - Jemi të gjithë me një mendim dhe kjo është gjë pozitive.

Petrit Vasili - Jam plotësisht dakord me konceptin e kontrollit të pasurive të tyre dhe ne nuk themi ndonjë gjë të re me këtë, sepse mund të jetë më intensive puna e tyre. Jemi të

bindur që ka ndonjë kuptim çështja e dhënies së pëlqimit për telekomunikimet? Po jua them sinqerisht që ky është një përcaktim qesharak. Ne synojmë, kush e ka menduar këtë mrekulli të paparë, që nëpërmjet interceptimit të komunikimeve telefonike të gjejmë korrupsionin e tyre, ndërkohë që u kemi thënë që ta keni shumë të qartë se ne ju përgjojmë. Nuk besoj se na rrëzoni në naivitete të këtij niveli, prandaj ju lutem na e kurseni këtë gjë.

Jam plotësisht dakord me kontrollin e pasurive dhe me të gjithë mekanizmat e fshehjes së saj, të cilat mund të investigohen, por ne u themi edhe publikisht që ju jeni të përgjuar, dhe, po të doni, ju flisni edhe për korrupsionin, sepse ne po ju dëgjojmë dhe po ju kapim dhe këtë po e shënojmë në Kushtetutë. Unë mendoj që ai koncept që kemi bërë ne për dyshimet, edhe për të tjerat ka një procedurë të tërë për përgjimin, na bënë të mundur që të kemi mundësi edhe të asaj që quhet interceptimi i veprimtarisë korruptive. Jam plotësisht dakord për kontrolle të pasurive akoma edhe më të shpeshta dhe intensive, dhe ILKPDI-ja të ketë një strategji ndryshe për interceptimet telefonike, e aq shumë më shumë edhe të familjarëve, por të vëmë edhe klauzolën që, po nuk deshën familjarët, ne i kthejmë me procedurë të zakonshme. Unë them që të qëndrojmë fort te kontrolli i pasurive, i cili është një indikator shumë i qartë që na e mat korrupsionin shumë pastër, dhe u largohemi këtyre, të cilat kanë interpretim shumë negativ nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, por edhe në mënyrën se si përdoret dhe nuk përdoret kjo lloj praktike në kohët demokratike. Që përgjohet telefoni dhe që bëhet interceptimi nuk është thënë as para viteve '90. Tani të shkruajmë Kushtetutën e vendit që ti vete me kuç dhe me maç dhe do t'ju përgjojmë të gjithëve. Jepni pëlqimin që ju përgjojmë dhe ju flisni që t'ju kapim ne.

Fatmir Xhafaj – Po dakord.

Oerd Bylykbashi - Këtu është e shkruar dhe ka një problem, sepse thuhet që Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mund të emërojë asnjë gjyqtar pa marrë pëlqimin e tij dhe të familjarëve të afërt për kontrolle periodike të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve personale sipas ligjit.

Së pari, këtu nuk është e qartë nëse duhet marrë pëlqimi për kontrollet, apo pëlqimi do të jetë sipas ligjit, por kjo është gjë që zgjidhet dhe është çështje vote. Problemi është këtu, që kontrolli periodik logjikisht do të thotë që po i referohemi diçka që do të ndodhë në të ardhmen. Pra, kontrollet do të jenë periodikisht në të ardhëm, nuk mund të kontrollohet periodikisht në të shkuarën. Pra, çështja që shtrohet është që do të kontrollohet që ta japin pëlqimin për të kontrolluar vetëm në të ardhmen dhe çfarë ka ndodhur në të shkuarën nuk përbën më objekt

kontrolli? Është e shkruar në Kushtetutë, dhe, në qoftë se është kështu, kjo duket sikur nuk do të kontrollojë se çfarë ka ndodhur më parë.

Fatmir Xhafaj - Ideja është se kush është kandidat kështu siç është sot, se si mund të jetë, mund ta propozoni.

Oerd Bylykbashi – Jo, të shkruar po flas. Kontroll periodik, do të thotë në të ardhmen.

Fatmir Xhafaj - E riformuloi edhe zoti Majko, për ta përmbledhur dhe për ta pastruar këtë gjë, dhe m'u duk interesante, por koncepti është që një njeri, para se ta emërojë këshilli, duhet të bëjë këto dy gjëra.

Së pari, t'i nënshtrohet kontrollit të identifikimit të pasurisë, jo kontrollit periodik dhe kontrollit të posaçëm, sepse është gjyqtari i Gjykatës së Posaçme dhe, së dyti, të japë pëlqimin për disa kufizime në të drejtat dhe liritë e tij. Ky është koncepti i kësaj, gjithsesi, kur ta riformulojmë, duhet parë te ligji dhe pastaj jam dakord.

Oerd Bylykbashi - Kam edhe unë një propozim, por nuk ia vlen, sepse duhet ta përmbyllim këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – Po, duhet ta përmbyllim.

Fatmir Mediu – Çka po pretendon Oerdi, ka të bëjë me pjesën përpara, sepse...

Fatmir Xhafaj – Kishte arritur në një pikë të përbashkët, pak a shumë.

Fatmir Mediu – Dakord, por është një shqetësim.

Fatmir Xhafaj – Dakord, thujeni, ju lutem!

Fatmir Mediu – Në qoftë se do të flasim për gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme, do të merremi vetëm me dakordësinë e gjyqtarit për periudhën pasi emërohet, apo edhe përpara se të emërohet?

Fatmir Xhafaj – Pasi emërohet.

Fatmir Mediu – Por, në qoftë se do të flasim për para se të emërohet, mendoj se...

Fatmir Xhafaj – Dakordësi është që ai të jetë i ekspozuar, të jetë i politizuar në lirinë dhe të drejtat e tij.

Fatmir Mediu – Në procesin e...

Fatmir Xhafaj – E ka pasi emërohet. Pasuritë e tij janë verifikuar periodikisht.

Fatmir Mediu – Në procesin më pas, po. Po në procesin përpara do të ketë një investigim?

Fatmir Xhafaj – Patjetër, këtë ka pasur parasysh ligji, që nuk emëroresh në qoftë se nuk i nënshtrohesh këtij kontrolli.

Fatmir Mediu – Në qoftë se ti nuk i nënshtrohesh këtij kontrolli, kjo është me dakordësinë e këtij gjyqtarit, dakord?

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se ai nuk jep dakordësi për këtë, nuk hyn për të kandiduar.

Fatmir Mediu – Unë po flas për atë që ndodh më parë me gjyqtarin, jo për atë që do të ndodhë më pas.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, në momentin që ai do të kandidojë, është i detyruar t'i nënshtrohet këtij kontrolli të posaçëm për një Gjykatë të Posaçme, për Prokurorinë e Posaçme. Kjo është logjika. Më pas, ai do të jetë në kontroll permanent, do të ketë një status të veçantë për sa kohë që Gjykata e Posaçme do të ketë një status të posaçëm edhe ndaj tij.

Gjithsesi, rishikojeni formulimin dhe, nëse ka ndonjë gjë që ta...

Urdhëroni, zoti Majko!

Pandeli Majko – Çështja e dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve, por po qëndroj te telekomunikimet. Unë mendoj se duhet parë jo vetëm nga logjika që këta njerëz do të kenë privatësi, por do të jenë edhe njerëz nën një mbrojtje të veçantë. Tani të jemi të sinqertë, të gjithë anëtarët e gjykatës së posaçme do të jenë nën presionin e influencave të politikës, të qeveritarëve, tonat me një fjalë. Ju e dini se si funksionon kjo histori në Shqipëri: të rregullojë gruan, të rregullojë fëmijën, të çojë një dhuratë, ekzistojnë te ne këto gjëra, të mos na duken çudi. Prandaj, këta njerëz, në qoftë se do të pranojnë të hyjnë në gjykatën e posaçme, këta janë *watchdog*-ët tanë, do të jenë mekanizma shtetërorë për kontrollin e klasës politike dhe të institucioneve të shtetit shqiptar, do të jenë nën kontroll të veçantë për t'u mbrojtur dhe për të mos rrëshqitur.

Fatmir Mediu – Ky shqetësim nuk mund të zgjidhet dot siç është shkruar.

Fatmir Xhafaj – A keni ndonjë gjë tjetër për nenin 25?

Nuk keni.

Oerd Bylykbashi – Nuk e di se çfarë mendojnë ekspertët në lidhje me problemin...

Fatmir Xhafaj – Po, do t'jua jap fjalën.

Ta mbyllim ne një herë.

Oerd Bylykbashi – Dua të shtroj pyetjet për atë që kam nevojë unë.

Fatmir Xhafaj – Ju i shtruat pyetjet dhe besoj se ata i mbajtën shënim.

Oerd Bylykbashi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Keni pyetje shtesë?

Oerd Bylykbashi – E përjashtoj në qoftë se nuk i japin përgjigje.

Fatmir Xhafaj – Ua jep edhe kështu. Kam përshtypjen që zoti Smibert ka diçka.

Jon Smibert - Disa pika fillimisht. Neni 135, paragrafi i fundit është i gjithi për gjyqtarët që do të jenë në gjykatën e posaçme për veprat penale të korrupsionit. Si gjyqtarët ashtu dhe prokurorët e posaçëm kanë hequr dorë, dhe gjithashtu kanë dhënë pëlqimin që një organ tjetër të shikojë llogaritë e tyre bankare e herë pas here të kontrollojë, si edhe të dëgjojë rastësisht telefonat e tyre celularë. Për sa i përket telekomunikacionit, përgjimi i anëtarëve të ngushtë të familjes në këtë rast është për shkak se anëtarët janë duke folur më shpesh me gjyqtarët dhe është një mënyrë vetëdije që ata kanë për nënën, babanë, ose vëllanë e tyre, ose kushdo që është duke jetuar me to, ndaj telefonat e tyre mund të përgjohen. Është një çështje reale e kohës së sotme kur ekzistojnë aplikacione të tilla *si whatsapp, viber*. Është efektive pasi ne e dimë se si në pjesën e prokurorisë jeta është bërë më teknologjike dhe shumica e gjërave kalon prej valëve. Mendoj se kjo do të krijojë një pengesë mjaft të vlefshme për njerëzit që të telefonojnë një gjyqtar e t'i kërkojnë që të dalë për kafe. Një çështje tjetër të cilën dua të sqaroj, për shkak ndoshta dhe nga përkthimi, është kufizimi që u është vënë zyrtarëve të nivelit të lartë. Nuk është plotësisht e qartë ndoshta nga përkthimi, por ky është një kufizim. Nuk është i përkohshëm, por do të përfshijë vetëm krimet e rënda. Thjesht desha të dija a po e kuptoja qartë.

Rainer Deville – Më lejoni të kaloj shkurtimisht gjatë paragrafëve. Neni 135 paragrafi i parë për Gjykatën e Lartë Administrative është me të vërtetë vendim politik që duhet të merrni dhe duhet të na tregoni se cili është vendimi juaj në mënyrë që Kushtetuta të draftohet në një mënyrë apo një tjetër. Ju keni shkëmbyer të gjitha mendimet tuaja në lidhje me këtë, por mendoj se duhet të marrim një vendim. Në paragrafin tre ishte sugjerimi i Komisionit të Venecias që zyrtarët e nivelit të lartë duhet të përkufizohen më me detaje. Sigurisht që mund të vendosni të kaloni pjesën tjetër të pikave 3,4, në ligjin zbatues, por mendoj se ka një arsye të mirë pse është vënë këtu - sepse ishte një kërkesë e Komisionit të Venecias kështu që duhet lënë aty. Në paragrafin katër ju duhet të bëni kujdes që votimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor për të shkarkuar gjyqtarët është vetëm kur duhen pushuar nga puna për sjellje të rënda, kështu që nuk është vetëm një çështje e llojit që nëse unë kam shumicën i shkarkoj ata nga detyra. Është një lloj sanksionimi disiplinor i shkeljeve të rënda, kështu që kjo pjesë duhet të qëndrojë. Ajo që kemi ndryshuar

është një kuorum më i lartë që ata të shkarkohen në vend që të emërohen. Ky ishte ndryshimi. Për telekomunikimin kjo është bazuar mbi standardet dhe përvojat e Kroacisë dhe Rumanisë, dy modele të suksesshme, ku njerëzit nuk dëgjojnë se çfarë bëjnë ata gjatë gjithë kohës, por dëgjojnë në mënyrë rastësore, dhe nëse diçka provohet ata dalin nga sistemi. Pra, e drejta e privatësisë është e garantuar gjatë zbatimit të legjislacionit, por sigurisht që duhen të kontrollohen. Këta njerëz duhet të kenë besimin e publikut se ata janë personat e duhur për të luftuar korrupsionin dhe ky është një mjet i bazuar në një model shumë të suksesshëm. Kjo duhet të jetë në Kushtetutë, sepse e drejta e telekomunikacionit i përket të gjithëve dhe për këtë duhet të merret pëlqimi i personit që do punojë në këto zyra. Nga eksperiencia e shteteve të tjera kjo përbën një standard pune. Kështu duhet të veproni edhe ju dhe ta përfshini në Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi, riformulimi do ta pastrojë nga fjalët e tepërta. Për shembull, nuk arrij dot ta kuptoj se pse duhet ta shkruani, që gjyqtari i Gjykatës së Posaçme, në gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar emërohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përputhje me këtë dispozitë, si dhe me ligjin. Kjo është e gjitha shprehje parazitare, sepse nuk ka njeri që nuk emërohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për sa kohë që u shërben gjykatave. Prandaj, duhen pastruar, sepse janë disa shprehje që nuk mund të rrinë në Kushtetutë, për sa kohë që nënkuptohen.

Vazhdojmë me nenin 26, që ka të bëjë me ndryshimin e nenit 136. Kush ka për të folur, zoti, Mediu, zoti Majko?

Fatmir Mediu - Unë do të flas shkurt për disa nga çështjet me paragrafët përkatës.

Së pari, në paragrafin e parë, thuhet që anëtarët e Gjykatës së Lartë Administrative, emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për një mandat 9-vjeçar pa të drejtë riemërimi. Ne i kemi vendosur presidentit 7 ditë afat për marrjen e vendimit pas propozimit të bërë nga ky Këshill, por, në gjykimin tim, 7 ditë është një kohë relativisht e pamjaftueshme që presidenti të mbledhë të gjithë informacionin e domosdoshëm për propozimet, dhe të dalë në një përfundim për kundërshtimin ose miratimin e kandidaturave.

Së dyti, ne i vendosim afat presidentit të Republikës pas propozimit, por mendoj se duhet që t'i vendosim afat edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor pas mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, në mënyrë që të mos krijojë tejzgjatje dhe vazhdim të punës së anëtarit të Gjykatës së Lartë, për shkak të historive të ndryshme që mund të ndodhin në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Pra, histori të cilat ne i kemi ndeshur dhe duhet patjetër që t'i shmangin. Në qoftë se i

vendosim afat presidentit të Republikës, mendoj se duhet vendosur edhe një afat pas mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, se kur duhet të shprehet Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Fatmir Xhafaj – Do ta bëjmë me ligj atë.

Fatmir Mediu - Meqenëse e kemi shprehur në Kushtetutë për presidentin, besoj se...

Fatmir Xhafaj – Dakord, propozimi është racional, por kemi procesin e emërimit dhe jo të përfundimit të mandatit.

Fatmir Mediu – Gjithashtu, kemi një problem sa juridik, politik aq edhe publik, që ka të bëjë me rastin kur presidenti i Republikës kundërshton një nga anëtarët ose propozimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, thuhet që ka të drejtë të kundërshtojë një herë, dhe ky këshill vendos me shumicë se do ta konsiderojë serioz kundërshtimin e presidentit, dhe automatikisht quhet i emëruar. Unë mendoj se përcaktimet duhet të jenë shumë të qarta, në rast të një refuzimi nga presidenti i Republikës, dhe në rast se kemi një vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në kundërshtim me atë çka shprehur presidenti i Republikës. Mendoj se krijojmë një precedent ose një debat në opinionin publik shumë të pavlefshëm, për sa i përket integritetit që duhet të ketë anëtari i Gjykatës së Lartë. Kështu që, duhet gjetur një mënyrë e sjelljes së KLGJ-së jo me votim, në rast të refuzimit të presidentit të Republikës. Pra, është një situatë e cila kërkon zgjidhje, dhe refuzimi nga presidenti i Republikës, autoritetit të parë të vendit, me një votim të KLGJ-së për miratimin ose jo të propozimit të presidentit të Republikës, mendoj se krijon një impakt jo pozitiv në opinionin publik.

Për sa i përket pikës 5, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes të anëtarëve të Gjykatës së Lartë...

Më falni, sepse është pika 4. “Anëtarët jogjyqtarë, nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale dhe nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike.” Unë e kam shprehur më parë dhe e rishpreh me forcë qëndrimin tim, se ky është një qëndrim populist dhe i pavlefshëm, që njerëz të politikës nuk duhet të jenë në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, apo në nivele të tjera të gjyqësorit. Mendoj se në politikë ka njerëz me integritet, dhe qasja politike nuk ka të bëjë me ushtrimin e funksionit, sepse ushtrimi i funksionit ka të bëjë me respektimin e Kushtetutës dhe të ligjit, dhe në momentin kur ti merr një autoritet, në një pozicion të caktuar të gjyqësorit, në atë moment ndërpritet veprimtaria politike dhe ti ushtron detyrën bazuar mbi Kushtetutën dhe ligjin. Është një lëvizje populiste që bëhet nga ana jonë, me qëllim që të themi se nuk e duam politikën, sepse ajo e bën çdo gjë keq. Padyshim,

që politika ka problemet veta, por ne sot po diskutojmë dhe analizojmë gjyqësorin, dhe vetëpërrjashtojmë politikanët për të qenë të mundshëm, për të qenë anëtarë të Gjykatës së Lartë apo të Gjykatës Kushtetuese. Kjo, mua nuk më duket racionale dhe këtë ua kam thënë kolegëve të mi, e kam thënë këtu, dhe po e përsëris që ky është një qëndrim të cilin unë kërkoj që ta analizojmë pak më tepër dhe të bashkohemi që nuk duhet të ndodhë kështu.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë propozoj që në nenin 26, në paragrafin i parë, po e lexoj që të jem më i qartë për kolegët:

“Anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative, emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi”. Deri këtu është në rregull. “Presidenti i Republikës brenda 7 ditësh”, këtë 7-ditësh unë propozoj që ta zëvendësojmë me 10 ditë, nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që propozon, jo që emëron, anëtarin e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Administrative...

Paragrafi i dytë, “Presidenti i Republikës mund të mos e pranojë kandidatin e propozuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për shkak të mosplotësimit të kushteve të zgjedhshmërisë, të mosrespektimit të procedurës së ndjekur në përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve, ose mosplotësimit të kriterëve të kualifikuara të parashikuara në ligj” dhe pastaj gjithçka tjetër është siç është e shkruar në ligj, vetëm duke ndryshuar 7- ditshin ta bëjmë brenda 10 ditëve. Pra, ajo që dua të them është se Presidenti të kufizohet vetëm në grupin e parë të shkaqeve të mosplotësimit të kushteve të zgjedhshmërisë, sepse të tjerat në thelb janë të ankimueshme në gjykatë.

Gjithashtu, propozoj që në paragrafin e tretë të ndryshohet shifra e viteve të përvojës, ku nga 13-vjet të bëhet me 15-vjet përvojë dhe 1\5-ta e anëtarëve mund të zgjidhen mes juristëve më të spikatur me jo më pak se 15-vjet përvojë si avokat, profesor, ose lektor i së drejtës, por unë propozoj që nga 15-vjet të bëhet 20-vjet përvojë.

Po ashtu, propozoj që paragrafi i fundit të hiqet fare, për arsye se gjithçka është e nënkuptuar në paragrafin e parë dhe do të ishte shumë disproporcionale shkrimi i një fjalie të tillë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Në paragrafin e katërt, “anëtarët jogjyqtarë”, do ta zëvendësoja, “me kandidatët, të cilët nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale,” vazhdoj “kandidatët

jogjyqtarë nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10-vjetëve të fundit përpara kandidimit.”

Paragrafin e pestë e lëmë siç është, kurse në paragrafin e 6 – të, në fjalinë e parë propozoj: “Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative, zgjidhen me shumicën e anëtarëve të secilës gjykatë me votim të fshehtë dhe për një periudhë 3-vjeçare pa të drejtë rizgjedhje”. Në të gjithë paragrafin me të kuqe, që është fjalia më poshtë, “në rast se asnjë prej kandidatëve nuk merr në votimin e parë shumicën e kërkuar etj, ”, mendoj se këto mund të përfshihen në ligj, dhe nuk ka pse ta mbingarkojmë Kushtetutën me detaje të tilla.

Për paragrafin e shtatë propozoj dhe po e citoj: gjyqtari i Gjykatës së Lartë ose i Gjykatës Administrative, qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit dhe jo deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar. Mendoj se do të ishte më e saktë: gjyqtari i Gjykatës së Lartë ose Gjykatës Administrative qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 1, nënparagrafët c, ç, d, dh, dhe e”.

Këto janë propozimet e mia.

Fatmir Mediu - Po ndjek logjikën e zotit Majko. Për një mijë arsye, KLGJ-ja mund ta zvarrisë pa fund propozimin për anëtarë të gjykatës dhe kjo do të thotë që tejkalohet, dhe kemi raste, mandati i anëtarit të Gjykatës së Lartë në këtë pozicion. Mund të ndodhë konflikti midis KLGJ-së me Presidentin e Republikës, kështu që, unë mendoj se termi “kohëzgjatja e mandatit” duhet përcaktuar sa më saktë. Më mirë të vendosësh një vakancë që të detyrojmë KLGJ-në dhe Presidentin e Republikës të marrin vendim, sesa ta lëmë të papërcaktuar deri në zëvendësimin nga propozimi, siç tha zoti Majko.

Për sa i përket afatit, dhe po i kthehem paragrafit të parë, 7 apo 10 ditë, kjo do të thotë që Presidenti i Republikës me korrespondencë zyrtare për 10 ditë duhet që të marrë informacione nga disa institucione, për emrat që propozohen dhe nga pikëpamja kohore, 10 ditë, është e pamundur që të marrësh të gjithë informacionin si dhe vendimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, e rregullojmë, por e kemi vënë 7 ditë dhe zoti Majko thotë që ta bëjmë 10 ditë, kurse unë po ju them që nga pikëpamja e praktikës administrative është e pamundur, mund të ndodhë që institucionet të mos përgjigjen në kohë edhe për qëllime të caktuara, siç ka ndodhur, dhe të mos jepet informacioni i duhur, dhe në raport të interesave politike, Presidentit të Republikës të marrë qëndrim. Pra, duhet parë i gjithë zinxhiri i veprimit në kohë, i Presidentit, i

Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe i një strukture shtetërore për të dhënë përgjigje në kohë dhe detyrim me ligj në qoftë se nuk i përgjigjen. Gjithashtu, jam kundër idesë 20 vjet, sepse a e di se çdo të thotë të qenit avokat 20 vjet, sepse nuk ka asnjë që ka mbaruar, dhe janë të rrallë ata dhe kanë qenë në pamundësi për të zënë një funksion gjyqësor apo diku tjetër, që janë bërë avokat menjëherë. Pra, shumica e tyre nuk i kanë pasur ato kritere për të qenë gjyqtarë apo në pozicione të tjera, prandaj kanë filluar punë si avokat dhe 20-vjet të çon te periudha e ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve të kohës së regjimit komunist, për të qenë të mundur që të zgjidhen anëtarë të Gjykatës së Lartë. Unë mendoj se, të paktën për ne si opozitë kjo është e papranueshme.

Pandeli Majko – Kolegë, këtë punën e komunizmit, të mos e radikulizojmë në këtë pikë. Jemi në vitin 2016. Sa vjeç ka qenë prokurori më i ri i komunizmit, prandaj të bëjmë një matematikë dhe të mos e bëjmë sistemin tonë sikur do të shkruajmë parullën” “Mirë se erdhët inkuzitorë të dashur, në sistemin e drejtësisë”. Kemi ligje të natyrave të ndryshme, të cilët ngado që ta marrësh, nuk do të lejojnë të ndodhin histori të çuditshme, duke futur në sistem ish-prokurorë apo ish-gjyqtarë të komunizmit të cilët kanë bërë namin.

Fatmir Mediu - Ka sot, dhe nuk po hyj në vlerësimin apo meritën e gjithsecilit. Logjikisht, nga pikëpamja politike, mendoj se është e papranueshme për ne, që pas 25 – vjetësh t’i rikthehemi përsëri asaj çështje. Këtë kam shqetësim dhe po e ngre, sepse po na kthen në vitin 1991.

Pandeli Majko – Ne mendojmë se Kushtetuta është një ligj *part time*, që bëhet për vitin 2016, maksimumi vitin 2017, kur janë edhe zgjedhjet elektorale?! Kjo Kushtetutë që po bëjmë ne do të jetë të paktën me një vokacion 20-vjeçar.

Fatmir Mediu - ...20 - vjeçarin për të ardhmen, jo 20-vjeçarin për të shkuarën.

Pandeli Majko - Për 20 - vjeçarin e ardhshëm pra, bëjeni llogari mirë. A e kuptoni se në çfarë terreni po flasim?!

Fatmir Xhafaj - Zoti Mediu, logjika e zotit Majko është kjo, që nuk mund të shkojë në Gjykatë të Lartë dhe as nuk mund të jetë dot një lektor i shquar, edhe nëse i ka mbaruar të gjitha, edhe jashtë shtetit në moshën 25 vjeç i mbaron, siç, plus 20 vjet punë bëjnë 45 vjeç, dhe nëse ne e bëjmë, do të thotë që 40 vjeç mund të shkojë në Gjykatë të Lartë, por ai nuk është bërë as jurist i shquar dhe as avokat i shquar. Kjo është logjika, por në qoftë se doni, hiqjani, sepse nuk është problem, por për mua më mirë vini një dysheme dhe thoni që po nuk qe 50 vjeç nuk shkon në Gjykatë të Lartë, që të paktën të ketë përvojën e jetës.

Fatmir Mediu - Atëherë, lini vetëm gjyqtarë dhe mos i futni. Doni ta thjeshtoni...

Zoti Xhafaj, po ju them një problem i cili ka qenë më parë, dhe uroj që të jetë zgjidhur. Ata që kishin mbaruar, dhe nuk po zë universitet të caktuar, këtu që merreshin diplomat pa meritë, në qoftë se e kishin mesataren mbi 9-të, kishin të drejtë për të vazhduar Shkollën e Magjistraturës për t'u bërë gjyqtarë.

Fatmir Xhafaj - Është tjetër temë ajo.

Fatmir Mediu – Jo, sepse do të them pse-në. Këta bëheshin të shquar, për shkak të mënyrës se si penetrohej në sistem, në paaftësinë e tyre dhe paaftësinë e sistemit tonë për t'i kontrolluar. Një që mbaronte në Francë, në shkollat më të mira juridike, me mesataren 8 –të nuk kishte mundësi që të hynte në Shkollën e Magjistraturës dhe uroj të jetë ndërruar, sepse ishte vendosur si kriter mesatarja, dhe niveli është kaq disporcional, sepse ka njerëz të tillë të talentuar, që nuk mund të përjashtohen qoftë edhe për efekt moshe. Mund të ketë përjashtime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Petrit Vasili - Ne kemi një version në këtë draft pune, ku kemi dy propozime alternative, rastin e Zotit Majko, si dhe atë për të cilën zoti Mediu nuk bie dakord. Secili ka formuluar bindjet e veta për këtë punë dhe ne kemi për ta diskutuar, votuar këtë çështje, prandaj të futemi dhe të themi po kemi dakordësi për të njëjtin propozim dhe po qe se nuk kemi, i ikim tutje, sepse ideja që t'i mbushim mendjen njëri – tjetrit është ide joracionale, sepse gjithsecili është i motivuar në propozimin që ka. Ne kemi një draft pune, dhe ky draft kërkon 13 vjet, ka një propozim për 15 vjet, dikush tjetër mund të mos jetë dakord, por duhet të biem dakord se cila është dakordësia në këtë pikë, është te kjo, te kjo, apo te kjo. Kështu ne fitojmë kohë, sepse u rikthye apo jo komunizmi, jo do të na futet diktatura apo jo, sepse ne e dimë fare mirë se si ka hyrë diktatura, si del diktatura dhe bëhemi qesharakë për këtë punë. Ne e dimë se ku hyn diktatura dhe ku nuk hyn diktatura. Meqë unë dhe ti jemi nga nga 60 vjeç, paskemi hyrë në diktaturë, këto janë muhabete kot. Ne kemi një propozim konkret prandaj të themi i qëndrojmë ose jo, dhe po nuk kemi dakordësi, mbetemi te drafti i punës që na ka ardhur. Duhet që të bëjmë pak më përpara, se po rrimë në vend.

Fatmir Xhafaj - Fjalën e ka zoti Bylykbashi dhe pastaj zonja Hysi.

Oerd Bylykbashi - Në lidhje me këtë çështje, problemi i parë që ne gjykojmë është fakti që Presidentit të Republikës së Shqipërisë i është kufizuar një rol, qoftë edhe formal në lidhje me emërimin e gjyqtarëve, vetëm te gjyqtarët e gjykatave të larta, ndërkohë që është hequr

kompetenca e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, që me propozime që vijnë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, të ketë edhe ai mundësinë që të shprehet në lidhje me faktin, nëse një gjyqtar i plotëson kriteret, pra, një gjyqtar i cili mund të jetë dukshëm i papranueshëm për t'u emëruar. Unë besoj se kjo zgjedhje, duke e limituar Presidentin dhe duke ia hequr këtë mundësi, nuk mbështetet as nga ajo që thotë Komisioni i Venecias, i cili thotë se ndërkohë që kemi diçka që vjen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, roli i Presidentit mund të ruhet. Pra, ai duhet ta ketë mundësinë dhe pushtetin për të refuzuar kandidatët që janë dukshëm të papërshtatshëm. Në këtë kuadër, është problematike vendosja e afatit 7 ditor, sepse është një kufizim për Presidentin e Republikës, i cili brenda 7 ditëve duhet të ketë mundësinë që të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm për të bërë një gjykim të informuar, nëse gjyqtari të cilin ai do ta dekretojë, qoftë ky kufizim që ne gjykojmë se nuk është i duhuri, gjyqtari i përmbush këto kushte apo jo, dhe për rrjedhojë të shprehet me veto brenda 7 ditëve. Kështu që, kjo duhet marrë përsëri në konsideratë, në mënyrë që ne të kemi diçka që nuk është thjesht një proces fals, por të jetë një moment i rëndësishëm kushtetues.

Po kështu, te paragrafi i dytë, Presidentit të Republikës i është hequr mundësia që të shikojë edhe probleme në lidhje me procedurën.

Pra, duhet që Presidenti i Republikës të ketë mundësinë që të hyjë dhe të shikojë edhe elemente të tjera, dhe jo vetëm te ky kufizim që i është bërë këtu, për mosplotësimin e kriterëve të kualifikimit, ose në kushte të pazgjedhshmërisë, të kandidatit të parashikuar në Kushtetutë. Pra, duhet të shikojë më gjerë se sa aq, në përputhje me atë që thotë edhe opinionin final i Komisionit të Venecias. Pra, na duhet të shikojmë më me shumë kujdes kompetencat e Presidentit të Republikës në emërimin e gjyqtarëve jo vetëm të gjykatave të larta, por edhe në nivelet më poshtë. Nuk ka asnjë arsyetim pse duhet të hiqet, dhe në çdo rast, duke ruajtur pjesën...

Fatmir Xhafaj – Nuk kemi pse një ligj që nuk e ka sot Kushtetuta, t'ia japim nesër.

Oerd Bylykbashi - Gjithashtu, ka një lloj kufizimi i cili është problematik në dy aspekte. Siç është e parashikuar këtu, është dhënë thjesht e drejta e një vetoje, dhe më pas kjo është e rrëzueshme me votim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, por si rregull, vetoja rrëzohet me një shumicë më të lartë sesa shumica absolute, nëse kjo do të pranohet, sepse kështu siç është, është gabim. Dekreti i Presidentit nuk mund të rrëzohet me të njëjtën maxhorancë, me të cilën është bërë ai propozim. Në këtë aspekt ne duhet ta shikojmë nëse duhet thjesht ta limitojmë në këtë

fazë apo vetoja e Presidentit i Republikës ka një efekt definitiv, në lidhje me propozimin që është bërë. Kështu që, për të bërë një përshtatje në përputhje edhe me është modelin europian, i gjithë ky grup duhet riparë me kujdes.

Çështja nëse gjyqtarët e Gjykatës së Lartë duhet të vijnë edhe nga jashtë sistemit, besoj se kjo është çështje e debatit politik të cilin Partia Demokratike e ka pozicionuar qartë.

Prurja e gjyqtarëve nga jashtë sistemit, për më tepër në një masë të konsiderueshme, siç parashikohet, në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën e Lartë Administrative, nëse kjo do të mbetet, bie ndesh me atë që është synimi për ta profesionalizuar sistemin gjyqësor. Duke sjellë persona nga jashtë, rritet mundësia për të politizuar sistemin. Pra, bie ndesh me atë që është qëllimi, me të cilin ne po e spostojmë Gjykatën e Lartë, nën Këshillin e Lartë Gjyqësor. Kjo është një çështje të cilën e kemi ngritur dhe besoj se duke e zgjidhur këtë, bie edhe debati, zoti Majko, në lidhje me gjyqtarët që vijnë. Pra, t'ia çojmë 20-vjet dhe të themi dhe se kush dekan i kohës së komunizmit ka nxjerrë atë person, i cili u bë prokuror në vitet e fundit të periudhës së komunizmit dhe për rrjedhojë, për zell, ishte edhe më i egër. Zoti Majko, këto janë fakte që i dinë shqiptarët, dhe unë nuk besoj që koha që kalon e pastron atë lloj zullumi të asaj kohe.

Një çështje tjetër që duhet mbajtur, dhe unë e mbështes siç edhe herën e kaluar zotin Mediu, është që duhet ta shikojmë me kujdes çështjen e afatit 10-vjeçar, në mënyrë që të jetë diçka që të ketë proporcion. Ky nuk është rasti, sepse ky diskutim u bë në rastin e Gjykatës Kushtetuese, por këta persona po barazohen me kriminelë, të cilët dënohen me mbi 2 vjet, dhe për rrjedhojë ndalohen 10 vjet për të ushtruar funksione publike, dhe në çdo rast t'i vendosësh dhe t'i barazosh në të njëjtin paragraf, kriminelët dhe ata që kanë bërë politikë, zoti Pandi, unë besoj se juve duhet t'ju shqetësojë.

Mendoj se përveç faktit që paragrafi i pestë referon te kriteret dhe procedura, ndërkohë që duhet të bëhen me ligj, dhe besoj që në ligj duhet të jetë një minimum, për sa u përket kriterëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sepse t'ia delegosh të gjithë ligjit, mundet të krijojë probleme të tjera, por, megjithatë, ta diskutojmë dhe të gjejmë zgjidhjen më të mirë në lidhje me këtë.

Paragrafi i gjashtë ka të njëjtat probleme, të cilat u shtruan në lidhje me zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Parashikohet balotazh, por më pas ka inkonsistencë në lidhje me mënyrën se si do të zgjidhen rezultatet e ndryshme. Parashikimi i të gjitha rasteve në

Kushtetutë është i pamundur në rastin konkret, dhe për rrjedhojë duhet gjetur një zgjidhje, sepse roli i kryetarit të Gjykatës së Lartë është rol i rëndësishëm në atë institucion.

Besoj se paragrafin e shtatë, ne duhet të shikojmë me kujdes, në mënyrë që të mos na kthehet përjashtimi në rregull. Ndryshe nga parashikimi kushtetues i derisotëm, i cili nuk e lejon mundësinë, që një gjyqtar i Gjykatës së Lartë, të vazhdojë dhe çështja është përpara Gjykatës Kushtetuese për diskutim, por ju do të thoni që mund ta bëjmë se po e rishkruajmë Kushtetutën dhe çështja që shtrohet është pse?

Fatmir Xhafaj - E ka Gjykata Kushtetuese.

Oerd Bylykbashi - Gjykata Kushtetuese e ka dhe ne e diskutuam herën e kaluar, dhe besoj se ju kujtohet, që edhe ashtu siç e ka Gjykata Kushtetuese ka një problem që mund të na çojë në kapërcime. Të njëjtat probleme mbeten edhe këtu, por nuk shikoj arsye se pse duhet që të ndryshojë nga ajo që kemi deri më sot.

Ka edhe një problem tjetër. Në qoftë se një gjyqtar i Gjykatës së Lartë, për një nga arsyet, largohet nga funksioni, këtu parashikohet që ai që do ta zëvendësojë do vazhdojë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar dhe rregulli bazë është ai 9-vjeçar. Ne kemi parashikimin që zëvendësimi bëhet deri në afatin që ka mandati që po zëvendësohet te Gjykata Kushtetuese, për një arsye shumë të thjeshtë. Aty kemi rrotacion tre vjeçar të përcaktuar dhe na duhet që ta respektojmë atë, kurse këtu nuk e kemi këtë lloj, sepse këta janë gjyqtarë të Gjykatës së Lartë. Një person e ka mandatin 9 vjeçar, dhe për arsye të përcaktuara nga Kushtetuta e humbet mandatin dhe ai që e merr atë e ushtron për 9 – vjet. Nuk ka arsye pse ai që

e zëvendëson dhe do ta plotësojë si vend, sepse nuk lidhet me asnjë rregull rotacioni. Kështu që unë besoj se edhe këtë çështje ne duhet ta shikojmë me kujdes, sepse jo vetëm që nuk ka sens, por nuk ka arsye pse të futemi në këtë lloj loje. Supozoni që një gjyqtari të Gjykatës së Lartë t'i mbarojë mandati vetëm një vit e gjysmë ose dy vjet nga fundi dhe ai që do ta zëvendësojë do të jetë vetëm për dy vjet dhe më pas do të rizgjedhim një anëtar të ri. Pse? Në këtë rast nuk është njëtrajtshmëria me Gjykatën Kushtetuese, por janë dy modele të ndryshme të funksionimit dhe qëllimit të dy gjykatave.

Zoti Pandi, sigurisht që do ta sjellim edhe këtë, por po shtrojmë problemet. Unë nuk kam ndër mend të diskutoj sot për propozimin tuaj, por po diskutoj për këtë që është këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pa merak, zoti Majko, sepse do ta depozitojmë edhe propozimin tonë.

Fatmir Xhafaj – I bëni propozimet te neni përkatës, sepse pastaj nuk mund të themi që do të sjellim një propozim dhe do t’i kthehemi përsëri nenit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Oerd Bylykbashi - Mund të gjejmë edhe marrëveshje për formulimin e përbashkët.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Fjalën e ka zonja Hysi dhe pastaj zoti Mediu.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, duhet të heqim dorë nga diskutimi i dy çështjeve për të cilat tashmë është vendosur.

Së pari, skemën e emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën e Lartë Administrative, si dhe kompetencat e Presidentit, unë i quaj probleme të mbyllura.

Së dyti, lidhur me problemin nëse duhet të ketë apo jo kandidat jogjyqtarë, është shprehur qartë Komisioni i Venecias. Unë jam dakord me propozimin e kolegut Majko, që në paragrafin e parë të nenit 136 të shtojmë periudhën që i lihet Presidentit të Republikës në dispozicion, por duhet ta qartësojmë, sepse nuk duhet të jetë nga momenti i dërgimit të propozimit prej Këshillit të Lartë Gjyqësor, as nga data e vendimit, por nga data e mbërritjes së propozimit në Presidencë. Pra, në këtë mënyrë ne shmangim çdo vonesë që mund të vijë në komunikimin midis dy institucioneve, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Presidentit të Republikës.

Me të drejtë zoti Majko bën pyetjen se çfarë do të ndodhë nëse nuk e dërgon. Në qoftë se nuk e dërgon, nuk ka se çfarë të shqyrtojë Presidenti, prandaj duhet që ta lidhim me momentin e mbërritjes dhe në ligj duhet të jemi shumë të vëmendshëm që Këshilli i Lartë Gjyqësor të ketë afate të përcaktuara qartë.

Lidhur me pikën e dytë, paragrafi i dytë i ligjit, mendoj se formulimi që ka sjell kolegu Majko është i saktë, në kuptimin që i japim të drejtë Presidentit të gjykojë, të mos pranojë kandidatët e propozuar në tre raste.

Së pari, kur nuk është respektuar procedura në përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve.

Së dyti, për shkak të mosplotësimit të kushteve të zgjedhshmërisë.

Së treti, është mosplotësimi i kriterëve të kualifikimit të parashikuara në ligj. Këto janë, dhe besoj se më tepër nuk kemi se çfarë t’i lëmë tjetër Presidentit.

Zoti kryetar, kërkoj që kur të bëhet rregullimi i afatit në paragrafin e parë, ta shikojmë të lidhur ngushtë edhe me paragrafin e dytë, sepse në fjalinë e dytë të paragrafit ka një fjali ku thuhet që, kur Presidenti nuk shprehet, kandidati konsiderohet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 10 ditëve nga data e vendimit të Këshillit Gjyqësor. Në fakt ky afat 10 ditor bie ndesh me paragrafin e parë.

Gjithashtu, kam edhe një shqetësim lidhur me atë që ngriti zoti Mediu për Shkollën e Magjistraturës. Pa dyshim që në Magjistraturë, zoti Mediu, shkojnë studentët më të mirë dhe ata i nënshtrohen një konkursi, por nga ana tjetër problemet lidhur me pranimet ose jo në Shkollën e Magjistraturës, na pëlqen apo jo, nuk zgjidhen në këtë nen, por zgjidhen në një ligj të posaçëm, aq më tepër që mosha që ju kërkoni ta ulim, ka një pasojë shumë negative. Pse? Po ju sjell rastet e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë që kanë mbaruar mandatin, dhe sot janë ende pa punë. Ku do t'i kthesh? Në rast se ata mbarojnë karrierat e tyre në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën e Lartë Administrative në moshën 40-vjeçare dhe kanë edhe 25 vjet të tjera punë, ku do të punojnë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, për Gjykatën e Lartë. Pra, ata duhet të shkojnë në Gjykatën e Lartë në moshë sa më të pjekur, që të kenë mundësi të japin më shumë dhe pastaj të mos ketë probleme se ku do të shkojnë. Ku është sot zonja Shpresa, ku janë anëtarët, kryetarët e gjykatës? Kanë mbaruar punë dhe, edhe pse janë ende në moshë aktive...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të kthehen përsëri në Gjykatën e Shkallës së Parë, në Gjykatën e Apelit? Prandaj duhet të jenë sa më të pjekur dhe të kenë krijuar edhe karrierën e tyre.

Fatmir Mediu - Nuk po i hyj diskutimit për këtë të fundit, sepse po diskutojmë me njëri-tjetrin, por po i kthehem edhe një herë çështjes në pikën tre dhe katër.

Ne po e bëjmë këtë reformë me bindjen që pushteti gjyqësor ka probleme jo të vogla, të cilat kanë të bëjnë me korrupsionin dhe paaftësinë dhe, në qoftë se ne do të nisemi vetëm nga karriera brenda gjyqësorit, do ta kufizojmë shumë gamën e përzgjedhjes së njerëzve, të cilët i kalojnë të gjithë filtrat e parashikuar në ligj për të qenë anëtarë të Gjykatës së Lartë, por edhe të gjykatave të niveleve të tjera. Pra, duhet patjetër që ne të përcaktojmë strikt kriteret se si kalohen këta filtra dhe kriteret e aftësisë, sesa ta ngushtojmë gamën te karriera brenda gjyqësorit.

Gjithashtu, i rikthehem edhe një herë pretendimit që unë ngrita, për sa i përket qenies ose jo në politikë.

Fatmir Xhafaj - Qartë, do ta rishikojmë.

Fatmir Mediu - Unë mendoj se duhet riparë.

Fatmir Xhafaj - Unë kuptoj se ju jeni që të ketë një prurje nga jashtë gjyqësorit dhe të mos jetë i kufizuar detyrimisht me një kufizim kohor në politikë. Ky është propozimi sipas jush?

Fatmir Mediu - Pikërisht kjo është.

Fatmir Xhafaj - Fjalën e ka zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, dua ta ripërsëris atë që thashë se Presidenti i Republikës duhet të ketë kompetencën siç e ka edhe sot, neni 136, pika 4, për të emëruar me dekret gjyqtarë, me propozim të cilët sot i ka KLD-ja dhe nesër do t'i ketë KLGJ-ja, me të gjitha rregulla që i vendosim ne për ta bërë. Pra, ky është një reduktim i ndjeshëm i kompetencave të Presidentit të Republikës dhe nuk shikoj asnjë lloj arsye pse duhet të ndodhë kjo.

Fatmir Xhafaj - Te cili nen i Kushtetutës?

Oerd Bylykbashi – Në nenin 136, pika 4.

Fatmir Xhafaj - E ke për gjyqtarët e tjerë, por të flasim për Gjykatën e Lartë një herë.

Oerd Bylykbashi – Jo, sepse atë e kemi dhe është shkruar këtu për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë.

Së dyti, për sa i përket afatit 7-ditor apo 10-ditor, që besoj se është më i përshtatshëm në ligj, ne mund të ndajmë një opinion të përbashkët në lidhje me këtë dhe të gjejmë më oportunin. Sigurisht që është një moment i rëndësishëm nga momenti i pikënisjes dhe zoti Majko tha që e çojmë në 10 ditë nga momenti që është marrë vendimi, por, në qoftë se vendimi shkon me vonesë, përsëri mbetemi te 7 ditët, kështu që nuk kemi zgjidhur ndonjë gjë të madhe. Ajo që është më e rëndësishme është mundësia e Presidentit të Republikës që brenda një kohe të mjaftueshme të ketë mundësi të mbledhë informacionin, i cili mund të jetë edhe një informacion që mund ta bëjë qartazi të papranueshëm kandidaturën në lidhje me integritetin që ka pasur gjyqtari. Kështu siç janë formulimet sot, edhe pse do të kishim një gjyqtar të emëruar me shumicë nga KLGJ-ja, ai nuk përmbush kushtet për të qenë një gjyqtar me integritet, sepse ka të dhëna të qarta që ai nuk është i tillë, përsëri do të na miratohet, pra do ta marrë funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në rastin konkret, por edhe më poshtë nëse do t'i japim zgjidhje çështjes që ne ngritëm.

Fatmir Xhafaj - I mbyllim këtu diskutimet. Ka disa formulime konkrete dhe biem dakord të gjithë që duhet pastruar nga fjalitë e tepërta.

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me pozicionin tonë politik, për ata që vijnë nga jashtë sistemit, unë e thashë, është edhe në dokumentet që kemi prezantuar rregullisht këtu, por marrja e personave që vijnë nga jashtë sistemit do t'ia vështirësonin më shumë KLGJ-së vlerësimin e performancës së tyre apo edhe aspekte të tjera, sepse, në qoftë se një gjyqtar është i qartë se si do të vlerësojë dikë që është avokat, lektor i së drejtës, apo funksione të tjera, si edhe noter, kjo nuk është më në të njëjtat.

Pra, janë kritere të ndryshme.

Fatmir Xhafaj - Është me kritere në ligj.

Oerd Bylykbashi - Çfarë do t'i thuash një avokati, i cili, për shkak se është penalist, ka raporte shumë të rregullta me individë që kanë qenë apo janë elemente të spikatura të botës së kriminit? Si do ta vlerësojmë atë pjesë?

Fatmir Xhafaj – Je avokat, nuk je shok i kriminelit.

Oerd Bylykbashi - Ky është një element tjetër. Ata të cilët do të bënin vlerësimin e një noteri apo një avokati, po ashtu duhet të kenë interesin që ta bëjnë më të mirë vlerësimin e avokatit. Kështu që duhen parë me kujdes edhe këto.

Fatmir Xhafaj - E mbyllim në qoftë se nuk kemi ndonjë gjë të veçantë.

Pandeli Majko - Në dijeninë time, në ligjin që është në fuqi, përfaqësuesit që vijnë nga jashtë sistemit është në kufijtë e 1\4 –s, kurse në projekt-Kushtetutë propozohet për 1\5-s. Ky ishte komenti.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

E mbyllim këtu këtë dhe vazhdojmë me nenin 27, ku pas nenit 136 shtohet neni 136, germa “a” me këtë përmbajtje...

Dakord, zoti Rainer, keni ndonjë merak të veçantë.

Rainer Deville - Për nenin 136 ka një çështje të cilën nuk e kemi mbuluar. Në qoftë se gjyqtari ka një mandat prej nëntë vitesh dhe më vonë do të bëhet anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, çfarë do të ndodhë me këtë mandat 9 vjeçar për shkak se Këshilli i Lartë do të jetë një punë me kohë të plotë në të ardhmen kështu që ndoshta duhet...

Fatmir Xhafaj- Dakord, por kam përshtypjen se do ta zgjidhim kur të shkojmë te Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nuk jua plotëson ajo?

Rainer Deville - Presidenti në këtë format të ri kushtetues ka vetëm një kontroll formal kështu që ai nuk kontrollon integritetin apo përfshirjen politike, prandaj kohëzgjatja është e shkurtër. Kriteri objektiv “edukim juridik” është vendosur dhe më pas ekziston mundësia për të shqyrtuar këtë pjesë në funksion të parimit të kontrollit dhe balancave. Por ky është thjesht një kontroll formal, asgjë më shumë dhe nuk ka të bëjë me ndonjë lloj vlerësimi apo ndonjë gjë tjetër. Kjo është pjesë e reformës.

Faleminderit, edhe zotit Deville për komentet dhe besoj se u mirëkuptuam në lidhje me ndërhyrjen e parë që ai dëshironte të bënte, që dëshiron ta lëmë për ta diskutuar te Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe, nëse nuk na e plotëson atje këtë kërkesë tuajën, e rikthejmë këtu, prandaj unë them që ta lëmë të hapur, por unë besoj se ne mund ta zgjidhim nga pikëpamja e formulimit kushtetues.

Vazhdojmë me nenin 27.

Oerd Bylykbashi - Nuk kam vërejtje thelbësore dhe besoj se kriteret këtu janë të përgjithshme dhe i delegohet ligjit që kriteret të tjera në përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve të jenë të parashikuara aty. Duke qenë se këto kriteret që kemi vënë, që të jenë vetëm shtetas shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak, janë kriteret të përgjithshme, nuk kemi diçka më të detajuar, dhe çështja është për kujdesin që duhet bërë në përcaktimin e kriterëve të tjera, të cilat mund të jenë problematike.

Po i kthehem vetëm një moment pikës 5 të nenit 26, sepse ndoshta është e rëndësishme, vendosja e kriterëve dhe administrimi i kriterëve me ligj. Vazhdimësia dhe kushtet për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë përcaktohen me ligj. Ata e kanë mandatin 9-vjeçar dhe duket sikur me ligj mund të përcaktohen kushte të tjera, të cilat, përveç atyre që janë mbarimi i parakohshëm i mandatit, do të çonin edhe në shkurtimin e mandatit kushtetues 9-vjeçar. Pra, kjo nënvizon nevojën e kujdesit të madh për kriteret që përcaktohen me ligj, me qëllim që të mos shkojnë në përplasje me nenet kushtetues.

Pandeli Majko - Unë kam një vërejtje të karakterit teknik për nenin 27. Propozoj që të ndahet në dy paragrafë dhe përkatësisht fjalia e parë të jetë”

“ 1. Gjyqtarët etj., etj, mund të jenë shtetas shqiptarë...” dhe vazhdon pa asnjë ndryshim. Dhe fjalia e dytë të jetë si paragraf i dytë. Kandidatët përzgjidhen sipas procedurave transparente dhe mendoj se është më mirë nga pikëpamja e teknikës juridike.

Oerd Bylykbashi – Ka çështje të tjera nga anëtarët e Komisionit? Atëherë presim kryetarin që të vazhdojmë, sepse ndoshta ka ai diçka për të thënë në lidhje me nenin 27.

Ekspertët kanë diçka? Dakord.

Vazhdojmë me nenin 28 që ndryshon nenin 137.

Zoti Majko, urdhëroni!

Pandeli Majko – Unë propozoj një riformulim të shkurtër dhe po e lexoj nenin të plotë me të gjitha ndryshimet: “Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një vepre penale, konfliktit të interesit ose keqbesimit”. Domethënë, “sjelljen kriminale” e zëvendësojmë me “vepër penale” dhe i shikoni të gjitha vetë, besoj. Domethënë, janë thjesht vërejtje të karakterit të teknikës juridike.

Fatmir Mediu – Kemi pothuajse të njëjtin diskutim si në rastin e veprimit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe mendoj që debatin që bëmë për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, duhet ta shtrijmë edhe për anëtarin e Gjykatës së Lartë. “Paligjshmëria” ndoshta nuk ka vend. Pra, të mos gjykojmë vendimin...

Fatmir Xhafaj – Dakord, e hoqëm që herën e parë.

Pandeli Majko – Në propozim është që të hiqet.

“Të një vendimi, si pasojë e një vepre penale...”

Fatmir Xhafaj - Dakord. Pas nenit 137 shtohet...

Neni 29.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Kë kemi për këtë nen? Zoti...

(Mungesë incizimi).

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, në mbështetje të asaj që tha zoti Ristani, sigurisht, unë kam propozime dhe drafte konkrete në emër të opozitës, por ...

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, të mos i ndajmë propozime të opozitës dhe propozime të maxhorancës. Këtu jemi deputetë individualë. Debatin politik e kemi bërë. Mos e riktheni në debat politik shqyrtimin nen për nen.

Oerd Bylykbashi – Nuk ka lidhje me këtë. Po ta bëj zoti Ristani...

Fatmir Xhafaj – Unë po ju them një gjë, që e kemi mbyllur diskutimin dhe do të fokusohemi te neni.

Oerd Bylykbashi – Zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Silleni nga partia...

Oerd Bylykbashi – Ajo që unë po them është se njëri nga anëtarët...

Fatmir Xhafaj – Partia Republikane, ka amendamente?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Oerd Bylykbashi – Zoti Xhafaj, e kam marrë unë fjalën, ka mundësi të vazhdoj?

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – Nuk kam riformulim, ta zëmë, për nenin 137, do ta sjell një...

Gjyqtari gëzon imunitet...

Fatmir Xhafaj – Shkruaje, thuaje, lexoje!

Oerd Bylykbashi – “Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve...”, kjo është ajo që keni ju sot, apo jo?

Riformulimi ynë: “Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij. Ai nuk mban përgjegjësi për interpretimin e ligjit, përcaktimin e fakteve, apo vlerësimin e provave që nevojiten për zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, përveçse kur vërtetohet se ai ka faj, pasi ai ka vepruar me dashje, apo neglizhencë të rëndë apo të justifikuar”.

Fatmir Xhafaj – As nen kushtetues nuk është ky. Unë të kam vlerësuar deri tani kur ke kërkuar që të kenë shkrim kushtetues. Nëse ky është shkrim kushtetues...

Oerd Bylykbashi – Një sekondë, zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – Pra, ka formulime për të cilat do të ulemi dhe do t'i rakordojmë në një të vetëm, që do të zgjidhen edhe këtu, edhe në Gjykatën Kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Mbaruam me nenin 28.

Vazhdojmë ne nenin 29. Ka propozime konkrete për nenin 29? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Keni ndonjë gjë konkrete për nenin 29?

Oerd Bylykbashi – Besoj se këtu do të vlejnjë të njëjtat diskutime që ne bëmë për dispozitën kushtetuese. Sigurisht që këtu nuk është elementi i afatit të mandatit, por mungon besoj... Do të flasim për momentet kur personi e mbaron detyrën e gjyqtarit. Ne nuk kemi

parashikuar rastin klasik, që është kur personi ndahet nga jeta dhe ky është po aq fakt juridik sa edhe pensioni, zonja Hysi.

Po kështu besoj se duhet të përcaktojmë më qartë çështjen e pamundësisë.

Fatmir Xhafaj – Të lutem!

Oerd Bylykbashi – Po kështu, referimi te një nen tranzitor në një nen permanent, nuk është i përshtatshëm, duhet të bëjmë një referim më të përshtatshëm për një nen permanent, pa referuar një nen që më pas nuk do të ketë më fuqi.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Jemi dakord me nenin 29?

Oerd Bylykbashi – Dakord, vazhdojmë.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me nenin 30.

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vetëm, ju lutem, pika konkrete!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje konkrete për ekspertët lidhur me germën “ç”, ku thuhet: “Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rastit kur vlerësohet profesionalisht nën mesataren etike ose profesionale, sipas ligjit”. Kërkoj ndjesë që e bëj këtë pyetje, por, duke mos e ditur përmbajtjen e projektligjit, do të doja të dija çdo të kuptojmë me shprehjen “vlerësimi nën mesataren etike dhe vlerësim nën mesataren profesionale”? Janë të parashikuara në ligj?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zonja Tabaku, kishit gjë për të thënë?

Pandeli Majko – Unë propozoj që germa “ç” të riformulohet duke shkruar: “vlerësohet profesionalisht sipas ligjit”. Mendoj që pjesa “nën mesataren etike ose profesionale” të hiqet. Është diçka që ne mund ta trajtojmë me të gjithë teknikën përkatëse në ligj.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ka gjë tjetër për nenin 39?

Oerd Bylykbashi – Për nenin 30.

Fatmir Xhafaj – Po, nenin 30, më falni!

Oerd Bylykbashi – Besoj se nuk është zgjidhur çështja që ngre Komisioni i Venecias. Duke zëvendësuar termin “i paaftë” me terminologjinë “nën mesataren etike ose profesionale” mbetet përsëri i paqartë si përcaktim. Por e lidhur kjo me kthimin e uljes së pagës si një masë

disiplinore, është gjithashtu... Domethënë, nuk kuptohet ku është diferenca e uljes së pagës nga masa disiplinore. Kështu që, është një çështje që mbetet e pazgjidhur nga ky draftim.

Mos harroni edhe diçka tjetër: paga është një element thelbësor i lidhur, në gjykimin tim, me pavarësinë e gjyqtarit. Ne e kemi diskutuar shpesh që niveli i pagës, përveç aspektit të pavarësisë, është edhe një instrument për të luftuar korrupsionin në sistemin e drejtësisë, është hedhur shpeshherë si ide. Nëse nuk ka definicione të qarta, futja e uljes së pagës në një masë disiplinore, gjithashtu, mund të shkonte në drejtim të cenimit të pavarësisë së gjyqtarit në ushtrimin e detyrës së tij. Kështu që, besoj se na duhet ta zgjidhim me kujdes këtë aspekt.

Dakord me germën “a”, germën “b” dhe germën “c”. Po ku është diferenca midis germave “c” dhe “ç” për uljen e pagës?

Fatmir Xhafaj – Është tjetër gjë masa disiplinore që i jepet, që mund të jetë, për shembull, zbritja në detyrë, zbritja në gradë, që rregullon ligji, është tjetër gjë vlerësimi periodik që bëjnë ata. Në qoftë se ti nuk merr maksimumin e mundshëm, nuk ke pagën e mundshme dhe përfitime shtesë, sepse, përveç pagës bazë, ne duhet t’u japim, me të drejtë, një bonus, që të rrisim përfitimet e gjyqtarit, të cilat do të jenë të kondicionuar me vlerësimin profesional dhe me karrierën e gjyqtarit. Pra, një gjyqtar që është në Shkallën e Parë, mund të marrë edhe pagën e gjyqtarit të Shkallës së Lartë nëse ai i plotëson kriteret, nuk ka masa disiplinore, vlerësohet pozitivisht në të gjithë karrierën e tij e të tjera. Sa do të shkojnë në Gjykatën e Lartë? Kemi 400 gjyqtarë? Në gjithë karrierën e tij do të shkojnë 40 veta po t’i marrim 9 me 9. Pra, në qoftë se ai ka një karrierë 40-vjeçare, domethënë i bie nga 10 në çdo 10-vjeçar, sikur t’i ndanim matematikisht, do të shkonin 40-50 veta. Atëherë, i bie që pjesa tjetër të mos ketë mundësi gjithë jetën të shkojë në Gjykatën e Lartë dhe të marrë pagën e gjyqtarit të lartë. Por unë besoj se do ta zgjidhë ligji. Në qoftë se do të kemi ndonjë gjë që nuk na përputhet, e shikojmë.

Dakord?

Oerd Bylykbashi – Çështja të bëhet e qartë, sepse paga është një element bazë, përfitimet janë diçka tjetër.

Fatmir Xhafaj – Është marrë e gjitha në tërësi, sepse ligji e sqaron.

Oerd Bylykbashi – (Nuk dëgjohet)... bën një ngatërrim me masën disiplinore.

Fatmir Xhafaj – Kemi vlerësimin periodik që bëjmë, e kemi edhe sot vlerësimin periodik për çdo gjyqtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, sepse, në qoftë se ti nuk ke marrë masën shumë mirë, gjatë gjithë karrierës tënde nuk e merr pagën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Edhe një herë, ka një pagë bazë, që është paga që unë marr si gjyqtar, për shembull, 1 mijë euro. Ndërkohë, një gjyqtar i Gjykatës së Lartë merr 3 mijë euro. Ai mund të jetë në Shkallën e Parë, nuk merr thjesht pagën bazë të tij, por mund të marrë pagën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Nëse këto i shtohen në llogari, ose e merr, ose e zbret. Kjo është logjika. Megjithatë, unë mendoj se ligji do ta qartësojë, por, nëse ka diçka që duhet riformuluar pak më mirë, le ta shikojmë, nuk ka ndonjë gjë të keqe. Vetë të bindemi që është bërë një formulim kushtetues, e para, dhe, e dyta, që është në interes të qëllimit. Në parim, biem të gjithë dakord për rëndësinë e pagës dhe të shpërblimit të gjyqtarëve.

Neni 31, “Mandati”.

Oerd Bylykbashi – Këtu do të flasim për mbarim para kohe të mandatit, apo për mbarim të mandatit? Është një diskutim që e bëmë edhe te Gjykata Kushtetuese. “Përfundon mandati 9-vjeçar”, por kjo dihet, sepse e thotë neni tjetër. Në qoftë se është 9-vjeçar, është 9-vjeçar dhe nuk është kusht mbarimi para kohe i mandatit. Nuk është kusht mbarimi, sepse e dimë, nuk kemi pse e replikojmë.

Atëherë heqja e kësaj do ta kthente në një nen ku gjyqtarit të Gjykatës së Lartë do t’i mbaronte mandati përpara kohe. Vazhdoj me të njëjtin koment që bëra më parë, përfshirë nenin 179/b në mënyrë specifike. Mbetet nevoja për të definuar më qartë çështjen e pamundësisë së gjyqtarit. Po kështu, te paragrafi 3, në lidhje me procedurat për zëvendësimin e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Majko, në qoftë se 179/b nuk duhet të jetë aty, nuk duhet të jetë, pikë.

Neni tranzitor nuk mund të referohet në një nen të përhershëm, e kemi diskutuar. Mund të bëhet një referim elegant e cila na jep mundësinë për ta vënë në nen tranzitor. E thash që herën që shkoi.

Fatmir Xhafaj – Qëndroi atij qëndrimi.

Oerd Bylykbashi – I qëndroj! Gjithashtu, edhe në lidhje me procedurat për zëvendësimin e gjyqtarit duhet të bëjmë kujdes në rastet e tjera më të njëjtën problematikë që të përputhemi brenda afateve të parashikuara nga Kushtetuta.

Fatmir Xhafaj – Meqenëse ky nen është i ngjashëm me atë të Gjykatës Kushtetuese, nëse ka diçka që duhet ta reflektojmë gjatë debatit që kemi bërë, ok. Në tërësi, mua më duket nen i pranueshëm, por ka dy-tre gjëra që janë trajtuar do ta shohim për ta vlerësuar.

Dakord dhe me nenin 31.

Neni 32.

Pandeli Majko – Kam një propozim.

Petrit Vasili - Të bëj një pyetje që të vazhdojmë më tej. Këtu hedhim disa variante dhe në fund mbarojmë shqyrtimin e nenit. A do t'i rikthehem për votim varianteve apo çfarë? Ta zgjidhim këtë punë në parim, ose po qe se është pjesë e diskutimit në këtë mënyrë, në qoftë se kemi ndonjë problem tjetër edhe mund ta ndjekim dhe vijmë te votimi. Për çështje të caktuar duhet të themi është ky variant, them unë diçka, thotë Oerdi, thotë diçka Pandi dhe mbaruam shqyrtimin.

Do kemi një qëndrim definitiv. Cili është? Të themi dhe variantin tjetër që në zbardhje duhet një variant i filanit, i propozuar nga filani, unë po ju them që tani, në rast se do të ecim në këtë rrugë, do zgjedhim sjellje të tjera politike. Çfarë mbaron në fund, do t'i rikthehem duke thënë se neni 25, u shqyrtua në tre variante? Do të votojmë të tre variantet dhe do të dalim me një variant përfundimtar apo do mbetemi te ajo çfarë përfunduam? Përfunduam shqyrtimin, bëme debatin. Do t'i rikthehem t'i votojmë edhe një herë tjetër? Në shumë raste kemi pasur dy-tre qëndrime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Ne po e kalojmë nen për nen. Kur ka propozime konkrete, do reflektojmë propozimet konkrete, më pas, përpara votimit në tërësi do ta rishikojmë edhe në herë draftin. Në qoftë se ka diçka që kontestohet, do ta bëjmë me votim. Jam dakord me zotin Vasili, do ta përmirësojmë të gjithë këtë debat. Duhet të jemi shumë konkret me nenin.

Zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Referuar nenit 32, janë të parashikuar rastet për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë. Në fakt, është e paqartë ku janë diferencat në nenin 29, arsyet për të cilat shkarkohet një gjyqtar. Gërmat “ç”: “Shkarkohet për shkelje të rënda profesionale ose etike në përfundim të një procedure disiplinore ose pas dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi”. Edhe gjyqtarët Gjykatës së Lartë disiplinohen njëjloj nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe

duket si një përsëritje. Po kështu: “Konstatohen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit”. Te fjala “gjyqtarit” nuk kanë bërë një diferencë. Më pas thotë “dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Pastaj kemi diskutimin në lidhje me gërmën “b”, të pikës 2 që e kemi bërë edhe te Gjykata Kushtetuese. Ulja e nivelit të garancive për të qëndruar kur dikush merret i pandehur, nuk ka një vendim gjykatë për të konstatuar flagrancën apo arrestin në shtëpi apo në burg.

Ripërsëritja qartazi që po bëjmë në nenin 29, gërmën “ç”, dhe po ashtu gërma “b” e pikës 2, ka diskutimin e çështjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese “Personat të cilët merren të pandehur, janë të prezumuar të pafajshëm, kur nuk kemi asnjë element ku ka një vlerësim gjyqësor se është gjykata ajo që ka vlerësuar masën e arrestit”.

Kishim një amendament, i cili pikërisht për këtë fakt nuk u pranua. “Pezullimi nga detyra të një gjyqtari të një funksionari publik kushtetues, kur është arrestuar në flagrancë për kryerjen e një krimi të rëndë”, siç është vrasja. Nuk ka lidhje me teorikën, por me faktin që me një prokuror, i cili të fillon jo për çështje korrupsioni, por për çështje të tjera, merr një krim të rëndë me dashje që nuk hyn te veprat e korrupsionit, nuk hyn te krimi i organizuar, ai të merr dhe të bllokoi anëtarët e Gjykatës së Lartë vetëm me faktin se e ka nisur ai çështjen. Po e ulim shumë stekën për të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë që mendon ai se dikush ka kryer një krim.

Fatmir Xhafaj – Zoti Devill, keni një koment për konfliktin e arsytuar ndërmjet nenit 29 dhe nenit 32 që po shqyrtojmë. Pse është e nevojshme të jenë me vete këto dy dispozita, dhe gërmën “b”, të pikës 2?

Rainer Deville - Kjo është një dispozitë e ngjashme me nenin 29 i cili është neni 128 i Kushtetutës dhe ne duhet të dallojmë paragrafin 1 i cili ka të bëjë me përgjegjësinë disiplinore dhe shkarkimin nga pezullimi që është një veprimtari përgatitore. Ne e kemi të njëjtën gjë në Gjykatën Kushtetuese dhe ky tashmë është një version shumë i kufizuar. Normalisht thuhet “nëse personi akuzohet” kështu që ne me të vërtetë duhet të kemi një aktakuzë me prova të mjaftueshme. Nëse dikush akuzohet me të vërtetë për ndonjë krim të rëndë, mendoj që është koha që ky gjyqtar të largohet. Kjo është shumë normale, ne madje e bëjmë këtë edhe për vepra të zakonshme. Ky është minimumi që ju keni. Kështu që në qoftë se ne diskutojmë për të shkuar më herët për pezullimin ose për të vendosur pezullimin për raste më të lehta, unë mendoj se ky

është tashmë një version shumë i kufizuar. Unë mendoj se kjo është diçka që ka të bëjë me të gjithë reformën dhe besimin e publikut te gjyqtarët. Kështu që nëse gjykatësit janë me të vërtetë nën një akuzë të krimeve të rënda, atëherë publiku pret që ky gjyqtar të pezullohet nga detyra derisa kjo të sqarohet. Besoj se edhe në këtë vend shumica e akuzave janë bazuar në një hetim të denjë me fakte të duhura dhe unë nuk besoj se në këtë vend çdo prokuror thjesht çon përpara një gjykatë një person pa ndonjë arsye. Duhet të keni parasysh se kemi bërë një gjyqësor të fortë përfshirë edhe prokurorinë, kemi krijuar një sistem të ri të bazuar në parimin e kontrollit dhe të balancave dhe të gjithë shkojnë në shkollën e Magjistraturës.

Jon Smibert - Unë mendoj se pyetja e zotit Bylykbashi ishte se pse kjo është këtu, ku njëkohësisht në nenin 29 ka një skemë të ngjashme për disiplinimin e gjyqtarëve. Pse ka një skemë të veçantë për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative? Një temë që më vjen në mendje është se gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative shpesh japin verdiktin përfundimtar në një çështje dhe nëse dikush prej gjyqtarëve të këtyre gjykatave pezullohet, kjo gjë nuk është e sqaruar mirë në nenin 29. Ky është një aspekt i rëndësishëm për ruajtjen e jurisprudencës së kësaj gjykatë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Dhanë një shpjegim shterues m'u duk, por gjithsesi po flasim për nenin 32.

Oerd Bylykbashi – Së pari, një çështje që kemi ngritur edhe radhës që shkoi është modeli ekzakt, por duke pasur parasysh që flasim për një drejtësi që po e reformojmë, sepse ka këto probleme. Përveç nevojës për t'u aftësuar më shumë ndoshta edhe kur abuzohet politikisht.

Ajo që po diskutojmë është për garanci, të cilat gjyqtarët duhet t'i kenë në ushtrimin e detyrës së tyre, ndërkohë që nuk duhet të kenë asnjë lloj imuniteti. Çfarë garancish jep ndaj një piketimi të nisur edhe me qëllim politik nga një prokuror jo i Prokurorisë së Posaçme, ndaj gjyqtarëve? Pra, ta regjistroj çështjen, ta marrë dhe të pandehur, sipas Kushtetutës gjyqtari prezumohet i pafajshëm, por në një shtesë rregulli i parashikuar nga neni 6/1 dhe për rrjedhojë edhe nga ligji që rregullon ushtrimin e detyrës nga persona, të cilët kanë probleme me pastërtinë e figurës, ne po shtojmë diçka tjetër. Atje nuk e pranuan idenë që hetimi penal të jetë i mjaftueshëm për pezullimin e një funksioni shtetëror të rëndësishëm, me përjashtim të rasteve shumë specifike.

Ndërkohë, asgjë nuk garanton në gjykimin tim, që prokurorë të caktuar, madje jo të trajnuar në nivelin e prokurorisë së posaçme, të nisin çështje nga paaftësia apo qëllimi, nga

keqdashja siç e ka gjyqtari, të bëjë një hetim penal e për rrjedhojë të prodhojë pezullimin nga detyra.

Së pari, nuk kemi rregulla zëvendësimi qoftë edhe të përkohshme. Së dyti, nuk kemi asnjë lloj garancie që ajo që po bën ai, do të përfundojë me një dënim, nuk kemi një vlerësim nga gjykata të atij minimumi provash që do çonte në arrest, (qoftë edhe në arrest shtëpie) për një veprë të rëndë penale, dhe po kështu nuk kemi asnjë lloj kufizimi në numër.

Pra një apo më shumë prokurorë, mund ta bëjnë këtë procedurë për të gjithë gjyqtarët e gjykatës, e për rrjedhojë të gjendemi në kushtet e pezullimit të gjithë gjykatës. Pra, nuk kemi asnjë filtër gjykate midis prokurorit dhe pezullimit nga detyra në kushtet që duhet t'i ruajmë fasadën e integritetit, sistemit gjyqësor. Pra, a ka modeli kufizime sasiore? Cilat janë garancitë që me këtë nuk abuzohet sot, të paktën në periudhën e parë derisa Shqipëria të ketë një gjyqësor, duke përfshirë prokurorinë dhe sistemin e drejtësisë ta ketë të atillë, të painfluencueshëm politikisht, sepse duhet të mendojmë për kushtet reale që kemi. Unë besoj se kështu siç është, është një stekë shumë e ulur, e për rrjedhojë me ndikim negativ në pavarësinë e ushtrimit të detyrës nga gjyqtarët.

Fatmir Xhafaj – Kam përshtypjen se ju niseni nga premisa të gabuara.

E para, i merrni të gjithë prokurorët të angazhuar politikisht.

E dyta, harroni që masat e prokurorëve verifikohen në gjykatë.

E treta, dhe që është edhe më e rëndësishmja, kërkon vendimin e Këshillit të Lartë gjyqësor, që do të thotë se i gjithë ai këshill është me njerëz të profilizuar.

E fundit, bëhet fjalë për një krim të rëndë të kryer me dashje dhe këtë e përcakton gjykata.

Oerd Bylykbashi – Po, ta ndaj në fund.

Fatmir Xhafaj – Jo, e ndan që në momentin e marrjes së pandehur, sepse do të shkojë ta paraqesë, plus që këtë do ta ndajë Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kodi i Procedurës para se të shkojë, për gjykim do ta çoj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ky nen është diskutuar edhe kur folëm për Gjykatën Kushtetuese dhe këto probleme nuk u ngritën. Madje unë do të thosha që diskutimi që po bëhet sot nga kolegu Bylykbashi bie ndesh edhe me diskutimin ose kërkesën e tij kur ne diskutuam

amendimin e ligjit “Për pastërtinë e figurave politike”. Unë mendoj se ky riformulim i sjellë nga ekspertët e nivelit të lartë do ta kënaqte zotin Bylykbashi, sepse ne marrim masa nëpërmjet këtij formulimi, ashtu siç e kuptoj unë, që në Gjykatën e Lartë nuk mund të vazhdojë të gjykojë një person ndaj të cilit është marrë një masë sigurie personale, arrest në burg ose arrest në shtëpi.

E dyta, kur merret në cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë, nuk do të ishte as etike, as e moralshme që gjyqtari i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës së Lartë Administrative të vazhdonte të ushtronte funksionin e tij dhe ndërkohë ai të paraqitet në ditë e orë të caktuara te prokurori: për t’u pyetur, për të dëshmuar, për t’u ballafaquar.

Ky formulim do ta kënaqte besoj zotin Bylykbashi në lidhje edhe me atë që ai thotë se nuk u bë te ligji “Për pastërtinë e figurave”. Të vetmin sugjerim që unë kam, e kam në lidhje me formulimin e paragrafit 2, me qëllim që të shmangim përsëritjet e fjalëve në vend të togfjalëshit “gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës së Lartë Administrative” të themi “gjyqtari pezullohet”. Të njëjtin rregull e kemi përdorur edhe te paragrafi i parë, te fjalia e dytë, ndërsa pjesa tjetër të mbetet kështu siç është.

Fatmir Mediu – Për propozime konkrete, për sa i përket rasteve të shkarkimit apo të lëvizjes së gjyqtarëve, propozimi im është ky, në nenin përkatës:

1. Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet përveç rasteve kur Kushtetuta e parashikon ndryshe.

2. Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveçse kur;

a) transferimin e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor;

b) gjykata kur transferohet është në pamundësi të gjykojë një apo disa çështje;

c) për shkak të interesit publik;

ç) gjyqtari merr masa disiplinore për transferimin në një gjykatë tjetër pa shkelje të rënda profesionale dhe etike në përfundim të një procedimi disiplinor.

3. Gjyqtari nuk mund të largohet nga detyra përveç rasteve:

a) mbush moshën 70 vjeç;

b) përfundon kohëzgjatjen e mandatit nëse detyra është me mandat;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet nga detyra, sipas paragrafit 4 të këtij neni;

d) vërtetohen kushte të pazgjidhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë fizike apo mendore për të ushtruar detyrën.

4. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

b) vërtetohet se ka faj, pasi ka vepruar me dashje apo në neglizhencë të rëndë apo të pajustificuar në keqinterpretimin e ligjit, përcaktimin e pasaktë të fakteve ose vlerësimin e gabuar të provave që nevojiten në zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore;

c) kryen shkelje të tjera të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, sipas përcaktimeve të bëra me ligj;

ç) vlerësohet se është në kushtet e pamjaftueshmërisë së aftësive profesionale dhe etike, sipas kritereve e procedurës të përcaktuara me ligj.

5. Procedimi disiplinor i gjyqtarit fillon nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili respekton të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor. Shkeljet disiplinore, masat e tjera disiplinore dhe procedimi disiplinor i gjyqtarit rregullohen me ligj.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të pezullojë përkohësisht nga detyra gjyqtarin për të cilin ka filluar procedimi disiplinor, nëse rrethanat e shkeljes disiplinore e bëjnë të papërshtatshme ushtrimin funksionit prej tij.

7. Pavarësisht ecurisë së procedimit disiplinor, Këshilli i Lartë Gjyqësor deklaron pezullimin nga detyra të gjyqtarit kur:

a) për shkak të kryerjes së një vepre penale ndaj tij caktohet prej gjykatës masa e arrestit, masa e ndalimit të ushtrimit në detyrë a në shërbim publik apo ndonjë ndalim tjetër që e pengon gjyqtarin në ushtrimin e detyrës;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje.

Për sa i përket nenit 140 apo nenit 32 për mbarimin e mandatit propozojmë si më poshtë:

“Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë apo i Gjykatës të Lartë Administrative mbaron në rastet e përcaktuara në paragrafin 2....

Fatmir Xhafaj – Më fal, po flasim për nenin 140, e cila është për përgjegjësinë disiplinore dhe nuk ka lidhje me mandatin. Ka kaluar.

Fatmir Mediu – Neni 140, gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore.

Fatmir Xhafaj – Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, nuk ka lidhje me mandatin kjo.

Ke ngatërruar nenet.

Fatmir Mediu – Ja sa ta shoh.

Fatmir Xhafaj - Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas procedurës që rregullohet me ligj. Është neni 140.

Fatmir Mediu – Do ta shoh.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 32.

Neni 33.

Fatmir Mediu – Zoti Xhafaj, mandati i gjyqtarit...

Unë u përpoqa që t'i grupoja të gjitha nivelet e gjyqësorit në një dhe të mos i ndaja.

E dyta, ka të bëjë me mbarimin e mandatit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Në rregull. Por rezervoj të drejtën që ta paraqes me shkrim, për shkak të konfuzionit që keni ju për propozimin tim.

Fatmir Xhafaj – Neni 33. Kush ka ndonjë gjë për nenin 33?

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Kjo lidhet drejtpërdrejt me diskutimin që bëmë te neni i parë i diskutimit të ditës së sotme, pra neni 25. Sigurisht që zgjidhja e atij problemi aty lidhet drejtpërdrejtë me ekzistencën apo jo të nenit 33 që ndryshon nenin 141. Pra, edhe kjo përpjekje që është bërë këtu për t'i dhënë një zgjidhje nuk garanton që:

a) kjo mbledhje e përbashkët do të ndodhë, sepse edhe mund të mos ndodhë;

b) nuk e zgjidh çështjen që do të ketë marrë formë të prerë ndoshta përpara se të mblidhet ky organ në njërën apo në një shkallë, apo në të dyja shkallët në të njëjtën kohë për çështje të njëjta. Për rrjedhojë, subjekti (madje mund të jenë marrë edhe vendime, të cilat mund të jenë shqyrtuar në gjykatat e larta respektive), në fund fare, në mungesë të një zgjidhjeje efektive, i është drejtuar edhe Gjykatës së Strasburgut për problemin që ka.

Ky nen duhet rishikuar së bashku me çështjen e Gjykatës së Lartë Administrative, por në çdo rast unë shoh pamundësinë që nëpërmjet këtij neni të zgjidhim atë që diskutuam te neni 25.

Fatmir Xhafaj – Po.

Pandeli Majko – Unë do të vazhdoj edhe një herë te pajtimi teknik i neneve dhe jo te diskutimi teorik. Propozoj që te paragrafi 1 të vendoset ashtu siç Komisioni i Venecias na ka

propozuar dhe që është edhe në *footnote*. Po e lexoj të plotë që paragrafi 1 të lexohet siç është shkruar në *footnote*: “Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative shqyrtojnë çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit, për të siguruar njehsimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore”.

Është fakt që deri më sot për shkak të mbingarkesës, që nuk është përmendur asnjëherë këtu dhe nuk e kam dëgjuar nga ndonjë përfaqësues i opozitës, Gjykata e Lartë është absolutisht e mbingarkuar me çështje dhe për pasojë është fakt që ajo nuk ia ka dalë të zbatojë urdhërimin kushtetues për njehsimin dhe zbatimin e praktikës gjyqësore. Por, në term moral është kthyer...

Fatmir Xhafaj – Atëherë t’i qëndrojmë formulimit të Venecias. Pra, Venecia e ka thënë fare pastër dhe qartë: “Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative shqyrtojnë çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njehsimin ose zbatimin e praktikës gjyqësore”.

Pandeli Majko – E saktë.

Fatmir Xhafaj – Po, sepse bëhet gjykatë ligji në ndryshimin që është sot gjykata.

Pandeli Majko – A ka mundësi të vazhdoj, zoti Oerd?

Fatmir Xhafaj – Për unifikimin e praktikës.

Pandeli Majko – Meqenëse të paktën në parim kemi rënë dakord që do të ecim sipas vërejtjeve të Komisionit të Venecias në përgjithësi...

(Diskutime pa mikrofon.)

Mua më duket që zgjidhja e Komisionit të Venecias është më funksionale. Në paragrafin e dytë propozoj që të kemi një shkrirje me paragrafin e tretë dhe të lexohet: “Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative zgjidhin mosmarrëveshjet e natyrës juridiksionale në kolegji të përbashkët të të dy gjykatave, që vendos për interpretim të detyrueshëm të ligjit, sipas rregullave të parashikuara në ligj”. Pra, hiqet paragrafi i tretë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Fatmir Mediu – Për sa i përket nenit 141, në gjykimin tim, paragrafi 1 të ndryshohet dhe të bëhet si vijon:

1. Gjykata e Lartë ka juridiksion rishikues dhe siguron zbatim uniform të ligjit nga gjykatat më të ulëta.

Fatmir Xhafaj – Është e vjetër kjo. Ka qenë në Kushtetutën e ...

Fatmir Mediu – Ky është propozimi.

Fatmir Xhafaj – Ngaqë ne po i mbahemi Venecias ti i mbajtur asaj.

Fatmir Mediu – Pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë me përmbajtjen si vijon: “Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative zgjidhin konfliktet juridiksionale në kolegji të përbashkët të të dy gjykatave që vendos për interpretimin e detyrueshëm të ligjit, sipas rregullave të përcaktuara me ligj”.

Fatmir Xhafaj – Këtë sapo e tha, zoti Majko.

Neni 34, besoj e njihni me atë që keni dëgjuar te Gjykata Kushtetuese.

Më falni! Bëmë parashikimet te neni 33. I dëgjuam dhe janë të njëjta.

Neni 34.

Oerd Bylykbashi – Jo, nuk janë të njëjta.

Fatmir Xhafaj – Ju keni qëndrim ndryshe.

Oerd Bylykbashi – Nëse ne do ta zgjidhim çështjen në themel, neni përkatës bie, nëse do të mbetet, duhet të gjejmë një zgjidhje, por kjo është një çështje, sikundër e thanë edhe ekspertët, politike.

Fatmir Xhafaj – Besoj se e kemi zgjidhur.

Oerd Bylykbashi – Unë po të them që është ende për t’u zgjidhur, sepse Komisioni i Venecias ka dhënë një rrugë, por asnjëra nga çështjet e tjera: *forum shopping*, zgjidhjes së ndryshme të të njëjtës çështje, zgjidhjes së paefektshme nga kjo mbledhja e përbashkët...

Fatmir Xhafaj – E ka thënë qartë Komisioni i Venecias dhe ne e morëm mot-a-mot.

Oerd Bylykbashi – ...zgjidhjes së paefektshme nga kjo mbledhje e përbashkët, çështjeve që janë mbyllur tashmë, pra, që kanë marrë formë të prerë dhe janë në zbatim, refuzimit nga gjykatat të një të drejte të caktuar nga një subjekt qoftë nga njëra, qoftë nga tjetra, asnjëra nga këto nuk zgjidhen sot nga kjo mbledhje e përbashkët.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, që ta kuptoni, ky nen është për unifikimin e praktikës, që është ngritur fort gjatë gjithë kësaj kohe. Do të jetë Gjykatë Ligji jo Gjykatë e Shkallës së Tretë. Ky rregullim që bëjmë ne këtu këtë parashikon.

Nuk do të gjykojë si Gjykatë e Shkallës së Tretë, do të gjykojë si gjykatë ligji dhe do të bëjë unifikimin e praktikës gjyqësore...

Oerd Bylykbashi – Një kolegji administrativ në Gjykatën e Lartë do të zgjidhte çështjen e unifikimit pa pasur nevojë për të bërë cirk në dispozitë kushtetuese.

(Mungesë incizimi.)

Fatmir Xhafaj – Neni 34. Jemi dakord, si te Gjykata Kushtetuese, që bëjnë atë diskutim? Dakord.

E mbyllim.

Faleminderit!

5 minuta pushim, për të vazhduar më pas me nenet e tjera.

(Rihapet mbledhja)

Fatmir Xhafaj – Rifillojmë mbledhjen.

Neni 35. Ndryshimi i nenit 147 ekzistues.

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Çështja e Këshillit të Lartë Gjyqësor besoj se ngërthen një nga problemet politike, që duhen zgjidhur. Pra, çështja e votimit me shumicë të cilësuar duhet të zgjidhet patjetër.

Ne kemi sugjeruar se një nga formulat, që duhen për zgjedhjen e 5 anëtarëve jogjyqtarë, do të jetë ajo me vende të rezervuara. Gjithashtu, mbetet për t'u zgjidhur çështja e anëtarit të pestë. Kështu siç është, me 11 anëtarë, ku 6 janë nga gjyqësori, 5 janë jashtë gjyqësorit, të cilët do të vijnë me propozime nga entitete të tjera, por do të përzgjidhen nga Kuvendi dhe të propozuara që të votohen veç e veç, nuk bën gjë tjetër veçse garanton kapjen e sistemit. Kapja e sistemit është një çështje që, pa u zgjidhur ajo, nuk shkojmë në asnjë vend. Pra, nuk është vetëm çështje shumice. 6 me 5 me këtë propozim që kemi këtu e bën sistemin shumë vulnerabël. Jo vetëm kaq, por kjo rëndohet akoma më shumë nga fakti që edhe kryetari do të jetë nga këta anëtarë. Pra, janë jo vetëm në një diferencë shumë të ngushtë vendimmarrëse, por edhe kryetari do të jetë nga radhët e jogjyqtarëve.

Për rrjedhojë duhet një zgjidhje globale, e cila do të na sigurojë që mënyra si do të zgjidhen këta 5 anëtarë, të jetë e tillë që të garantojë moskapjen politike, funksionalitetin e formulës që ata do të emërohen. Të mos ketë bllokim dhe në fund të kemi një Këshill të Lartë Gjyqësor që siguron atë që thuhet, e para, pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Po fjala e parë e renditur në atë fjali është “pavarësia”, dhe e pazgjidhur apo e zgjidhur kështu siç është këtu, nuk garanton asgjë të këtillë. Mund të kemi probleme të aspekteve të draftimit që duhen diskutuar...

Fatmir Xhafaj – E kuptoj shumë mirë sensibilitetin tuaj për sa i përket çështjes së zgjedhjes. Shumica janë dakord dhe e kemi ngritur që në fillim. Ndaj, unë mendoj se nuk kemi pse t'i themi për çdo nen. Ju e çmoni. Dakord.

Ju mirëkuptoj, por le të fokusohemi te pjesa tjetër, që është teknike, përveç problemit politik që ka, zgjidhjes politike për kuorumin. Teknikisht keni propozim konkret?

Oerd Bylykbashi – Teknikisht për formulimin e të gjithë nenit?

Fatmir Xhafaj – Po.

Oerd Bylykbashi – Nuk mund të bëhet një propozim konkret për gjithë këtë nen pa zgjidhur këtë çështje mjaft të rëndësishme sa thamë.

Pra, në qoftë se ne do të mbetemi me emërimin e veçantë të secilit prej anëtarëve dhe që vazhdon më tutje në këtë nen, nuk kemi bërë asgjë.

Për shembull, në pikën 5 thotë: “Kuvendi voton veç për secilin grup kandidatësh”. Secili grup kandidatësh është për një pozicion. Pra, në mos gaboj, janë 3 kandidatë për një, do të na duhet që dora dorës deri në votimin e pestë të kemi konsumuar 15 kandidatura dhe kjo e bën të vështirë edhe në aspektin e burimeve njerëzore.

Nga ana tjetër, votimi veç e veç i secilës kandidaturë është votim maxhoritar. Me çfarëdolloj formule që do të zgjedhim ne atë, është...

Fatmir Xhafaj – Grup, jo secilin kandidat.

Oerd Bylykbashi – Kuvendi voton veç për secilin grup kandidatësh, që do të thotë për secilën vakancë, 3 kandidatë. Pika më sipër thotë: “3 kandidatë të përzgjedhur sipas kësaj procedure transparente dhe publike. Këshilli i emërimeve bën renditjen e kandidatëve dhe ia dërgon Kuvendit”. 3 përbën grup dhe kemi votim veçmas për secilin grup tresh, që në fund është votim maxhoritar.

Do të jetë se cili mori më shumë vota, do të jetë se cili mori shumicë të cilësuar, do të jetë me balotazh, do të jetë me votim proporcional, siç thotë Komisioni i Venecias, apo do të jetë një formulë, e cila do të garantojë pjesëmarrjen substanciale të opozitës, në gjykimin tonë, në modelet e propozuara edhe nga partnerët, edhe nga Komisioni i Venecias, një prej atyre që ne kemi përzgjedhur, është ky me vende të rezervuara.

Pra, unë nuk mund të bëjë një propozim konkret për këtë këtu, pa pasur një zgjidhje që të shkojë njësoj në disa aspekte të kësaj Kushtetute. Sigurisht, kemi probleme të këtij lloji. Ne

nuk kemi zgjidhur ende nëse do të ketë një këshill të emërimeve në drejtësi në rolin e tij, por nëse do ta ruajmë siç është këtu...

Fatmir Xhafaj – E kemi mbyllur këtë diskutim.

Oerd Bylykbashi – Unë besoj që jo, sepse e thamë radhën e kaluar...

Fatmir Xhafaj – E kemi mbyllur çështjen e këshillit të emërimeve, arkitekturën e sistemit.

Oerd Bylykbashi – Unë po ju them që nuk është mbyllur çështja e arkitekturës. Ja pra, po ju them këtë problem që kemi këtu.

Shikoni emërimet në drejtësi. Bën renditjen e kandidatëve Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Ndërkohë, kandidatët që merr për renditje janë 3 gjithsej dhe këta vijnë nga këto organizma propozuese. Pra, do të jetë, për shembull, Dhoma e Avokatisë apo Dhoma e Noterisë, që do të bëjnë përzgjedhjen dhe short-testimin do ta bëjë organi i jashtëm nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Ajo që do t'i mbetet Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është renditja, por po të lexosh nenin që keni shkruar këtu për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, roli që ka është të kryejë verifikimin e kushteve dhe të kriterëve ligjore, profesionale, morale dhe kandidatëve jogjyqtarë. Bën limitim në numra. Pra, është në konflikt thelbësor qoftë edhe me nenet, që ekzistojnë në këtë Kushtetutë.

Po kështu, ne kemi probleme në lidhje me mënyrën si zgjidhet kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Problematika të ngjashme me përzgjedhjen që bëhet në rastet e tjera. Pra, formula për përzgjedhjen e kryetarit është problematike brenda vetvetes. Kështu që nuk mund të vazhdojë me këtë lloj formulimi.

Në rast se kjo shumicë nuk arrihet as në votimin e dytë, kandidatët nga të dyja raundet, që renditen të parët për secilin grup, konsiderohen të emëruar.

Formulimi është shumë konfuz: Renditja si do të jetë? Nga KED-ja apo renditje nga vota?

Fatmir Xhafaj – Në cilën pikë?

Oerd Bylykbashi – Në fund të pikës 5. Pra është i gjithë neni që ka nevojë për t'u riparë...

Fatmir Xhafaj – Propozim konkret!

Oerd Bylykbashi – Propozim konkret, zoti kryetar, në qoftë se heqim Këshillin e Emërimeve të Drejtësisë, sigurisht që do ta shkruajmë ndryshe komplet. Në qoftë se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk do të hiqet, por do të mbetet, atëherë...

Fatmir Xhafaj – Kemi rënë dakord për këtë gjë.

Oerd Bylykbashi – Jo, për këtë nuk kemi rënë dakord. Nëse do të jetë kështu..

Fatmir Xhafaj – Kur erdhët dhe bëmë diskutimin në parim, për fat të mirë, ne kemi një dokument këtu. Na e keni dhënë ju. Zoti Halimi e dorëzoi dokumentin në emrin tuaj. Unë e kam atë dokument. Të gjithë e kemi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ky është një nen i cili ka shumë probleme me karakter politik për t'u zgjidhur, përtej aspekteve, që unë besoj, se në aspektin e draftimit ne do ta zgjidhim pa problem. Gjithmonë, mbetet shqetësimi që neni duhet të ketë, po them, elegancën e mjaftueshme të draftimit kushtetues, në mënyrë që çfarë nuk duhet të jetë këtu, mund të jetë e parashikuar në ligjin...

Fatmir Xhafaj – Kemi rënë dakord.

Zoti Majko, urdhëroni!

Pandeli Majko – Për nenin 35 propozoj që paragrafi i parë të mbetet ashtu siç është. Po ashtu, edhe paragrafi i dytë të mbetet ashtu siç është.

Te paragrafi i tretë, propozoj të ketë një ndryshim të vogël në renditjen e fjalëve dhe po e lexoj: “ Anëtarë, gjyqtarë të përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë, moral dhe profesional.” Fjala “moral” dhe përpara të ndryshojë vendin. Për paragrafin e tretë nuk kam vërejtje tjetër.

Për paragrafin e katërt në fjalinë e dytë “Për çdo vend vakant, organizmat propozuese i paraqesin Këshillit të Emërimeve në Drejtësi...” dhe në vazhdim, propozoj të shkruhet “ Për çdo vend vakant organet propozuese i paraqesin”. Është një propozim i karakterit teknik.

Gjithashtu, dëshiroj të them edhe një gjë tjetër për paragrafin e katërt dhe këtu do të kërkoja edhe opinionin e kolegëve. Për fjalinë e parë që ka të bëjë me formulën që është shkruar këtu, propozimi im është: “Anëtarët jogjyqtarë zgjidhen me 3/5-at e të gjithë anëtareve të Kuvendit mbi bazën e propozimeve: nga avokati, dy anëtarë; nga trupa e pedagogëve të drejtësisë, 2 anëtarë dhe nga trupa e pedagogëve jogjyqtarë ose prokurorë të Shkollës së Magjistraturës, një anëtar.”

Jam i hapur të pres edhe propozimet e kolegëve të tjerë.

Në pikën 5 të bëhet një riformulim i paragrafit dhe po e citoj propozimin që i ofroj komisionit: “Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Kur në votimin e parë nuk arrihet shumica prej 3/5-at, Kuvendi voton përsëri brenda 7 ditëve nga data e votimit të parë. Në rast se shumica prej 3/5-ash nuk arrihet as në votimin e dytë, do të konsiderohen të emëruar kandidatët e renditur të parët nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.”

Arsyetimi është i thjeshtë: besohet se në vazhdim të gjithë trupat, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Trupa e Pedagogëve e të tjerë, në qoftë se do të mbetet varianti i parë, do të priren të përzgjedhin kandidatët më të mirë se në raundin e parë të përzgjedhjes, prandaj propozoj pikërisht këtë që sapo thashë, por, në fakt, edhe nga ajo që tha zoti Bylykbashi.

Në pikën 6 propozoj që fjalia e dytë të hiqet dhe të vendoset në ligj. Besoj se ka më shumë kuptim të vendoset në ligj, pasi aty ne do t’i japim shumë detaje dhe formë të caktuar mënyrës së zgjedhjes së kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën 7 kam një propozim, i cili sqaron çështjen e raportit të mandatit të anëtarëve gjyqtarë. Po e lexoj të gjithë nenin, duke pasur parasysh edhe propozimin tim brenda, që është fjalia e tretë: “Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej 5 vjetësh pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët gjyqtarë kthehen në vendet e mëparshme të punës”. Pra, fjala “rikthehen” është bërë “kthehen”. Fjalia që propozoj unë është: “Anëtarë dhe gjyqtarë, të cilët vijnë në këshill nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Lartë Administrative ose Gjykatat e Posaçme, u pezullohet mandati gjyqësor gjatë kohës së shërbimit si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Anëtarët jogjyqtarë, që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose, në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to”. Këto janë propozimet.

Fatmir Xhafaj – Keni gjë tjetër?

Urdhëroni, zoti Ristani!

Arben Ristani – Kam diçka për pikën 4, këtu ku flasim për anëtarët jogjyqtarë, mënyra e përzgjedhjes së tyre me 3/5-at, është e papranueshme për ne dhe e kemi deklaruar një gjë të tillë. Ne preferojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, ka edhe një skemë tjetër, e cila është biseduar dhe, me sa di unë, është skema e vendeve të rezervuara, që, në nivelin e propozimit, dy kandidatë të jenë të maxhorancës, dy

kandidatë të jenë të opozitës. Gjithsesi, në këtë pikë është një nga kushtet që kemi ne. Në qoftë se do ta diskutojmë më tutje, e diskutojmë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ristani!

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti Majko, ju e bëtë propozimin, edhe në vijim të debatit që bëmë herën që shkoi, që nga dy votime të ndryshme, përzgjedhim aty. Në qoftë se ne do të ruajmë konceptin e renditjes që vjen nga KED-ja, do të kishim dy anëtarë që renditen të parët. Pra, nuk është e qartë zgjidhja.

Unë kam edhe një koment. Nëse ne do ta limitojmë kaq shumë Kuvendin, duket qartë se kujt po ia japim kompetencën e përgjegjshmërisë së këtyre 5 anëtarëve gjyqtarë dhe, për rrjedhojë, këta garantojnë përgjegjshmërinë e sistemit, të KLGJ-së, në rastin konkret, te cili? Me kaq pak rol sa i japim Kuvendit, ne, me eventualitetin e bllokimit të një votimi në Kuvend, e spostojmë të gjithën tek avokatët, te noterët, te Trupa e Pedagogëve e të tjerë. E para, do të na duhet që të rregullojmë me ligj momentet përkatëse, në mënyrë që të mos ketë kapje, të mos ketë devijime dhe deformime.

Fatmir Xhafaj – Patjetër.

Oerd Bylykbashi – E dyta, për çfarë e investojmë ne Kuvendin, në qoftë se Kuvendi nuk qenka kaq i rëndësishëm? E investojmë që të votojmë edhe me 3/5-at për këta pesë funksionarë kaq të rëndësishëm në një balancë të kujdesshme brenda KLGJ-së. Kuvendi nuk qenka ai që është, pra, ata i propozojnë dhe në fund fare këshilli i merr me drejtësi, siç thoni ju. Pra, e kemi bërë pothuajse të tejdukshme një kompetencë kushtetuese që i përket Kuvendit për të garantuar përgjegjshmërinë e sistemit gjyqësor përpara të zgjedhurve për raport të zgjedhësve. Ndërkohë, ia transferojmë këtë kompetencë Dhomës së Avokatisë, Dhomës së Noterisë e të tjera. Pra, e gjithë zgjedhja ka një problem.

Prandaj, unë do të doja të bëja një propozim konkret, të paktën edhe për rekord, por mbetet që të gjejmë gjuhën e përbashkët. Për nenin 147 propozoj:

“1. Këshilli i Lartë Gjyqësor garanton pavarësinë, përgjegjshmërinë si dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve përzgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e jurisë dhe jogjyqtarë. Procedura e përzgjedhjes së tyre garanton kandidimin e hapur, konkurrimin e

ndershëm midis shumë kandidatëve, vlerësimin krahasimor të përmbushjes së kriterëve, transparencën dhe standarde të tjera të procesit të rregullt ligjor”.

3. Anëtarët gjyqtarë zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve të të gjitha niveleve me integritet të lartë profesional dhe moral. Konferenca Gjyqësore Kombëtare i zgjedh anëtarët dhe gjyqtarët me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë, duke siguruar përfaqësim të drejtë të të gjitha shkallëve të gjykatave.

4. Anëtarët dhe gjyqtarët duhet të kenë shtetësi shqiptare dhe nuk duhet të kenë mbajtur poste politike apo poste në një parti politike gjatë periudhës (që mund ta përcaktojmë së bashku) përpara kandidimit. Ata duhet të kenë mundësi të spikatur profesionale dhe integritet profesional dhe moral, njohuri të thelluara ligjore dhe të paktën 15 vjet përvojë pune.

5. Anëtarët jogjyqtarë zgjidhen nga Kuvendi sipas metodës së kuotave të rezervuara, ku dy anëtarë përzgjidhen nga lista e mbështetur nga shumica parlamentare, dy anëtarë përzgjidhen nga lista e mbështetur nga pakica parlamentare dhe një anëtar zgjidhet me 3/5-at e votave me propozim të qeverisë civile me një formulë që do ta na duhet ta zgjedhim në ligj.

6. Rregullat më të detajuara për kushtet dhe kriteret, si dhe për procedurën e kandidimit të zgjedhjeve caktohen me ligj.

7. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të këshillit të radhët e gjyqtarëve jogjyqtarë, me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve. Në rast se kryetari nuk zgjidhet në mbledhjen e parë, anëtari më i vjetër në moshë nga radhët e gjyqësorit organizon zgjedhjen e kryetarit me short në mbledhjen e radhës, e cila zhvillohet e hapur. Kryetari qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej 5 vjetësh pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të kohëzgjatjes së mandatit, anëtarët gjyqtarë rikthehen në vendet e mëparshme të punës. Anëtarët jogjyqtarë, që përpara detyrës punonin me kohë të plotë në sektorin publik, në përfundim të kohëzgjatjes së mandatit rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose, në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to.

9. Mandati i ushtruar rregullisht nga anëtari konsiderohet vlerë e shtuar profesionale sipas rregullave të përcaktuara me ligj.”

Pra, ky është një propozim i mundshëm për t’u parë nëse mund të gjejmë gjuhën e përbashkët.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Për amendimin e variantit të nenit 147 të Kushtetutës, u paraqitën dy propozime, njëri nga zoti Majko dhe njëri nga zoti Oerd. Do të ishte mirë që këto t'i kishim paraprakisht, sepse ne, deri tani flas, kemi gjykuar për dispozita shumë të shkurtra dhe që kuptohen qartë.

Nga ana tjetër, ne kemi folur gjatë gjithë kohës për të pasur një shkrim të Kushtetutës në një gjuhë sa më të thjeshtë, sa më koncize dhe për ta lënë shumicën e detajeve në ligj.

Riformulimi që sjell zoti Bylykbashi për nenin 147, i cili amendohet nga neni 35 i këtij projektligji, e detajon, është shumë më i gjerë, por njëkohësisht e cenon të gjithë diskutimin që kemi bërë për strukturën dhe hierarkinë e institucionit.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, mos u merrni me zotin Bylykbashi! Kurseje kohën!

Vasilika Hysi – Jo, e kam në parim, sepse për mënyrën si po diskutojmë, ne nuk po e ndjekim dot më diskutimin. Po bëhet shumë i lodhshëm dhe nuk arrijmë dot t'i ndjekim këto lloj formulimesh dhe rishkrimesh pa pasur parasysh diçka të shkruar përpara.

E mora fjalën edhe në aspektin procedural, por, nga ana tjetër, kur duhet të ndryshojmë çështje që janë thelbësore ose të diskutuara, duhet t'i lëmë kohën e duhur, ose t'i kemi të shkruara përpara dhe të flasim. Këtu ka dy ndryshime thelbësore, për të cilat mendoj se ne si komision duhet të shprehemi.

E para, për paragrafin 4, në projektin e sjellë nga ekspertët e nivelit të lartë, propozohen 5 anëtarë jogjyqtarë nga organe propozuese të ndryshme. Në propozimin që solli kolegu Majko, që na ftoi të shprehemi dhe të marrim një vendim, ka një ndryshim. Me fjalë të tjera, do të vazhdojë, apo jo që Dhoma Kombëtare e Avokatisë të propozojë një person? A do të vazhdojmë ta mbështesim idenë se shoqëria civile do të ketë një person të propozuar? Kjo është çështja e parë që duhet të zgjidhim.

Kalojmë te çështja e dytë e propozimit që bëri kolegu Majko. Nëse ne pranojmë se cilat do të jenë organet përkatëse dhe numri i kandidatëve për anëtarët jogjyqtarë që ata do të propozojnë, kalojmë te roli i Kuvendit. Këtu ka dy qëndrime të ndryshme.

E para, ju thoni që të zgjidhet modeli me vende të rezervuara. Personalisht jam kundër dhe do ta jap argumentin pse. Deri më sot ne po e diskutojmë reformën në drejtësi si një nga mekanizmat që do të krijojë një sistem gjyqësor të pavarur.

Nga ana tjetër, propozimi që sillni ju, kolegë të opozitës, në qoftë se është propozim i opozitës, të pestë kandidatët për anëtarë jogjyqtarë, janë totalisht politikë ose, nëse nuk janë politikë, ne do t'i bëjmë politikë, pasi thuhet se dy do t'i mbështesë maxhoranca, dy do t'i mbështesë opozita dhe një do ta sjellë shoqëria civile. Për të qenë korrekte, katër prej tyre ne do t'i politizojmë. Pavarësisht se ata janë ose duhet të jenë njerëzit më të mirë, me përvojë, mundësisht të mos kenë ndikim politik, të mos jenë anëtarë partie e të tjera. Në këtë kuadër, ne e dëmtojmë përbërjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky është mendimi im. Unë do të preferoja që ne të qëndrojmë sa më larg politizimit.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, ju jeni diktuar nga fakti që zoti Bylykbashi, për rekord politik, e hap herë pas here këtë gjë. E kemi thënë që çështjen e votimit të shumicave të kuorumit që do të duhet dhe mënyrës se si do të përzgjidhen insionet që janë në tagrin e Kuvendit, do t'i diskutojmë përgjatë mesditës.

Vasilika Hysi – Unë nuk fola për kuorumin, fola se kush do t'i propozojë.

Po flas për dy propozimet që na u hodhën në tavolinë.

Fatmir Xhafaj - Ju jeni me variantin që është këtu?

Vasilika Hysi - Unë jam me propozimin që të diskutojmë ndërmjet variantit që kanë sjellë ekspertët dhe variantit që diskutoi zoti Majko. A do të mbajmë ne një qëndrim për këtë?

Fatmir Xhafaj - Çfarë bëri zoti Majko? Bëri një riformulim, si e kuptova unë, që dispozita të jetë më e pastër. Kaq!

Vasilika Hysi - Ka hequr të drejtën e noterëve dhe të shoqërisë civile të propozojnë. Mendoj se para se të kalojmë te neni tjetër, duhet të shprehemi për këtë nen. Na ftoi zoti Majko dhe për këtë duhet të shprehemi.

Fatmir Xhafaj - A jeni dakord ju për këtë?

Vasilika Hysi - Do të jap opinionin tim për këtë.

Së dyti, në rast se ne flasim që Kuvendi ka të drejtë të votojë veçmas për secilin grup kandidatësh dhe të votojmë një listë që nuk e ka shumicën e 3/5-ve, ta rivotojmë edhe një herë, bën logjikë, sepse gjithmonë lista që do të vijë më pas nuk do të jenë kandidatët më të mirë. Kandidatët më të mirë do të propozohen në listën e parë dhe kjo na shtyn që në parlament të gjejmë konsensus me njëri –tjetrin, me qëllim që Kuvendi të ketë peshë, përndryshe do të fitojë dhe do të quhet i emëruar kandidati që është renditur i pari nga Këshilli i Emërimeve.

Prandaj, zoti Kryetar, po e përsëris, të marrim edhe një herë çështjen e parë, a do të biem dakord që noterët dhe shoqëria civile nuk do të paraqesin më propozime?

Meqenëse kërkuat opinionin tim, unë jam dakord që shoqëria civile përderisa është kaq shumë kaotike dhe ne nuk kemi rregulla të qarta se si do t'i propozojmë, si do të renditen, si do të kemi një proces publik transparent, më mirë të jetë nga bota akademike, sepse është më profesionale dhe më pranë problemeve të sistemit gjyqësor.

Lidhur me kandidatët për noterë, ejani ta diskutojmë. Kolegu Majko e hodhi si sugjerim: a do t'ia lëmë Dhomës Kombëtare të Avokatisë kandidatin apo do të marrim nga noterët? Për këtë nuk jap dot mendim, sepse jam e dyzuar.

Fatmir Xhafaj - Dakord!

Kemi disa propozime konkrete dhe varianti është ky që po diskutojmë, kurse propozimet janë propozime që në thelb synojnë përjasjen më mirë me frymën kushtetuese. Ka dy-tre propozime, përveç çështjes së kuorumit, të cilat kërkojnë zgjidhje thelbësore ose kanë ndryshim thelbësor.

Së pari, është propozimi i nenit, 4 që kishte të bënte me paragrafin e parë.

Së dyti, kemi riformulimin e plotë të pikës 5 për t'i dhënë mundësi Kuvendit që brenda të njëjtit grup propozimi të votojë dy herë, në mënyrë që të arrijnë të gjejnë konsensusin. Mendoj se kjo është një gjë pozitive, që investon Kuvendin dhe ka qenë një propozim i zotit Bylykbashi që Kuvendi të mos e ezaurojë vetveten me një votim apo dy votime.

Lidhur me pikën 6, "Nëse kryetari nuk vjen në mbledhjen e parë...", për të gjithë paragrafin e dytë që propozoi zoti Bylykbashi, zoti Majko mendon që duhet të vendoset në ligj, sepse janë detaje të panevojshme në Kushtetutë.

Më pas në pikën e 7 për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë që të vijnë nga Këshilli...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Për anëtarët e Gjykatës së Lartë, zoti Devill e ngriti si shqetësim që duhet zgjidhur. Këtu është dhënë një adresim.

Zoti Bylykbashi bëri dy-tre propozime për mënyrën se si duhet të jenë. Futi Konferencën Gjyqësore, që nuk është më pjesë e logjikës së kësaj arkitekture, për shkak se nuk zgjidhet nga gjyqtarët. Logjika e propozuesve, siç e kam kuptuar unë, është që Gjykata e Lartë zgjedh përfaqësuesin e saj, gjykatat e Apelit zgjedhin dy përfaqësuesit e tyre dhe gjykatat e shkallës së parë zgjedhin tre përfaqësuesit e tyre gjyqtarë në një votim të drejtpërdrejtë. Këtu

bashkohemi për votimin e drejtpërdrejtë, por jo përmes Konferencës Gjyqësore, e cila ka vetëm këtë funksion në Kushtetutë sot dhe nuk ka pse ta ketë, sepse me këtë gjë vetëm sa do ta kompleksojmë më tej sistemin.

Atëherë, ngelet që të zbardhen, që t'i shohim të formuluar, në mënyrë që të gjykojmë më mirë konkretisht

A kanë ekspertët ndonjë koment apo do ta lenë për më vonë? Nuk kanë.

Vazhdojmë me nenin 36.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Së pari, dua të bëj një koment: duke e parë në aspektin e draftimit, ajo ka lidhje me referencat transitorë, që i kemi diskutuar, kështu që kjo nuk përbën ndonjë gjë të re.

Zoti Kryetar, kërkoj pak kohë që të bëj komentin tim, ndërkohë mund të flasë ndonjë koleg tjetër.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Majko.

Pandeli Majko - Te neni 36, që kombinon me nenin 147/a, propozoj që te germa “a” të kemi një thjeshtim të formulimit.

Po e citoj të plotë formulimin: “Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: emëron, vlerëson, ngre në detyrë, transferon gjyqtarët e të gjitha shkallëve, përveç gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”.

Mendoj se në fund të gjitha janë të nënkuptueshme dhe nuk ka nevojë pse të mbingarkohet me specifikime të natyrave të tjera.

Po ashtu te germa “b” kam të njëjtën frymë: “Vendos për masa disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, përveç gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”.

Për gerrat “c”, “ç” dhe “d” nuk kam vërejtje. Po ashtu te pika 2, ku thuhet: “Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të krijojë dhe të vendosë për nënkomisione”, propozoj një riformulim: “Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve me fuqi vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në pikën 3 kam bërë një ndryshim dhe po e lexoj: “Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me politikën e përgjithshme shtetërore në fushën e dhënies së drejtësisë, të organizimit e funksionimit të pushtetit gjyqësor me planifikimin strategjik dhe pushtetin gjyqësor”.

Mendoj se ky specifikim për pjesëmarrjen e ekzekutivit apo të përfaqësuesve të ekzekutivit në diskutimet e çështjeve të drejtësisë përcaktohen më mirë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Bylykbashi, keni ndonjë propozim konkret?

Oerd Bylykbashi - Një propozim i mundshëm për pikën 1 është: “Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) përzgjedh, emëron, vlerëson, ngre në detyrë transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) shqyrton ankesat ndaj gjyqtarëve dhe gjykatave, si dhe kontrollon veprimtarinë e gjyqtarëve të të gjitha niveleve dhe vendos për masat disiplinore ndaj tyre; c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative (nëse kjo do të mbetet), sipas procedurës së përcaktuar me ligj; ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr inspektimin e tyre; d) drejton, kontrollon dhe kujdeset për administrimin e gjykatave dhe shërbimet e administratave gjyqësore; dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; e) mbikëqyr trajnimin profesion të gjyqtarëve të administratave gjyqësore të të gjitha niveleve; ë) mbron figurën e gjyqtarit dhe të pushtetit gjyqësor.

Paragrafi 2: Këshilli i Lartë Gjyqësor nxit efikasitetin e drejtësisë duke bërë planifikimin strategjik për sistemin gjyqësor. Ai merr masa për të forcuar besimin publik te pushteti gjyqësor duke vlerësuar cilësinë e shërbimit në gjykatë dhe duke informuar të paktën një herë në vit publikun dhe Kuvendin për gjendjen e këtyre shërbimeve, si dhe duke iu kërkuar autoriteteve shtetërore kompetente marrjen e masave për të përmirësuar administrimin e drejtësisë”.

“Këshilli ushtron edhe funksionet e tjera të përcaktuara me ligj:

1) Këshilli i Lartë Gjyqësor për ushtrimin e funksioneve të tij organizohet dhe vendos në komisionet e përhershme të përbërë nga anëtarët e tij, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme.

2) Komisioni Disiplinor, që përbëhet nga dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, është përgjegjës për verifikimin e ankesave ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve dhe administratave gjyqësore, si dhe me iniciativën e tij për hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj tyre. Anëtarët e Komisionit Disiplinor zgjidhen me short çdo dy vjet dhe kryetari i tij është anëtar gjyqtar.

3) Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve pa pjesëmarrjen e anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

4) Ankimi kundër vendimit të Këshillit të Lartë gjyqësor shqyrtohet në një pozitë me Gjykatën Kushtetuese.

5) Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor vetëm kur diskutohen çështje që lidhen me verifikimin strategjik dhe me buxhetin e pushtetit gjyqësor.

6) Këshilli i Lartë Gjyqësor ndihmohet nga administrata e tij, e cila përgjigjet përpara tij.”

Ky është një propozim i mundshëm për t’i kontraktuar funksionet.

Fatmir Xhafaj - Gjërat që i ka ligji ne i futëm këtu tani?

Këto janë gjëra që janë në ligj, nëse e keni lexuar ligjin që ishte në proces konsultimi. Ata që jua kanë dhënë, i kanë marrë nga ligji, që kanë bërë ekspertët dhe i kanë futur këtu. Shumica e këtyre janë për t’u vendosur në ligj.

Oerd Bylykbashi - Kur të biem dakord, i çojmë atje!

Fatmir Xhafaj - “Po të rrisim efikasitetin”, janë parullat e gjyqësorit.

Oerd Bylykbashi - Zoti Xhafaj, ky është një propozim i mundshëm dhe, në momentin kur ne të biem dakord, do t’i transferojmë gjërat edhe në ligj se e ngushtojmë formulimin atje. Ndërkohë, ne si komision nuk i kemi parë ende ligjet, mund t’i ketë parë konsulta atje, por ne si komision, që do t’i çojmë në parlament, nuk i kemi parë.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, por këtej i hiqni për t’i çuar në ligj, këtej i shtoni në Kushtetutë.

Oerd Bylykbashi - Ky është një propozim, i cili në kushtet kur ne të biem dakord, një pjesë e këtyre parashikimeve transferohen atje.

Fatmir Xhafaj - Merrni një konsulent kushtetues, këtë këshillë miqësore do t’jua jepja, por ju e dini vetë.

Oerd Bylykbashi - Zoti Xhafaj, mos mendoni se e keni vetëm ju këtë shqetësim.

Po ju them edhe një herë nëse nuk e kuptuat: nëse ne do të biem dakord me këto zgjedhje, do t’i transferojmë ato që janë formulime për në ligj. A ju kujtohet kur në seancën e parë thatë: “Këto formulime janë kështu në mënyrë që të kishim një vizion të të gjithës?”

Fatmir Xhafaj - Po, sepse janë në ligj.

Oerd Bylykbashi - Bukur, jo ende ligji nuk ka ardhur në këtë tavolinë, sepse kemi rënë dakord që ta shohim së bashku atë ligj.

Fatmir Xhafaj - Po, pasi të kalojmë projektin kushtetues.

Ju kishit një praktikë shumë të mirë, të them të drejtën e pëlqeva, pavarësisht se nuk më shkonte shumë në kushtet e mosbesimit, të klimës e të tjera, por disa gjëra i tërhiqnin vëmendjen komisionit në sensin që po trajtoni këtë çështje të natyrës kushtetuese. Dua të sjell në vëmendje këto dy gjëra që të mbahen në konsideratë për ligjin: ndajeni këtë gjë, se ju nuk po e ndani, por po e sillni si normë kushtetuese. Po e sollët si normë kushtetuese, nuk e ndajmë dot se çfarë është kushtetuese dhe çfarë është për në ligj.

Atë praktikë unë e kuptoj dhe jam dakord.

Oerd Bylykbashi - Zoti Kryetar, jemi mjaftueshëm të aftë që ta bëjmë ndarjen ndërmjet të dyjave, ndërkohë që po bëjmë një propozim konkret dhe po them edhe këtë: ajo që duhet të biem dakord bashkë është se çfarë nuk është për tekstin kushtetues, ta spostojmë në ligj. Atëherë, çfarë ka të çuditshme në këtë rast?

Fatmir Xhafaj - Dakord!

Faleminderit!

Zonja Hysi, ju lutem sa më konkrete.

Vasilika Hysi – E kam konkrete dhe është në vazhden e atij diskutimi që bëra më parë.

Ne në tavolinë kemi projektin e ndryshimeve kushtetuese. Ne nuk kemi ende në tavolinë projektligjet që do të shoqërojnë këtë paketë, apo këto ndryshime kushtetuese që do të vijnë si paketë. Deri tani ne i kemi pastruar nga detajet propozimet në paketën e ndryshimeve kushtetuese për t'i kaluar në ligj. Nuk ka ndodhur deri më sot që, pjesën e ligjit ta sjellim te ndryshimet kushtetuese, ta miratojmë dhe ta kthejmë përsëri në ligj. Pse? Sepse ajo që thotë zoti Bylykbashi, që t'i miratojmë sot, të biem dakord, dhe pastaj t'i kalojmë në ligj, nuk bën sens.

Këto propozime ose riformulime, që ju i shkëpusni nga ligji dhe doni t'i miratoni sot, kanë një lidhje logjike me pjesën tjetër të dispozitave që janë në ligj. Ne nuk mund të themi që sot, se jemi dakord me të, pa parë ligjin në tërësi.

Prandaj, do të sugjeroja, edhe për të fituar kohë, edhe për të qenë më eficient në këtë diskutim – sepse, sinqerisht, ju diskutoni, por ne që po ju dëgjojmë nuk ndjehemi komodë në këtë lloj diskutimi – t'i marrim një për një paragrafët.

A kemi diçka për germën “a”, të pikës 1, të nenit 36 “Për kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor”? Ne nuk mund të shtojmë kompetenca, që aktualisht i kanë organe, për të cilat kemi rënë dakord se do të ekzistojnë në skeletin e organeve të drejtësisë.

Prandaj, do të lutesha të marrim e të pastrojmë paragrafët një e nga një. Në qoftë se ka çështje ose pyetje të paqarta, për të cilat kemi nevojë për përgjigje, t'ua drejtojmë ekspertëve, por të mos bëjmë sot ligjin e organizimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë mënyrë siç po veprojmë sot, ne nuk po kuptojmë se çfarë po miratojmë e çfarë s'po miratojmë dhe çfarë çështjesh të hapura...

Fatmir Xhafaj – Do t'ju kërkoja një gjë, dhe e kam edhe me kolegët e maxhorancës: evitoni çdo lloj debati që ka të bëjë me qëndrimet apo gjykimet politike. T'i marrim të mirëqena. Le të vazhdojmë me ndërhyrjet konkrete, teknike. Ku ka debat për ndërhyrje teknike, jam shumë dakord. Ku, s'ka, në rregull, zgjedhje që e kanë bërë vetë kolegët e tjerë, kështu që s'kemi çfarë të bëjmë.

Kemi ndonjë gjë tjetër, pasi u shprehën të gjithë për këtë gjë? Kemi ndonjë gjë tjetër, përpara se të pyes zotin Deville? Jo. në rregull, e mbyllim diskutimin mes nesh. Fjala për ekspertët ndërkombëtarë.

Zoti Deville, ju lutem!

Rainer Deville - Do dëshiroja të tërhiqja vëmendjen tuaj lidhur me çka kemi vendosur në footnotën 27, sa i takon rolit të Ministrit të Drejtësisë. Kemi thënë në paragrafin 1 pika d, që ky Këshill po drejton dhe menaxhon administratën e gjykatave dhe në strukturën e teknologjisë së informacionit, ne shohim që Prokuroria e Përgjithshme ka sisteme të ndryshme nga gjykatat. Pyetja që ngrihet është, nëse do kemi një sistem të ri, kush do ta ketë pronësinë dhe kush do jetë mbi këto Këshillat?

Nga perspektiva e menaxhimit të gjykatave, duam të shohim një trup/strukturë mbi Këshillin e Lartë Gjyqësor që të krijojë standardet për të gjithë vendin.

Kështu që ose shtojmë numrin, përveç strukturave të teknologjisë së informacionit që do të vendosen më tej nga Ministria e Drejtësisë që do ta gjeni në footnotën 27, ose nëse doni ta vendosni si një rregull të përgjithshëm mbi Ministrinë e Drejtësisë, ndoshta do të bëhej të neni 100 dhe te Këshilli i Ministrave, edhe pse aty do të dukej paksa e veçantë. Por kjo është një pyetje teknike pas të cilës është çështja se çfarë bën Ministria e Drejtësisë. Kemi pasur disa herë pyetjen, a duhet Ministria e Drejtësisë të mbledhë propozimet e buxhetit nga të gjitha institucionet dhe të luftojë për to, apo çdo institucion që jep propozimet e buxhetit që është në fakt 1 në 100 duhet të luftojë për buxhetin që propozon? Kjo pyetje mbetet pa përgjigje sepse

nuk ka asnjë dispozitë në Kushtetutë që rregullon Ministrinë e Drejtësisë. Pra pyetja është, çfarë duhet të bëjë Ministria e Drejtësisë dhe mund të gjejmë diçka për strukturën e IT-së?

Fatmir Xhafaj – Po. Kemi gjë tjetër këtu? Në rregull.

Vazhdojmë me nenin 37: “Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Kemi ndonjë gjë esenciale? Nëse s’kemi ndonjë gjë, të mos...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku e keni këtë?

Pandeli Majko – Te pika 4 e nenit 37. Është vetëm një rregullim, që mua më duket shqipërim. Sipas paragrafit “a” dhe “b” të këtij neni. Qartësohet se cili paragraf, i cilit nen...

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Po ta shikojnë të nevojshme le ta qartësojnë.

Keni tjetër gjë për nenin 37?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, dakord, dakord!

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me këtë nen, përveç komenteve të mëhershme për referencat dhe nevojën për të definuar pamundësinë, për shembull, kemi edhe një çështje: “Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit të anëtarit të larguar.”

Pyetje: cili është organi që emëron anëtarin gjyqtar të KLGJ-së?

Jo më kot ne kishin Konferencën Kombëtare Gjyqësore. Cili është organi që ka të bëjë me...

Fatmir Xhafaj – Po. Është mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, është mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, është mbledhja e gjyqtarëve të shkallës së parë. Rregullohet me ligj ajo.

Oerd Bylykbashi – Ne kemi bërë një propozim, që ishte...

Fatmir Xhafaj – E qartë.

Oerd Bylykbashi – Është një opsion. Por kështu siç është, është një referencë boshe, që nuk të çon diku.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Oerd Bylykbashi – Sigurisht, aspekte të terminologjisë, që duhen përshtatur, janë këtu. Po të doni, mund të bëj një propozim këtu, në lidhje me këtë.

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbaron kur:

a- Mbush moshën e pensionit.

b- Jep dorëheqjen. (Do të propozoja heqjen e shprehjes: “përfundon mandatin pesëvjeçar”, sepse ajo është automatike)

c- Shkarkohet sipas parashikimit të nenit 147/ 3.

ç- Vërtetohen kushtet e pazgjidhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të anëtarit të këshillit.

d- Vërtetohet fakti i pamundësisë fizike apo mendore, për të ushtruar detyrën.

Nëse ky është një definim, kur flasim për pamundësinë. Sigurisht, i mbetem edhe parashikimit të rastit kur anëtari ndërron jetë.

2- Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3- Kur vendi i anëtarit ndodhet vakant, organi që e ka zgjedhur anëtarin paraardhës, sipas nenit 147 emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar. Nëse raportet e përfaqësimit në Kuvend kanë ndryshuar, anëtari përzgjidhet nga lista e mbështetur nga grupi parlamentar, që kishte mbështetur anëtarin paraardhës.

4- Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, jo më vonë se tre muaj para përfundimit të mandatit të një anëtarit për shkak pensioni apo mbarimit të kohëzgjatjes së mandatit, si dhe menjëherë, në rastet e tjera të mbarimit të mandatit, njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e anëtarit të ri, në çdo rast përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka deklaruar përfundimin e mandatit.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Ju kuptova. I gjithë ndryshimi juaj është sidomos te pika 3, që lidhet me mënyrën e emërimit me shumicë të cilësuar, pa shumicë të cilësuar ose me një nga variantet e propozuara nga ju. Në rregull. Do ta zgjidhim atje, kur të zgjidhim atë, vetvetiu do të reflektohet këtu.

Oerd Bylykbashi – Sigurisht.

Fatmir Xhafaj – Dakord, dakord!

Neni 37. Dakord me këto sugjerime, për t’u reflektuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë për t’u reflektuar?

Oerd Bylykbashi – Pra, nuk mund të themi: neni 147, sepse kemi opsione, të cilat...

Fatmir Xhafaj – Për t’u reflektuar. S’kishte asgjë. I pashë unë.

Neni 38.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për ekspertët.

Në dispozitat e tjera, që rregullojnë masat disiplinore ose më saktë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, është përmendur pezullimi. Në rastin e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk është parashikuar mundësia e pezullimit, kur një anëtar i Këshillit Gjyqësor arrestohet, qoftë në rastin kur i është dhënë arrest me burg apo arrest në shtëpi, ose qoftë në rastin kur marrë i pandehur. Në fakt, me propozimin që bëri kolegu Majko, që mandati i tyre të pezullohet nga të qenit anëtarë në Gjykatën e Lartë ose si anëtarë në gjykatat e tjera, besoj se ata do të kenë përgjegjësi sikur të ishin gjyqtarë edhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në rast të shkeljeve.

Fatmir Xhafaj – Qartë. Në rregull.

Për sa kohë që ai, këtë e efektton nga të qenit gjyqtar, kuptohet automatikisht nga këshilli. Patjetër, se ai është pezulluar si gjyqtar dhe pastaj të shkojë në këshill. Dakord. Megjithatë, në rregull.

Zoti Deville.

Rainer Deville – Nëse ju prekni pavarësinë e gjyqtarëve duhet që ta bëni të qartë sepse ju prekni pozitën e garantuar të tyre. Këshilli i Lartë Gjyqësor është thjesht një strukturë menaxhimi dhe kështu që mund ta vendosni në ligj dhe prandaj referohet te ligji dhe sigurisht pezullimi duhet të jetë aty gjithashtu por nuk keni nevojë që ta shtoni dhe në Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Faleminderit.

Ka gjë tjetër për nenin 38?

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, në gjykimin tonë, këtu nuk janë reflektuar shqetësimet që ngritëm ne më parë, për nenin 38.

Po e nis nga diçka më e vogël, për të arritur te diçka që është më e rëndësishme. Përveç asaj që gjyqtarët mbajnë përgjegjësi për shkeljet e rënda profesionale ose etike, që pastaj ia delegojmë ligjit, e për rrjedhojë e ulim garancinë, pra nuk kemi një minimum këtu, për sa u përket kritereve, sidomos për diçka që është vështirësisht e matshme, në lidhje me aspektin etik, neve, gjithashtu, na duhet të bëjmë një dallim të qartë midis arsyeve të shkeljeve të rënda profesionale ose etike. Kur, kur kanë ndodhur këto? Në momentin kur ai ushtron detyrën dhe vetëm për atë që është duke ushtruar detyrën si anëtar i këshillit të Lartë Gjyqësor? Sepse, në qoftë se nuk e sqarojmë fare mirë këtë, mund të interpretohet që, përveç rastesh kur ka dënime

penale për veprime të mëparshme, le të themi, ose papajtueshmëri funksioni, mundet që të përdoren si arsye edhe shkelje të tjera profesionale apo etike, kur para se ai të merrte detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duhet bërë qartë kjo ndarje, në çdo rast, për të mos pasur ndërhyrje të jo të duhura në KLGJ. Gjithsesi, unë besoj se problemi kryesor këtu është mosreflektimi ende i një çështjeje, e cila është pranuar si çështje e karakterit politik për t'u zgjidhur, që ka të bëjë me arkitekturën e së gjithës, prezenca e Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë. Ky është një organ, i cili duhet riparë në diskutimin e përgjithshëm që kemi, për thjeshtimin dhe funksionalitetin e plotë të sistemit, ndërkohë duke garantuar luftën kundër korporatizmit dhe përgjegjshmërinë e sistemit. Kështu që deri sa të zgjidhet kjo çështje, unë besoj në të gjitha këto aspekte. Ky nen nuk reflekton shqetësimet principiale, por dhe teknike të ngritura nga Partia Demokratike.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Për sa i përket pjesës që lidhet me propozimin teknik për ta saktësuar gjatë kohës që ai është në detyrë mbetet një gjë që ekspertët duhet ta shohin në zbardhjen finale.

Për sa i përket gjyqimit politik unë mendoj se diskutimi në parim, lidhur me arkitekturën, është një diskutim i mbyllur dhe nuk kemi pse e rihapim, plus që jemi këtu për të vazhduar me projektin, jo për probleme të reja për projektin.

Faleminderit!

Neni 39. Është i njëjti standard që kemi bërë dhe me Gjykatën Kushtetuese dhe me Gjykatën e Lartë. Jemi dakord?

Oerd Bylykbashi – Po, janë të njëjtat probleme që kemi diskutuar në të shkuarën...

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 40.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, te neni 147/c nuk pata mundësi të bëja një propozim për shkak të ndërprerjes. Po të doni, mund ta bëj një propozim. Ju kërktoj ndjesë që po rikthehem përsëri te neni 147/c.

“Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Ai shkarkohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese, kur:

a. Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

b. Vërtetohet se ka faj, pasi ka vepruar me dashje ose me neglizhencë të rëndë, apo të pajustificuar në keqinterpretimin e ligjit, përcaktimin e pasaktë të fakteve, apo vlerësimin e gabuar të provave që nevojiten për ushtrimin e funksioneve të tij.

c. Kryen shkelje të tjera të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e anëtarit të këshillit, sipas përcaktimeve të bëra me ligj.

2. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij. Ai nuk mban përgjegjësi për interpretimin e ligjit, përcaktimin e fakteve, apo vlerësimin e provave që nevojiten në ushtrimin e funksioneve të tij, përveçse kur votohet që ai ka faj, pasi ka vepruar me dashje, neglizhencë të rëndë apo të pajustificuar.

3. Procedimi disiplinor i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese. Procedura për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore rregullohet me ligj e garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor”.

Ky është një propozim i mundshëm.

Fatmir Xhafaj – Mbajeni në procesverbal, por kjo besoj se është një çështje e tejkaluar. Neni 40. Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Oerd Bylykbashi - Po e përsëris në vija të përgjithshme, pa u zgjatur shumë, problemet që duhen zgjidhur këtu në lidhje me mënyrën se si do të emërohet inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra, ILD-ja, është një organ i cili për rëndësinë që ka, në qoftë se ne nuk zgjidhim çështjen e kapjes politike nëpërmjet votimit, sigurisht që problemi do të shtrihet në aspektet e tjera të të gjithë sistemit. Kjo zgjidhje mund të çojë në rishikimin e konceptit. Pra, ne kemi parashikuar sot një organ monokratik, i cili zgjidhet me një votim maxhoritar me shumicë të cilësuar. Do të na duhet të gjejmë një zgjidhje pikërisht për këtë e cila mund të reflektojë dhe përbërjen e institucionit.

Sigurisht këtu reflektohet nevoja për të zgjidhur çështjen e rolit që ka Këshilli i Emërimeve në drejtësi dhe mënyra se si do të përzgjidhen kandidaturat që shkojnë për t’u votuar në Kuvend për inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Sigurisht që do të na duhet të shohim në mënyrë më të plotë rolin që ka inspektori i lartë. Pra, ku do të shtrihet funksioni i tij i inspektimit, ku do të shtrihet kompetenca e tij e inspektimit dhe si mund ta forcojmë më tej, zoti Majko, kompetencën e ILD-së, por, nga ana tjetër, të forcojmë edhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Mundet që parashikimet, nëse biem dakord, që inspektori i Lartë i Drejtësisë të marrë

kompetenca kontrolli që sot ushtrohen nga institucione jashtë sistemit të drejtësisë, si për shembull ILDKP-ja, në momentin kur ne përcaktojmë fushën e veprimit të ILD-së dhe këto kompetenca që kanë të bëjnë me kontrollin e integritetit të zyrtarëve, sigurisht më pas ne mund ta shohim më me kujdes edhe mënyrën se si dhe ku shtrihet veprimi i ILD-së në sistem, duke evituar konfliktin ose problemin që mund të shkaktohet nga konflikti i interesit midis organeve të ndryshme.

Këto janë disa komente që po bëj në lidhje me këtë çështje. Sigurisht që zgjidhjet e përgjithshme me karakter politik qoftë në aspektin e mënyrës së zgjedhjes, qoftë në aspektin e kompetencave, me të gjitha institucionet e përfshira, do të na japë mundësinë për ta ridefinuar ILD-në.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Po përpiqem të kuptoj natyrën e propozimit për nenin, por nuk po marr vesh gjë fare nga ajo çfarë paraqiti kolegu. Historinë e doktrinës politike e kuptoj, por për nenin nuk e di. Po vazhdoj me propozimin tim për nenin në respekt të kësaj që ne jemi mbledhur sot.

Për pikën 1 të nenit 40, që kombinon me nenin 147/d në draft, propozoj një riformulim të paragrafit 1. “Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të prokurorit të Përgjithshëm”.

Pra, kam bërë një ndryshim duke hequr pjesën e fundit të pikës 1.

Fatmir Xhafaj – Neni ngelet i njëjti. Pra, kërkon një riformulim.

Pandeli Majko – Ndërkohë propozoj që paragrafi të ndahet, ajo që kemi më poshtë, sepse bëhet fjalë për një kompetencë të një natyre tjetër të inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që ka të bëjë me auditin e gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë, ku shtohet pika 2, po citoj: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”.

Në pikën 3 dua të bëj vetëm një ndryshim. Lidhur me fjalën “Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet”, unë propozoj të bëhet “zgjidhet me 3/5-at e të gjithë anëtarëve...”.

Te paragrafi 5 fjalia e fundit: “shqyrtimi i këtyre ankesave vendoset nga një numër anëtarësh të këtyre organeve, sipas ligjit” propozoj të hiqet dhe sipas ligjit të vihet në fund të fjalisë së dytë. Fjalinë e fundit propozoj që të hiqet.

Fatmir Xhafaj – Ky është propozimi juaj? Keni ndonjë gjë tjetër? Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Pra, bazuar te ajo që lexojmë ne në raportin e Komisionit të Venecias unë dua të bëj këtë propozim.

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për:

a. Hetimin e shkeljeve disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tyre. Hetimi i shkeljeve kryhet bazuar në verifikimin e ankesave të paraqitura ose me nismën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas procedurave të parashikuara me ligj.

b. Kontrollin e deklaramit të pasurisë për gjyqtarët, prokurorët, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurorit të Përgjithshëm, oficerëve të njësisë së posaçme hetimore, si dhe të çdo funksionari që ka detyrimin e deklaramit të pasurisë dhe që ushtron funksionet pranë këtyre strukturave.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përzgjidhet nga lista e renditur e kandidatëve të hartuara nga një koleg me 3 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese caktuar me short. Procedura e përzgjedhjes dhe e emërimit të inspektorit të Lartë të Drejtësisë garanton kandidimin e hapur, konkurrimin e ndershëm midis shumë kandidatëve, vlerësimin krahasimor përmbushës të kriterëve, transparencës dhe standardeve të tjera të procesit të rregullt ligjor.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet me 2/3-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë riemërimi nga radhët e 5 anëtarëve të renditur më lart në listën e hartuar nga Gjykata Kushtetuese. Nëse asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave në Kuvend përsëritet një votim i dytë brenda 7 ditëve nga radhët e 10 kandidatëve të kualifikuar më lart. Nëse dhe në votimin e dytë nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidati që është renditur i pari nga Gjykata Kushtetuese, sipas parimeve të meritokracisë, konsiderohet i emëruar.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të jetë me shtetësi shqiptare dhe përzgjidhet nga radhët e juristëve me aftësi të larta profesionale. Ai duhet të ketë njohuri të thella të veprimtarisë publike dhe të sistemit të drejtësisë, si dhe të paktën 15 vjet përvojë në profesion. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të përgëzojë integritetin më të lartë profesional dhe moral. Ai nuk duhet

të ketë mbajtur funksione politike në organet publike, apo një funksion në ndonjë parti politike gjatë periudhës së përcaktuar, po themi vite përpara kandidimi.

5. Rregulla më të detajuara për vlerësimin e kushteve dhe kritereve, si dhe për procedurën e kandidimit të përzgjedhjes dhe të emërimit përcaktohen me ligj.

6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë pas përfundimit të mandatit. Nëse para emërimit në këtë detyrë punonte me kohë të plotë në sektorin publik, inspektori rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në pamundësi në një detyrë të barazvlefshme me të.

7. Procedurat për marrjen e vendimeve nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rregullohen me ligj.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Vasili

Petrit Vasili - Në opinionin përfundimtar të Komisionit të Venecias paragrafi 33, opinionin përfundimtar, kërkohet rishikimi i rolit të ministrit të Drejtësisë, çështjet disiplinore. Komisioni i Venecias ka sugjeruar në këtë paragraf që ankesat e ministrit do të shqyrtohen në të njëjtën linjë si ankesat e tjera. Pra, inspektori do të verifikojë pranueshmërinë e *prima facie-s* të të gjitha ankesave, njëri variant, ose kam propozuar që ministrit duhet t'i jepet e drejta e pavarur për të sjellë ankesa direkt para këshillit, pa kaluar tek inspektori. Sigurisht që këtu mund të gjejmë dakordësi, por duhet një reflektim dhe, meqë jemi te çështja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe tek trajtimi i ankesave, besoj se duhet ta kemi një pozicionim, sepse Komisioni i Venecias ka propozuar edhe zgjidhjet për këtë punë, pra ka ofruar dy variante. Sigurisht, ai variant, që na afron me shumë me njëri-tjetrin, duhet të pranohet. Gjithsesi, në të gjitha rastet, duhet të reflektojmë për këtë çështje, pasi Komisioni i Venecias është shprehur qartë duke dhënë edhe opsionet lidhur me këtë çështje. Besoj se ky është vendi i duhur që ne të kemi edhe një pozicionim për këtë punë.

Fatmir Xhafaj – Që të jem edhe unë i qartë në këtë pozicion, pa e mbivendosur ekzekutivin në funksionet e gjyqësorit, unë përkrah mendimin e hershëm, të cilit i qëndroj edhe sot, për një rol shumë aktiv të ministrit të Drejtësisë në sistem, natyrisht, duke mos penguar aftësinë vetërregulluese të sistemit, por të jetë si një vlerë e shtuar që mund ta ndihmojë efektivisht goditjen e frymës korporatiste të sistemit, si dhe të jetë njëherësh një mundësi për të rregulluar më mirë balancat dhe kontrollin ndërmjet pushteteve. Kështu që ka nevojë të reflektojmë tek opinionin final i Komisionit të Venecias, ku ka më shumë hapësira se në projektin

që kemi trajtuar këtu. Gjithsesi, u mbetet ekspertëve ndërkombëtarë për të riparë te zgjidhja finale.

Zoti Devil, në mos gaboj, kishit një koment për të gjithë debatin që u bë.

Rainer Deville - Për këtë pikë të fundit duhet që të bëjmë dallimin e pyetjes që ministri i drejtësisë mund të sjellë një ankesë për masë disiplinore – kemi patur këtë në draftin e mëparshëm – ku i dhamë atij një rol të veçantë të cilin e hoqëm më vonë për shkak të komenteve të Komisionit të Venecias. Kështu që Ministri i Drejtësisë mund të sjellë një ankesë që shkon në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe këto të fundit janë institucionet relevante që vendosin për këtë ankesë. Sidoqoftë, në nenin 174/d kemi paraqitur hetimin, dhe ky hetim duhet të jetë i pavarur nga pushteti ekzekutiv, kështu që kemi stopuar sistemin aktual ku Ministri i Drejtësisë ka të drejta hetimi. Kjo është bërë pasi tani kemi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë që merret me këtë detyrë, por Ministri ka të drejtën të mbledhë informacion dhe prova dhe të dërgojë ankesë, por ai nuk heton sepse ministri nuk është prokuror. Kjo është arsyeja pse ai nuk është në nenin 147/d, sepse ai ka të njëjtin rol si të gjithë dhe për këtë ne nuk e kemi përmendur në Këshillin e Lartë Gjyqësor, pra sepse ai ka të drejta si të gjithë të tjerët. Ne nuk kemi nevojë që të rregullojmë një të drejtë specifike. Çfarë duhet të rregullojmë në nenin 147/d është pyetja nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet të ketë buxhetin e tij që do ta administrojë vetë sepse çështja e buxhetit është në juridiksionin e tij. Nëse buxheti do jetë pjesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, kjo nuk do të garantonte pavarësinë e plotë dhe kjo mund të shtohet në pikën 1 të nenit 147/d ku ai ta propozojë dhe ta administrojë vetë çka do të sillte më shumë pavarësi.

Petrit Vasili – Unë e dëgjova komentin e zotit Devil dhe mendoj se ne jemi këtu për t'i qartësuar rolet dhe nuk besoj se Komisioni i Venecias e saktëson këtë gjë rastësisht në paragrafin 33 të opinionit përfundimtar. Mendoj se ne duhet të bëjmë reflektimet përkatëse, pasi ministri është një institucion, është përfaqësues i ekzekutivit për fushën përkatëse dhe nuk është një ankues si të gjithë të tjerët, por ka një përgjegjësi publike dhe politike të veçantë dhe të qenit i qartë edhe në shprehjet e këtij neni do ta ndihmonte qartësimin e procesit. Thjeshtësimi dhe dobësimin i rolit, jo thjesht i ministrit, por i ekzekutivit në këtë çështje, duke pasur parasysh ndjeshmëritë e mëdha publike, që përplasen natyrshëm në dyert e ekzekutivit, do të ishte më i qetë edhe opinionin publik, edhe qytetarët, duke ditur se ka një mundësi të mbrojtur me Kushtetutë, një garanci që ankesa shkon. Kjo nuk do të thotë se është ministri ai që e gjykon, por

tagri i veçantë që ai i merr këto ankesa dhe fakti që ato shkojnë atje, rrit besimin që çdo shqetësim i publikut përcillet, sigurisht duke mbajtur të njëjtën frymë për gjykimin në bazë të tagrit që neni i jep edhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të gjithë mekanizimit. Një rol i nënkuptuar dhe jo eksplicit nuk besoj se do ta ndihmonte shumë publikun, por nuk është edhe saktësisht në frymën e opinionit përfundimtar të “Venecias”, të cilin e shoh si një opinion korrekt dhe të ekuilibruar. Siç thashë, në ato opinion ofrohen dy variante dhe unë isha për një variant edhe më të thjeshtëzuar dhe me një shprehje goxha modeste, siç ishte paraqitja e ankesave, pa i mëshuar fort rolit të paraqitjes direkte të kërkesave në këshill. Kjo gjë nuk ndoshta do të ishte një herezi. Gjithsesi, na ndihmon të gjithëve, ndihmon ekzekutivët e të gjitha kohërave, pasi Shqipëria do të ketë gjithmonë një ekzekutiv të saj, që të ketë një rol të qartë në këtë moment delikat, siç është ai i raportit me publikun, i cili nuk është i kënaqur dhe kërkon që ankesat e tij të shqyrtohen. Kjo nuk do të thotë absolutisht se çdo ankesë do të zgjidhet ashtu siç e kërkon ankuesi, por, së paku, ne garantojmë kushtetutshmëri, qetësinë se ankesat, që paraqiten në instanca të caktuara, në mënyrë të veçantë ekzekutivi është ai vijës së parë, kanë mundësinë e shqyrtimit dhe garancinë kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Keni një koment tjetër?

Rainer Deville - Në këtë çështje ju keni vështirësi nëse Ministria e Drejtësisë e sjell atë direkt në Këshill, e cila është një nga mundësitë, dhe nuk ka aktivitete të tjera hetimore. Vendimi është bërë gjithmonë nga Këshilli, vendimi nuk është bërë nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë. Pra, nëse ju e anashkaloni atë, atëherë edhe e dobësoni atë, kështu që versioni i zgjuar është që Ministria e Drejtësisë mbledh atë dhe kjo mund të arrihet nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë e më pas vazhdon. Por, ky sigurisht është vendimi juaj. Ju mund edhe ta shtyni atë dhe në rast se Këshilli i Lartë i Drejtësisë dëshiron që të hetojë më gjerë, atëherë rasti nuk është i përgatitur mirë. Natyrisht ky është vendimi juaj se si do të vendosni ta bëni.

Petrit Vasili – Besoj se ka pasur një keqkuptim në të gjithë frazën time. Nuk thashë absolutisht versionin e dytë. E citova si një version që Komisioni i Venecias e ka përmendur. Personalisht, jam pro variantit të parë që ka paraqitur Komisioni i Venecias. Thashë që edhe varianti i dytë nuk do të ishte herezi. Nuk është propozimi im, por të dyja propozimet i ka bërë “Venecia”. Megjithatë, për hir të kontekstit të gjërave dhe të ngarkesave të caktuara, kam qenë më familjar me versionin e parë, por kam bindjen se kjo duhet të jetë e shprehur në Kushtetutë.

Këtë çështje e kam pasur eksplicite, pra ne duhet të shprehemi në Kushtetutë. Nuk fola për versionin e dytë në mënyrë preferenciale.

Fatmir Xhafaj – Këto mbetem për t’u parë nga ekspertët gjatë reflektimeve. Ky është një opsion që duhet të diskutohet. E mbyllim këtu diskutimin për nenin 40.

Vazhdojmë me nenin 41 “Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Nuk besoj se kemi ndonjë gjë për të thënë, sepse i kemi ezauruar.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, kemi momentin kur mbarimi i mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deklarohet me vendim të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kjo, deri diku, kuptohet për shkak të ndikimit dhe rolit që ai ka në të dyja këto piramida, por jemi përpara mundësisë që të dështojë kjo lloj zgjedhjeje nëse këto dy trupa, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë të Prokurorisë, nuk e bëjnë mbledhjen e përbashkët brenda një afati. Ata mund të kenë edhe arsytet e tyre. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është funksion që inspekton edhe këto trupa.

Fatmir Xhafaj – Të shkelin Kushtetutën?

Oerd Bylykbashi – Nuk është ndonjë çudi. Domethënë, është një vendim i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2004, nëse ju kujtohet, kur parlamenti nuk e respektoi afatin kushtetues dhe Gjykata Kushtetuese tha: “Bëjeni një ditë; mjafton ta bëni”. Për sa kohë nuk ka një penalitet, nuk është antikushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, është e qartë. Ta vëmë në ligj atë.

Oerd Bylykbashi – Dakord, por çështja është se kjo mund të dështojë dhe kjo na çon menjëherë te pika 3 “Mosdeklarimi i një gjëje që ka ndodhur”, për rrjedhojë kemi kapërcim të afatit të përcaktuar nga mandati. Kështu që duhet të shihet një zgjidhje, e cila do t’i jepte një zgjidhje të plotë kësaj.

A mund ta bëj një propozim?

Fatmir Xhafaj – Dakord, vetëm mos e lexo komplet nenin.

Oerd Bylykbashi – “Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbaron kur: mbush moshën e pensionit; jep dorëheqjen; shkarkohet...” (hiqet ajo historia e mandatit), pra janë rastet e përcaktuara të mbarimit të mandatit.

Pika 2: “Mbarimi i mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Kur mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përfundon, për shkak të

pensionit ose të mbarimit të kohëzgjatjes së mandatit, ai qëndron në detyrë deri në emërimin e inspektorit të ri”.

Pika 3: “Kuvendi, jo më vonë se tre muaj para përfundimit të mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shkak të pensionit, apo mbarimit të kohëzgjatjes së mandatit dhe menjëherë në rastet e tjera të mbarimit të mandatit njoftojnë Gjykatën Kushtetuese për deklarimin e mbarimit të mandatit. Procedura për emërimin e inspektorit përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i deklarimit të përfundimit të mandatit.

Fatmir Xhafaj - I qëndroni versionit që ky caktohet nga Gjykata Kushtetuese etj. Keni koncept tjetër, por e kemi mbyllur këtë. Unë jua thashë mos e koklavisni më shumë. Megjithatë kjo është e drejta juaj ta rithoni pozicionin tuaj.

Dakord.

Oerd Bylykbashi -Zoti kryetar, e kam për procedurë.

Çështja që ngrihet edhe nga Komisioni i Venecias, që sistemi është një çështje e përzgjedhjes politike, një vendimmarrje politike, sa kohë që edhe Komisioni i Venecias flet për një sistem, i cili është shumë i rënduar, për sa kohë është një çështje politike e shtruar dhe e pazgjidhur, e përsëris, në rastin konkret, e pazgjidhur, është e kotë të themi që është zgjidhur ose jo, kemi rënë dakord ose jo. Kur të zgjidhet e gjitha, do t’i japim drejtim dhe këtij elementi në lidhje me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Fatmir Xhafaj – Neni 42. “Përgjegjësia disiplinore dhe shkarkimi i Inspektorit të Lartë nga tribunali”.

Keni gjë për këtë nen?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 42 kemi pasur një diskutim kur diskutuam në parim, lidhur me procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore, në rastet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në pretendimet ose shqetësimet që ngritën kolegët e opozitës, që kërkonin të kishte dhe një përfshirje më të madhe të parlamentit. Nga ana tjetër, të dyja palët, si opozita dhe maxhoranca në këtë komision ngritën shqetësimin që propozimi i bërë në draft, për të pasur një komision hetimor parlamentar që mund të shqyrtonte procedurat dhe përgjegjësinë disiplinore të inspektorit, nuk u mirëprit. Ekspertët kanë sjellë një riformulim, një opsion të mundshëm duke parashikuar që pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të hetohen nga një deputet i Kuvendit. Unë personalisht e quaj të vështirë, do të thosha në kufijtë e

pamundësisë, që një deputet i vetëm në Kuvendin e Shqipërisë të bënte një verifikim të pretendimeve lidhur me shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Këtu kam disa argumente.

Së pari, pavarësisht se thuhet që deputeti duhet të ketë arsim të lartë juridik, jo të gjithë deputetët me arsim të lartë juridik në Kuvend mund të marrin përsipër dhe të bëjnë “rolin e prokurorit” për të hetuar të gjitha pretendimet në lidhje me shkeljet disiplinore që bën Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Së dyti, propozimi që bëhet, që deputeti të zgjidhet me short nga Kryetari i Kuvendit, e bën edhe më të dobët pozicionin e personit ose të deputetit që përzgjidhet. Unë dua të më mirëkuptojnë të gjithë kolegët, nuk kam absolutisht asnjë gjë konkrete për asnjë deputet, por ju e dini që nga 140 deputetë që ka Kuvendi i Shqipërisë, ku midis tyre numri i juristëve është i pakët, jo të gjithë kanë ato aftësi për të bërë një hetim të tillë. E them këtë, sepse shorti mund t'i bjerë edhe një personi që mund të ketë mbaruar një fakultet drejtësie, por që nuk ka aftësitë, kualifikimin për të bërë atë që e thashë pak më parë, hetimin dhe verifikimin e pretendimeve për shkelje disiplinore të Inspektorit të Arsimit të Lartë. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh përbërjen e parlamentit, përbërjen e Komisionit të Ligjeve, për faktin që në këto 20 vjet në Shqipëri ka pasur fakultete publike dhe private që kanë dhënë diploma të drejtësisë, mund të ndodhë që të përzgjidhen persona që mund të kenë një diplomë, për aq kohë sa ne nuk i diskriminojmë universitetet, që mund të vënë në dyshim nivelin real të formimit në fushën juridike. Prandaj, në këtë opsion që ju keni ofruar do të sugjerim të bënim një reformulim tjetër duke respektuar, në radhë të parë, sugjerimin që ju, të nderuar ekspertë, keni bërë që anëtari duhet të jetë nga Komisioni i Ligjeve.

Pa dyshim që mund të jetë dhe një opsion tjetër, por unë personalisht kam qenë kundër komisionit hetimor parlamentar, për mënyrën se si ne funksionojmë dhe me ligjin që kemi, por le t'i lihet Komisionit të Ligjeve. Rregullat parashikohen në Rregulloren e Kuvendit si dhe të kemi parasysh praktikën e Gjykatës Kushtetuese, pasi ekziston një praktikë të Gjykatës Kushtetuese. Pra, mos t'i lihet një individ të vetëm, por të shikohen 2 alternativa. Ose t'i lihet Komisionit të Ligjeve, ose, nëse do t'i rikthehemi idesë që ne në mbledhjen e kaluar debatuar fort për komisionin hetimor parlamentar, pa dyshim që ai duhet të përbëhet nga juristë, si dhe duhet të bëjmë ndryshime edhe në ligjin “Për komisionet hetimore parlamentare”, se përndryshe pastaj do të kemi komisione me 2 raporte, siç dalin tani, që nuk kanë fare debat profesional, por vetëm

diskutim politik. Ne mund ta vëmë në pozitë të politizimit një shqetësim ose një pretendim që mund të ngrejë Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Pra, në vend që ta rregullojmë, ta përmirësojmë situatën, do ta politizojmë atë. Ky do të ishte një dëm shumë i madh.

Ndaj, zoti kryetar, do të kërkoja të shikonim një mundësi sa më profesionale dhe sa më larg debatit politik.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka të tjerë për të diskutuar? Po, zoti Bylykbashi .

Oerd Bylykbashi – Sigurisht me rolin që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk është aspak për t'u çuditur që inspektori të mos performojë në atë që pritet. Sigurisht ai nuk jep drejtësi, por ai duhet të bëjë inspektimin e shkeljeve për ndonjë gjyqtar dhe këtë do ta bëjë në mënyrë të shpejtë, me cilësi të lartë. Por ai mund të performojë dhe në nivele që nuk janë ato të pritshmet, prandaj për këtë dhe duhet disiplinuar. Pra, duhen marrë masa disiplinimi në lidhje me të.

Kështu që për këtë nuk ka dyshim, por ajo që sugjerohet nga Komisioni i Venecias do të ishte një procedurë *impeachment*, dhe kjo jo vetëm që nuk është reflektuar, por është gjetur një mekanizëm i cili nuk e dimë çfarë modeli është dhe nga vjen, si edhe çfarë garancish dhe balancash garanton ky model për një çështje kaq të rëndësishme siç është ajo e disiplinimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që, për rrjedhojë, nëse do të ishte, do të lindte nevoja për ta zëvendësuar. Nëse ulim këta parametra, do të ishim përpara mundësisë për t'u ndikuar për mënyrën se si po disiplinohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Qëndrimi ynë është që këto formulime nuk kanë reflektuar ato që ngre Komisioni i Venecias në lidhje me këtë çështje. Sigurisht që mundet që shorti të çojë në situata që mund të jenë të pakuptueshme, po aq, mund të ngrihet një pyetje që Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk është i pezullueshëm për të njëjtat arsye që pezullohen anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Kemi raste të parashikuara, kështu që besoj ka nevojë për t'i dhënë zgjidhje dhe unë do të bëj një propozim në lidhje me këtë.

“Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit. Ai shkarkohet nga detyra kur:

a. dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi,

b. vërtetohet se ka faj pasi ka vepruar me dashje apo me neglizhencë të rëndë apo të pajustificuar në keqinterpretimin e ligjit për caktimin e pasaktë të fakteve apo vlerësimin e gabuar të provave që nevojiten për ushtrimin e funksionit të tij,

c.kur vërtetohet se nuk vepron për përmbushjen e rregullt të detyrës apo kur shkel me faj në mënyrë të përsëritur detyrimin për të zgjidhur në mënyrë të njëjtë çështje të ngjashme,

d) kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij sipas përcaktimeve të bëra me ligj.”

2. Procedimi disiplinor ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë fillohet me mocion të 1/5 së deputetëve të Kuvendit, dhe Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton shkeljen dhe vendos për përgjegjësinë disiplinore dhe shkarkimin e tij.”

3) “Procedura për shqyrtimin e rregullave disiplinore rregullohet me ligj dhe garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor.”

Ky është propozimi për një version të mundshëm të këtij neni, por kemi bërë një përpjekje që të listojmë disa kriterë më të detajuar në nëntekstin kushtetues për një organ kaq të rëndësishëm duke mos ia lënë çdo gjë detajimit me ligj, i cili mund të shkojë përtej asaj që ka qenë fryma e Kushtetutës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Nëse nuk keni për të shtuar diçka, e mbylлим këtu këtë nen. Kam vetëm një sugjerim: pa cenuar thelbin e projektit në mënyrë absolute, por për ta lehtësuar për mbajtjen e normave kushtetuese, përsëritjen e tyre, mos do të ishte më mirë që të mund të kemi një nen të përbashkët për të gjitha institucionet e reja të këtij kapitulli, ose duke përfshirë edhe prokurorinë, lidhur me përfundimin e mandatit, përgjegjësinë disiplinore, shkarkimin/pezullimin, për sa kohë që janë të njëjta mund t’i mblidhnim të gjitha në një nen? Kështu kemi mundësinë që ta lehtësojmë. Gjithsesi, është dhe çështja e teknikës së shkrimit, që duhet ta shohim për ta lehtësuar. Nenin 42 mbetet që ta rishikoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Keni opsion tjetër? Nuk jeni dakord?

Pandeli Majko – Mendoj se duhet të vendoset qartazi një pozicion, (po shpreh opinionin tim personal), e kam fjalën për Oerdin, dhe kërkuat që Këshilli i Lartë Gjyqësor të jetë

me formulë politike: dy nga maxhoranca dhe dy nga opozita. Ngriheni dhe kërkoni që parlamenti të ketë të drejtën të hetojë dhe të heqë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Ose nuk ka një kuptim të qartë të infrastrukturës që kemi krijuar deri tani, ose ne po rikthejmë edhe një herë Këshillin e Lartë të Drejtësisë! Në qoftë se do të ecim me këto propozime, mirë e kemi Këshillin e Lartë të Drejtësisë, madje unë propozoj të mbyllem diskutimet këtu dhe t'u themi ndërkombëtarëve që ne e kemi mirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor të quhet KLD dhe vazhdojmë. Dy përfaqësues nga maxhoranca dhe dy përfaqësues nga opozita, inspektorin e heqim kur të duam ne. Me këtë logjikë paskemi qenë shumë mirë. Po të mos kalojmë këtë reformë, ne rrezikojmë të futemi në grupin e shteteve të dështuara dhe gjithë klasa politike, përfshirë edhe kontributin tuaj, zoti Oerd, si propozuesi dhe rehatuesi i ligjit të dekriminalizimit, e keni dhënë.

Mënyra juaj e të trajtuarit të sistemit të drejtësisë është e njëlojtë me të njëjtin sistem që ekziston sot. Doni pjesën e politikës në sistem; doni vendimmarrjen e politikës në sistem; doni hetimin e politikës në sistemin e drejtësisë; gjithashtu doni edhe vendimmarrjen e politikës për të shkarkuar dhe për të vendosur njerëzit e sistemit të drejtësisë në sistem.

Por ç' do të bëjnë këta, kur ne të bëjmë të gjitha këto? Po ishim kështu, atëherë kot që e vazhdojmë diskutimin.

Oerd Bylykbashi – Në fakt, deri përpara tre vjetësh zoti Majko, do të kisha komoditetin e plotë për të thënë që, për t'u listuar te pjesa e problemit, kështu që është e kotë që të etiketojmë njëri-tjetrin. Kjo ishte e para.

E dyta, sistemi i drejtësisë, që ne përzgjedhëm në vitin '98, është një model evropian. Besoj se më keni dëgjuar mua apo kolegët e mi këtu që të kërkojnë vazhdimisht se cili është modeli. Fakti që ndër vite e kemi dëmtuar modelin edhe me sjellje, nuk do të thotë se modeli në vetvete është i gabuar. Ne modelin e kemi të mirë, por, për t'iu përgjigjur situatës shqiptare, na duhet të vendosim disa element, të cilat e bëjnë modelin funksional dhe të plotë. Pra, e bëjnë funksional si sistem; e bëjnë më të pastër, pa korrupsion dhe të pakapshëm nga politika. Modeli në vetvete është i drejtë dhe nuk kemi shpikur gjë ne, për rrjedhojë nuk mund të shpikim as këtë herë asgjë që është vetëm për Shqipërinë, sepse ne nuk jemi republikë bananesh. Kështu që mos u shqetësoni për sa i përket kësaj, do të na duhet që të gjejmë zgjidhje që këtë model ta bëjmë të mirë, së dyti, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e paaftë dhe të korruptuar t'i largojmë nga sistemi; janë dy gjëra të ndryshme. Nuk thërrmohet ndërtesa për shkak se ata që janë aty brenda

janë të korruptuar. Ndërtësën duhet ta ruajmë, aq sa duhet t'u ruhet, por të heqim ata që janë për t'u pastruar nga sistemi. Kështu që i qëndroj asaj që thotë vetë Komisioni i Venecias: “Një procedurë *impeachment* për inspektorin për shkelje të rënda”. Unë bëra një propozim, të cilin do ta diskutojmë dhe do të gjejmë një zgjidhje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbyllim këtë diskutim me dy pozicione të ndryshme për këtë pikë dhe me shqetësimin se duhet riparë e gjithë kjo dispozitë, sidomos pika 3, sepse për atë po bëhet debati: do jetë me *impeachment*; do të jetë me një deputet që të bëjë hetimin, i ngarkuar nga ligji; me një komision hetimor, ose nga vetë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut?!

Nenin 43 e kemi diskutuar në vijimësi. A ka nevojë t'i përsërisim fjalimet tona për këtë gjë? Nuk ka.

Neni i fundit për sot është neni 44. Ka ndonjë gjë lidhur me Tribunalin?

Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, kjo është një çështje që është e lidhur drejtpërdrejt me çështjen politike...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është një çështje, e cila është në themel të atij diskutimi politik: sistemi. Nëse Tribunali Disiplinor i Drejtësisë është organi i duhur apo jo; nëse do jetë ky apo do të jetë ndryshe, nëse nuk do të jetë ky, kujt do t'ia transferojmë këtë; nëse vdesim ne të gjithë, sistemi i drejtësisë pa Tribunalin e Drejtësisë do të jetë në ditë të hallit, të gjitha këto janë një seri çështjesh që do t'i zgjidhim qoftë në aspektin politik, qoftë në aspektin sistematik, qoftë në aspektin e moskapjes së sistemit, duke përfshirë dhe korporatizmin.

Së pari, Tribunali, i propozuar në formën që është, duke përfshirë në vetvete dhe duke e theksuar komponentin jogjyqtar, pra nga 1, që ka qenë një propozim më i hershëm, duke marrë 2 prokurorë nuk do të jetë më një trupë e cila ka gjyqtar brenda, pra persona, të cilët gëzojnë statusin e gjyqtarit, duke përfshirë atë që është qëndrimi i tyre në detyrë. Si e tillë, ne përballemi me problemin që është thënë në Komisionin e Venecias, pra me problemin që ka ky organ, i parashikuar në këtë formë në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo nuk është gjykatë, për rrjedhojë nuk garanton aksesin në një gjykatë. Nëse do të mbetet kështu, do të na duhej të parashikonim edhe nevojën për të bërë një ankim në një shkallë gjyqësori më tutje.

Duke thënë këtë, në këndvështrimin tonë, formulimet e këtij neni përplasen me atë që thonë Komisioni i Venecias dhe Konventa Europiane të të Drejtave të Njeriut. Dy prokurorët nuk përbëjnë gjyqtar. Nëse ky do të ishte një organ i karakterit administrativ, mund të fusim dhe jogjyqtarë, siç janë prokurorët, por me atë detyrë, që kemi lënë, nuk jemi aty ku kërkohet. Gjithashtu, për këtë përzgjedhjen duke u spostuar nga një nivel në një nivel tjetër të gjyqësorit dhe jo duke u kufizuar vetëm te një shkallë e nivelit të lartë, siç është Gjykata e Lartë, propozimi ynë ka qenë se duhet të ishte Gjykata e Lartë. Madje, edhe vetë ekspertët e pranojnë se Gjykata e Lartë është modeli standardë, por nuk na qenkan kushtet e Shqipërisë për ta bërë këtë! Për këtë do të bëj një koment të veçantë. Duke zbritur në nivelet e tjera, ne nuk marrim cilësi më të mirë se në Gjykatën e Lartë, ku janë funksionarët...

(ndërrhyrje pa mikrofon.)

Nuk është se do të marrim cilësi më të lartë, ndërkohë që do të importojmë të njëjtat problematika që kanë gjyqtarët, por cilësinë e kanë më të ulët. Nuk është kot dikush në gjykatën e lartë, sepse është moment promovimi dhe karriere, sidomos siç e parashikojmë te këto ndryshimet Kushtetuese. Kështu që nuk kemi zgjidhur asgjë, në qoftë se thuhet, qoftë edhe me *footnote*, në një dokument parlamentar, se ky është standardi, por Shqipëria nuk është në këtë standard.

Së pari, ne shpresojmë që brenda pak kohësh të hapim negociatat me BE-në. Mundet që fati të na sjellë që në një periudhë të shkurtër t'i përmbyllim këto negociata. Kështu që besoj se është i pavend theksimi i faktit se Shqipëria na qenka një model që nuk i ngjan askujt, për rrjedhojë duhet t'i aplikojmë një model që nuk e ka askush. Gjykata e Lartë i ka të gjitha mundësitë për ta bërë këtë dhe Tribunali Disiplinor i Drejtësisë nuk na shton, por, për më tepër, na i përkeqëson gjërat. Ne në mënyrë të vazhdueshme kemi kërkuar modelin ku është marrë, por modele, që nuk ekzistojnë askund, nuk kanë vend te kjo Kushtetutë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Zoti Majko, po të thelloheni pak, do ta kuptoni pse unë po i ngre këto pikëpyetje. Ju duhet të shikoni edhe një nga problemet kryesore që po na sjell ky model, që është ai i korporatizmit. Tribunali Disiplinor i Drejtësisë do të jetë ai që do të gjykojë vendimet e marra nga KLGJ-ja. Nga ana tjetër, në trupën përbërëse ka gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarë të tjerë. Pikërisht personat që janë subjekti i disiplinimit nga KLGJ-ja, një pjesë e tyre, do të jenë

edhe në Tribunalin e Drejtësisë, për rrjedhojë mund të bëjnë një detant mosndëshkimi me njëri-tjetrin dhe ky është korporatizëm i pastër.

Zoti Majko, siç e vini re, meqenëse ju çuditëni me problemet që ngre unë, jemi në themelin e problemit. Jemi ngatërruar me këmbët tona për të krijuar, gjoja, një institucion tjetër, por, duke shkuar te një model që nuk ekziston, e bëjmë më keq situatën ku jemi kemi: theksojmë korporatizmin. Kështu që, në këtë aspekt, mendoj se kjo është një çështje, e cila duhet të jetë subjekti i asaj zgjidhjes së përbashkët politike, që do të na çonte drejt një organi efikas, jashtë korporatizmit, jashtë kapjes politike dhe nuk do të na e komplikonte sistemin.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kam një ndërhyrje. Nuk e di nëse mund të jetë ose jo kjo si zgjidhje, sepse ka dy variante alternative, por dua ta mbroj shënimin e bërë nga ekspertët ndërkombëtarë. Pse kanë gjetur këtë zgjidhje?! Unë jam dakord me arsyetimin e bërë dhe shënimin e vendosur prej tyre. Jam dakord që Shqipëria do të bëhet vendi i BE-së, por nuk mendoj se do të bëhet vitin tjetër. Ata nuk kanë thënë se nuk ka vende anëtare të BE-së, që kanë hyrë vitet e fundit në BE, që nuk kanë probleme të tilla të ngjashme, por kanë thënë vendet me sistem të konsoliduar mund ta kishin këtë gjë. Mendoj se janë nisur nga një nisur nga një fakt konkret, dhe nga një praktikë konkrete. Ka të paktën 15 vjet që Gjykata e Lartë shqyrton vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ka po 15 vjet që 90% të tyre i ka rikthyer në detyrë, në mos më shumë. Pse? Për këtë shkak. Nëse nisemi nga kjo logjikë që u bë këtu, pse në këtë rast, kur formohet një trupë, siç është Tribunali që nuk janë në një korporatë të brendshme, siç është Gjykata e Lartë, por vijnë nga nivele të ndryshme, nuk kanë mundësi t'i unifikojnë qëndrimet dhe veprimet e tyre, që nga korporatizmi, kur janë anëtarët e Gjykatës së Lartë, që po ashtu shqyrtohen për përgjegjësi disiplinore nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Është shumë e thjeshtë lidhja e shkurtër për të krijuar frymën korporatiste kur e kemi nga Gjykata e Lartë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, sepse i thotë për të mbrojtur vetveten. E njëjta gjë është. Kurse për sa i përket asaj se mund të kenë ngjyrim politik, asnjë nga këta nuk ka *background* politik. Të gjithë janë në karrierë; janë profesionistë që nuk emërohen nga politika, pra asnjëri prej tyre që janë përbërëse e Tribunalit të Drejtësisë. A mund të ketë një zgjidhje me efeciente ndërmjet këtyre dy versioneve? Në qoftë se ka një zgjidhje më efeciente, hajde ta diskutojmë. Por më duket i arsyeshëm logjika që të mos e përqendrojmë të gjithë këtë praktikë te Gjykata e Lartë për argumentet e mësipërme. Ky është një qëndrim i ndryshëm nga i juaji.

Urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë ngrita çështje dhe zgjidhja mund të gjendet. Kështu siç është...

Fatmir Xhafaj – Derisa ka, është një variant me dy alternativa. Mund të shprehemi për të dyja alternativa. Të paktën, unë kështu e kuptoj.

Oerd Bylykbashi – Ajo që unë ngre si çështje është në themel: korporatizmi, kështu siç është, me këtë zgjidhje është keq. Të thuhet se Shqipëria është një lloj dele e zezë, së cilës nuk mund t'i vëmë asnjë lloj modeli, pra kjo që është shkruar në këtë *footnote*, unë nuk e pranoj.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Oerd Bylykbashi – Por mos harroni se ky dokument do të ngelet në analet e këtij parlament. Ne, në mënyrë absolute, nuk mund të flasim që Shqipëria na qenka një sistem që nuk i ngjaka askujt.

Fatmir Xhafaj – Ta tha “Venecia” që nuk bëhet; dhe me të drejtë.

Oerd Bylykbashi – Jo, bëhet. “Venecia” nuk ka thënë asgjë; bëhet dhe në mënyrë tjetër.

Fatmir Xhafaj – Po e thonë shqiptarët nga mëngjesi deri në darkë.

Oerd Bylykbashi – Lëri shqiptarët dhe populizmat, sepse nuk kanë lidhje me këtë. Ne këtu jemi për të bërë një punë që është me karakter tjetër, shqiptarëve do t'u japim atë sistem që do t'u bëjë atyre punë. Kështu është korporatist dhe nuk garanton cilësi.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Oerd Bylykbashi - Po ju jap një shembull, këtu është një përzgjedhje me short mes anëtarëve, nuk është kot fakti, e përsëri edhe një herë, që gjyqtarët janë në nivele të ndryshme, sepse është edhe çështje karriere, eksperience, aftësie, performance dhe për këtë arsye dikush rri në shkallë të parë, shkon në shkallë të dytë apo edhe në Gjykatë të Lartë. Përzgjedhja me short për një organ, i cili duhet të bëjë gjykimin e nivelit të lartë, për sa u përket standardeve të sistemit ne do t'i përzgjedhim, duke përfshirë edhe mundësinë që të kapim kualitetet mediokre brenda sistemit.

Fatmir Xhafaj - Kap variantin e parë, sepse ta jep varianti i parë.

Oerd Bylykbashi – Kështu që Gjykata e lartë (nëse kjo përbën një çështje, do të shikojmë nëse mund të ketë zgjidhje tjetër) mbetet e hapur. Ky është diskutimi që po bëj unë.

Fatmir Xhafaj – Varianti i parë është gati-Gjykatë e Lartë, shkon me këtë tuajin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Megjithatë, dakord.

Zoti Bylykbashi kishte një gjykim për të dyja alternativat e dhëna, si dhe një adresim lidhur me *footnote*-in, unë dhashë një këndvështrim në mënyrën sesi e shikoj unë me argumentet përkatëse dhe që e mbështes këtë pozicion. Kush ka një propozim konkret, meqenëse kemi dy alternativa?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar...

Fatmir Xhafaj – Vetëm se pa u zgjatur.

Vasilika Hysi – Pa u zgjatur, në qoftë se marrim përmbajtjen e nenit 147/f, i cili shtohet lidhur me Tribunalin Disiplinor të Drejtësisë, shohim se çështja e parë ose pyetja e parë që do të zgjidhim është: ndaj kujt vendosen masat?

Po të shikojmë se masat disiplinore, ato vendosen ndaj katër organeve shumë të rëndësishme: Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, kjo na çon në pyetjen tjetër: kush do t'ia vendosë këto masa disiplinore këtyre katër institucioneve shumë të rëndësishme?

Propozimi opsional i sjellë, varianti 2, që është me ngjyrë blu në dokumentin tonë, ia ka besuar një tribunali disiplinor të përbërë nga nëntë anëtarë, të cilët përfshijnë të tria shkallët e sistemit gjyqësor, por njëkohësisht ka përfshirë edhe prokurorë të Shkallës së Parë dhe të Apelit.

Më duket se ky riformulim ose ky opsion i sjellë në paragrafin e dytë e cenon atë çfarë ka thënë Komisioni i Venecias dhe neni 6, i cili kërkon që tribunali, duke pasur kompetenca gjyqësore, nuk mund të ketë përbërje anëtarësh jomagjistratë. Me fjalë të tjera, ne kemi shtuar në variantin ose në opsionin e dytë që janë tre prokurorë: një i Shkallës së Parë dhe dy të Gjykatës së Apelit.

Shqetësimi im tjetër është hierarkia ose vlerat që kanë gjithë këta gjyqtarë.

Pa dashur të paragjykoj asnjë gjyqtar, qoftë atë që punon në Shkallën e Parë, qoftë atë në Apel apo atë në Gjykatën e Lartë, fakti se gjashtë anëtarë të këtij Tribunali i përkasin Shkallës së Parë, pra Apelit, dhe përzgjedhja e tyre bëhet me short, e bën pak delikate vendimmarrjen e këtij tribunali.

Në radhë të parë, shorti mund të duket se jep transparencë, por ne nuk e dimë se kujt i bie. Pra, jo të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Shkallën e Parë dhe të Gjykatës së Apelit janë më të mirët.

Ju do të thoni: do të kalojnë procesin e vlerësimit. Po, do ta kalojnë procesin e vlerësimit, por vetëm se do të jenë ekselentë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe në procesin e vlerësimit, sepse do të ketë disa nivele.

Nga ana tjetër, fakti se zgjerohet me tre prokurorë e bën pak më të dobët, më delikate, vendimmarrjen e një trupe, e cila duhet të jetë gjykatë.

(Diskutime në sallë.)

Në këtë kuadër do të kërkoja nga ekspertët për ta riparë variantin e dytë, atë të mundshëm, duke pasur parasysh edhe variantin e parë të projektligjit, i cili anon më shumë nga Gjykata e Lartë.

Unë jam më në favor për nga Gjykata e Lartë, zoti kryetar, por duke pasur mundësi që trupa të përbëhet nga më shumë gjyqtarë dhe të ketë të paktën një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, jo më shumë, gjithnjë kjo për mendimin tim, sepse është delikate; duhet të jetë gjykatë.

Gjithashtu, jam pak skeptike lidhur me shortin nëse do të pranohet opsioni i dytë i mundshëm. Pra, jam më në favor që të punohet dhe të ketë rregulla më strikte, më të qarta të ligji specifik, i cili do të flasë rreth organizimit të të gjitha këtyre institucioneve që krijohen në kuadër të reformës në drejtësi.

Lidhur me paragrafin e parë, e tretë dhe të katërt të nenit 147/f, si në variantin e parë dhe të dytë, unë nuk kam komente, sepse janë të njëjta dhe nuk paraqesin probleme.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Po i bie shkurt, se jemi zgjatur me diskutimet sot, por mendoj që është shumë e rëndësishme kjo që po diskutojmë tani si nen, për Tribunalin Disiplinor të Drejtësisë, i cili mbetet thembra e Akilit në çdo rast për mirëfunksionimin e këtij sistemi që po ndërtojmë.

Unë jam për variantin e parë në tri pikat e para dhe propozoj që paragrafi i parë të mbetet ashtu siç është, pikë 1.

Në pikën 2 dua bëj një korrigjim të vogël teknik, ku thuhet (po e lexoj): “Tribunali Disiplinor i Drejtësisë përbëhet nga kryetari i Gjykatës së Lartë; dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit; kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative; dy gjyqtarë të Gjykatës Administrative, sipas ligjit, dhe një prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme, i zgjedhur sipas ligjit”. Kaq.

Në pikën 3 jam përsëri dakord (të mbahet pika 3 e variantit të parë) dhe propozoj të shtohet një pikë 4, ku kryetari i Gjykatës së Lartë është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, është!

“Kryetari i Gjykatës së Lartë është kryetari i Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë, i cili krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë”.

Është shumë e qartë që ne kemi një histori që na dallon dhe që ka të bëjë në thelb me shumë gjëra, por unë dua të them për këtë nen se nuk i besoj përgjegjësisë së goglave.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po e përsëris: nuk i besoj përgjegjësisë së goglave për një institucion kaq të rëndësishëm, i cili kërkon një përgjegjësi të mirëfilltë institucionale për çështjet që do të marrë në diskutim.

Po e mbyll këtu dhe mendoj se jemi shumë të qartë në dallimet me kolegët tanë të nderuar të opozitës: ne jemi që gjyqtarët t’i gjykojnë gjyqtarët pa gogla dhe politika të mos ndërhyrë fare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po.

Ka tjetër mendim lidhur me këtë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Smibert.

Jon Smibert - Në lidhje me disa gjëra që janë thënë sot. Së pari, nëse Gjykata e Lartë do të jetë një organ i përshtatshëm, dhe siç themi në *footnote* ajo nuk është e tillë, megjithatë ne gjejmë se ajo është një lloj kombinimi i çështjeve që kanë qenë ngritur në të kaluarën nga njerëzit – të tipit si korporatizmi - dhe pastaj mendoj se zoti Halimi në një moment tha se më mirë të kemi disa mediokër se sa të jenë politikisht të varur. Ne kemi pyetur gjatë gjithë kësaj kohe 18 mujore kush vëzhgon vëzhguesit, kush vëzhgon vëzhguesit, kush vëzhgon vëzhguesit? Tani do të jetë kush i zgjedh vëzhguesit që do të vëzhgojnë. Kjo është pambarim tani. Le të mendojmë për një trupë që vetëm shqyrton një grup të vogël të njerëzve. A mund të jetë kjo

Gjykata e Lartë? Sigurisht ajo mund të jetë, por problemi është, atëherë ju keni një Gjykatë të Lartë që gjykon mbi persona me të cilët ata janë disiplinarisht rivalë si për shembull Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pra, korporatizmi i cili është një shqetësim i madh ekziston ende. Është një pikë shumë e mirë që ju nuk besoni në fluska, por problemi është që ju duhet të vendosni cilët do të jenë më pas. Duke u përqendruar në një grup të vogël njerëzish ajo krijon diçka që është e mundshme në bazë të nenit 6, sepse shumica e anëtarëve janë gjyqtarë dhe ju duhet të mbani mend që të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në të gjitha këto vende që kanë këshilla gjyqësore dhe prokuroriale janë subjekt discipline. Kjo është thënë edhe në një opinion të Komisionit të Venecias, pika 6. Unë mendoj se do të jetë e mjaftueshme që ju keni anëtarë të prokurorisë që janë atje ajo nuk ndikon në cilësinë e të qënurit një gjykatë. Çështja më e madhe edhe pse është në fund të të gjitha këtyre çështjeve është se të gjitha këto ankime do të shkojnë në Gjykatën Kushtetuese ashtu sikurse të gjitha ankesat ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial do të shkojnë në Gjykatën Kushtetuese. Pra, në fund ka akses në një gjykatë. Pyetja e madhe mendoj unë në gjithë këtë ushtrim është për këtë grup të vogël të njerëzve të cilët janë shumë të rëndësishëm dhe masa disiplinore kundër tyre do jenë diçka që operon nën Gjykatën e Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë është kryetari i këtij Tribunali në bazë të këtij opsiioni/modeli të qëndrueshëm. Por në vend të saj, prapë ideja që të ekzistojë ende aspekti i korporatizmit thjeshtë duke qenë vetëm në Gjykatën e Lartë, të paktën ka shtuar disa aktorë të tjerë në këtë trupë. Pra, jepet ideja që është Gjykata e Lartë ajo që përpiqet për të zgjeruar/zvogëluar korporatizimin. Ishte një zgjedhje me short e cila është diçka që është diskutuar edhe në takimet e mëparshme, por kjo është diçka ku ne morëm parasysh shqetësimet dhe ju dhamë një model të cilin ne ndjejmë se ishte një alternativë e arsyeshme. Ju sigurisht mund të vendosni për opsiinin e Gjykatës së Lartë, por unë mendoj se atëherë ju përsëri do të zbulonit me kalimin e kohës se ka ende aspekte të korporatizmit gjë për të cilën jeni shqetësuar gjithmonë. Kjo është një përpjekje për të provuar dhe reduktuar atë proces.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të bëni një koment rreth ndërhyrjes?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Oerd Bylykbashi – Shorti në vetvete nuk është diçka e panjohur, por shorti ka komente mbi të, të bëra nga ekspertët ndërkombëtarë, gjithashtu, që rrezikon, pra i ka shanset 50 me 50, të mos përzgjidhet më i miri, por të përzgjidhet mediokri.

Ne mund të pranojmë edhe një nivel mediokër, por në nivele kaq të larta duhet të bëjmë kujdes. Pra, një short i cili na prodhon, po themi, një spesor me një profil të lartë kualiteti për të bërë këtë detyrë kaq të rëndësishme të një organi kushtetues, këtu është pika ku ne duhet të bëjmë kujdes.

Sigurisht që çështja që kemi ngritur, pra një përzgjedhje e cila do të eliminonte kapjen politike, shorti është një prej atyre elementeve, por duhet të bëjmë kujdes me mënyrën se si i dizenojmë, se këtu po punojmë për këtë çështje.

Pastaj, shqetësimi që ne ngremë në lidhje me nevojën për të qenë gjykatë, dhe si rregull është Gjykata e Lartë, do të ishte opsioni standard, siç pranohet edhe nga ju. Sigurisht që duke punuar ne mund të shohim një zgjidhje e cila do të shmangë një nga qëllimet kryesore ose do të plotësojë një prej qëllimeve kryesore, shmangien e korporatizmit, por kjo është çështje që ne e kemi lënë të hapur dhe duhet ta mbyllim së bashku. Për këtë arsye nuk jam i shqetësuar.

Më e rëndësishmja është që gjyqtarët duhet të jenë të disiplinueshëm pa asnjë lloj ekuivoku dhe pa asnjë shans që t'i shpëtojnë qoftë paaftësisë, qoftë korrupsionit. Për korrupsionin kemi instrumentin tjetër, por në rastin e inefficiencës dhe paaftësisë që do të na prodhonte një sistem korporatist, ne duhet ta eliminojmë këtë. Se kush është, hajde ta diskutojmë bashkë! E rëndësishme është që disiplinimi të bëhet mirë dhe siç duhet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Unë besoj se çështjen si do të jetë sistemi dhe si do të konfigurohet sistemi, tashmë e kemi zgjidhur. Çështjen si do të jetë ai më eficient, jemi në proces për ta diskutuar dhe për ta përmirësuar. Kemi pasur një ditë të lodhshme, jo shumë produktive, që të jem i sinqertë dhe pavarësisht se e kemi kaluar tërësisht kapitullin e gjyqësorit, do ta ndërpresim këtu për sot, duke shpresuar që nga gjithë ky ushtrim i vështirë që u bë sot, të kemi nxjerë disa mësim, së pari për t'i qëndruar momentit, të cilin jemi duke diskutuar, që na imponon të mbahemi fort te dokumenti i Komisionit të Venecias, te projekti i paraqitur, duke dhënë këndvështrimet për zgjidhje që e harmonizojnë atë me frymën e Kushtetutës aktuale, me natyrën e një dokumenti kushtetues dhe për t'i bërë normat shumë më eficiente në zbatimin praktik. Kjo do të thotë që

duhet të kemi sugjerime dhe propozime konkrete, në mënyrë që ekspertët ta kenë shumë më të lehtë për të reflektuar.

Unë besoj se duhet t'i evitojmë sa më shumë të jetë e mundur qëndrimet politike, në këtë moment, për shkak se këtë e kemi ezauruar me një debat të gjatë ndërmjet nesh, me disa dokumente të prodhuara në këtë tavolinë nga ne dhe nga vetë opozita, në mënyrë të veçantë.

Mbledhja e ardhshme do të jetë ditën e mërkurë, kur do të shqyrtojmë nga neni 45 deri te neni 54, pra të gjithë sistemin e prokurorisë.

E mbyllim këtu për sot.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi - Unë besoj se të gjithë biem dakord në lidhje me atë që thotë atë që thotë Komisioni i Venecias, që është e vetmja bazë jona dhe të gjitha ato elemente që duhet t'i zgjidhim së bashku, do t'i zgjidhim së bashku më tej, në shtratin e përmirësimit të këtij drafti. Por mbetet të theksojmë fort, se neni 25, me propozimet siç janë në këtë draft, ai lloj formulimi, nuk duhet të qëndrojë për këtë nen. Kjo duhet të jetë e qartë. Pra, edhe rasti i gjykatës së posaçme, e cila ka ato probleme që janë të reflektuara këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të kemi parasysh se jashtë kanë dalë të tjera njoftime ose të paktën është interpretuar, sikur është rënë dakord me të njëjtin formulim që ka në këtë tekst.

Jo vetëm propozimi i zotit Majko, por edhe propozimi që bëme ne, çojnë në një drejtim, që nuk mund të ketë asnjë lloj amnistimi, asnjë lloj kufizimi në hetimin e të gjithë atyre, të cilët...

Fatmir Xhafaj – Më falni!

Oerd Bylykbashi - Nuk është problem se ç'kanë thënë të tjerët, por duhet të jetë e qartë se nuk do të ketë asnjë lloj amnistimi për asnjë lloj zyrtari të lartë, i cili për arsye të kohës apo përtej asaj që përcakton ligji, mund t'i shpëtojë gjykimin nga gjykata e posaçme.

Fatmir Xhafaj – Për këtë foli zoti Majko, bile ai kaloi në ekstrem, se tha që nga viti 1991, gjë për të cilën as unë nuk bie dakord.

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë